



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Gezim DIBRA

Prof.As. Valentina HAXHIYMERI

Korrik / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”

1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.744, datë 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr 69, date 14.06.2018 Miratuar nga MAS me shkrese nr.7238/1, date 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.298, datë 22.10. 2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimit
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për 2022-2023	17 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 40 studentë; 2020-2021 32 studentë; 2021-2022 11 studentë; 2022-2023 8 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu” (në vijim UAMD) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UAMD. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dyte me emërtesë Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”. Programi i studimit është hapur me VKM Nr. 744, date 05.09.2013 me emërtimin “Mësimdhënie në Psikologji Sociologji”. Ky program studimi është riorganizuar deri në 20 %, duke ndryshuar emërtimin, nga Msc në “Mesimdhënie në Psikologji Sociologji”, në Msc “Mësues i Shkencave Sociale”, sipas Vendimit të Senatit Nr 69, date 14.06.2018, miratuar me shkresë nga MASR 7238/1 prot, date 31.08.2018. Programi ofrohet prej Departamenti i Psikologjisë të Fakultetit të Edukimit (FE) në UAMD.

Aktualisht, programi “Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”. është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program synon të përgatisë specialistë në fushën e mësimdhënies të lëndëve të shkencave sociale. Ai përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike/4 semestra. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Diplomë “Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale”. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vitet e fundit, është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 8 studentë
- Për vitin akademik 2021-2022 është 11 studentë
- Për vitin akademik 2020-2021 është 32 studentë

Gjithsej 52 studentë. Të diplomuar nuk ka në vitin akademik 2022-2023



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mesues i Shkencave sociale. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga **Prof.Dr Gëzim Dibra** dhe **Prof.Asoc.Dr. Valentina Haxhiymeri** dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, znj. Rajna Lila. Vizitat u realizuan në datat 9 dhe 10 Tetor 2023. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.

Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Arsim Parashkollor në FE, të UAMD-së, është:

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 801 datë 20.12.2005 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UE dhe Rregulloret në UAMD.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambientet e brendshme të UAMD dhe FE-së.

Analiza e të dhënave parësore është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Mesues i shkencave sociale (shtator 2023), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Drejtues te institucionit që mbulojnë programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe të Çështjeve Mësimore.

- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Takim me Përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës
- Takim përfundimtar me Dekanin

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizimi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

Vëzhgimi i mjediseve mësimore në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të arteve, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FE-së dhe të UAMD-së. Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi në përputhje tërësore me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare, dhe që synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Në Statutin e UAMD, Neni 3 shprehet se “<i>Universiteti mbështetet në parimin se arsimit të lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike ...</i>” Neni 4, pika 1, deklaron se “<i>UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuar me veprimtari të ligjshmerit e transparencës.</i>”¹</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UAMD, përfshi edhe programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, janë në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr.80/2015 “<i>Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë</i>”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto programe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky synim gjen shprehje në dokumentin “<i>Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së, 2020-2025</i>”, seksioni IV, ku mes të tjerash deklarohet se “<i>Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuar në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar</i>”. (fq.5)², si dhe në dokumentin “<i>Plani i zhvillimit strategjik të Departamentit të Psikologjisë, 2020-2025</i>”, ku shprehimisht thuhet se “<i>Departamenti synon ofrimin e programeve në</i></p>

¹ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

² <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf>



6


	<p><i>përputhje me kërkesat e tregut, sidomos në programet e nivelit të dytë të studimeve. Për këtë e ka praktikë rishikimin e kurrikulave, me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e sociologjisë, pasuruar në veprimtarinë shkencore të vendeve të zhvilluara kryesisht të OECD, BE, G20” (fq.9).³</i></p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, i referohet nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së UAMD-së, Ky kriter pasqyrohet qartë në Statutin e UAMD, neni 1, pika 2 e tij, ku përcaktohet se “Universiteti vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale...”. Në nenin 3 të tij, “Misioni”, ku deklarohet se “Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ka për mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Të krijojë, të zhvillojë e të përcjellë dije përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; b) Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; c) Të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin; d) Të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane; e) Të nxisë dhe të ofrojë arsimin universitar të integruar me praktikën profesionale të drejtëpërdrejtë në sipërmarrje.⁴ <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, 2019”, Neni 6, shprehet se “Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Ai gjithashtu synon të japë kontribut në zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies, si dhe komunikimit me fëmijët dhe të rinjtë. Përfundimi me sukses i këtij programi e çon studentin në tregun e</p>

³ Evidenca Nr.6 Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Psikologjisë 2020-2025.pdf

⁴ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

	<p><i>punës, pra në fazën tjetër, në zhvillimin e praktikës profesionale dhe më tutje, në provimin e shtetit, për t'u pajisur me licensën për ushtrimin e profesionit të mësuesit.⁵</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale</i> është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të dokumenteve të tilla si: “<i>Plani i Zhvillimit Strategjik, 2020-2025</i>”, Statutit dhe Rregullores së UAMD-së, FE-së, DP-së, si dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p> <p>Në dokumentin “<i>Plani i Zhvillimit Strategjik, 2020-2025</i>”, deklarohet se “<i>Misioni i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, është të rris prestigjin dhe të sjell shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studjuarit gjatë gjithë jetës, aftësimi të personelit akademik, duke e bërë UAMD-në një qendër nevralgjike të zhvillimit të dijes, inovacionit dhe ekonomisë</i>” (fq.3).⁶</p> <p>Në dokumentin RVB (2023), Institucioni shprehet se “<i>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe Fakulteti Edukimit, kanë si mision të formojnë dhe zhvillojnë tek studentët dije dhe aftësi për transformimin e tyre personal, suksesin profesional dhe përmirësimin e të mirave të përbashkëta</i>”.⁷</p> <p>Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të nivelit të dytë “<i>Mësues i Shkencave Sociale</i>” janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Të përgatisë mësues në arsimin paranuiversitar në shkencat shoqërore dhe humane.</i> 2. <i>Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla.</i> 3. <i>Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor</i>”.⁸
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale</i>, është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, interesit kombëtar për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqënies së</p>

⁵ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

⁶ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf>

⁷ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf

⁸ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

<p>interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>shoqërisë shqiptare dhe prirjet globale të zhvillimit të arsimit, kërkimit shkencor dhe sigurimit të standardeve në ushtrimin e profesionit të mësuesit, mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. Në dokumentin “Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, 2020-2025, theksohet se “Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”; Strategjisë Kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (2017-2022)”; ... në përputhje me Statutin e UAMD, Strategjinë e Zhvillimit të UAMD 2020-2025; Strategjinë e Zhvillimit të FE dhe DP. Shtyllat kryesore të ndërtimit të strategjisë bazohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia dhe kurrikula e programit të studimit; • Kërkimi shkencor; • Sigurimi i cilësisë së programit dhe mësimdhënies; • Mbështetja e studentëve; • Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm. <p>Objektivat strategjike të specifikuara për programin e studimit janë orientuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies • Ndërkombëtarizimin e studimeve • Cilësia e kërkimit shkencor • Bashkëpunimi mes komunitetit të kërkuesve shkencorë, mësimdhënësve, shoqërisë civile dhe biznesit për hartimin e projekteve të përbashkëta <p><i>Departamenti i Psikologjisë, Pedagogjisë dhe Sociologjisë, kanë praktikë rishikimin e kurrikulave, me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e sociologjisë, pasuruar në veprimtarinë shkencore të vendeve të zhvilluara kryesisht të OECD, BE, G20”⁹</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar ne analizen e kriterëve 1-4 te standartit I.1 te dokumentacionit te paraqitur dhe vizites ne institucion mendon se programet e studimit të ofruara nga UAMD, përfshi edhe programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë</i></p>

⁹ Evidenca_Nr.9_Plani i zhvillimit strategjik të Programit MSH MSHS 2020-2025.pdf




	<i>ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore.</i>			
	GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD), është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me Vendim Nr 801, datë 20.12.2005 të Këshillit të Ministrave.¹⁰ Përgjatë 18 viteve të themelimit të tij, institucioni ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e specialistëve të kualifikuar dhe kërkuesve të rinj në fushën e edukimit, ekonomisë, drejtësisë, teknologjisë së informacionit dhe zhvillimit profesional.</p> <p>UAMD përbëhet nga 5 fakultete, Fakulteti i Edukimit është një nga njësitë kryesore në përbërje të strukturës akademike të UAMD. Kjo njësi përfshin 7 njësi bazë, nga të cilat 6 departamente dhe Qendra për Edukimin në Vazhdim.¹¹ Departamenti i Psikologjisë është njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, “Master i Shkencave” në Mësues për Shkencat Sociale. Për organizimin e këtij programi, Departamenti i Psikologjisë bashkëpunon ngushtësisht me Departamentin e Pedagogjisë dhe Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin e Edukimit.¹²</p> <p>FE dhe DP demonstronjë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale. Referuar dokumentit.¹³, rezulton se Fakulteti i Edukimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 79 pedagogë efektivë (PAE) nga ku:</p>

¹⁰ Institution profile-Information about HEI, e-ASCAL.

¹¹ Evidenca_Nr.33_Organograma e Fakultetit të Edukimit, UAMD.pdf; Evidenca_Nr.95_Struktura e përgjithshme e UAMD, 2019.pdf;

¹² Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf

¹³ Evidenca_Nr.33.1_Të dhëna tabelore për personelin akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Edukimit, V.pdf




	<ul style="list-style-type: none"> - 3 Prof. Dr; - 18 Prof. Asoc; - 50 Dr; - 8 Doc/Msc; <p>Ndërsa departamenti përgjegjës për vitin akademik 2022-2023, ka 11 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, dhe 7 me gradën “Doktor”, dhe 1 në proces doktorature.¹⁴</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas dokumentit “<i>Plani strategjik i Fakultetit të Edukimit, 2020-2025</i>”, mësohet se “<i>Misioni i Fakultetit të Edukimit është përgatitja e individëve të kualifikuar në shkencat e edukimit dhe fushave të ngjashme me to për tregun e punës</i>”.¹⁵</p> <p>Në dokumentin “<i>Rregullore e Fakultetit të Edukimit, 2020</i>”, Neni 42, pika 1, përshkruhet se “<i>Fakulteti i Edukimit ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr</i>”.¹⁶</p> <p>Në dokumentin “<i>Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, 2019</i>”, Neni 5, përcakton se “<i>Masteri i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale është pjesë e Ciklit të Dytë të studimeve në Fakultetin e Edukimit të UAMD. Masteri i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale realizohet për një periudhë 2 vjeçare, me kohë të plotë, e cila merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në këtë fushë, dhe jo më pak se 120 kredite Europiane (ECTS)</i>”.¹⁷</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FE-së, njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.¹⁸</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, “Master i Shkencave” në Mësues për Shkencat Sociale. Për organizimin e këtij programi, Departamenti i Psikologjisë bashkëpunon ngushtësisht me</p>

¹⁴ Evidenca_Nr.32_Stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Psikologjisë, 2023.pdf

¹⁵ Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Edukimit, 2020-2025.pdf

¹⁶ Evidenca_Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf

¹⁷ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

¹⁸ Evidenca_Nr.120_Kodifikimi i programeve të studimit në UAMD.pdf




<p>njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamentin e Pedagogjisë dhe Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin e Edukimit.¹⁹</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, 2019”, Neni 9, përcaktohet se “Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” është strukturë mësimore-kërkimore që vepron brenda Departamentit të Psikologjisë, Departamentit të Sociologjisë dhe Departamentit të Pedagogjisë, pranë Fakultetit të Edukimit. Autoriteti drejtues i këtij programi është Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë. (1) Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” përbëhet nga struktura e Personelit Akademik specifik sipas profilit, të Departamenteve Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji, Përgjegjësit të Departamentit Psikologji dhe komisioneve përkatëse që ngrihen sipas nevojave të punës për mbarëvajtjen e programit”.²⁰</p> <p>Programi i studimit i marrë në vlerësim, integron fusha ndërdisiplinore të tilla si: psiko-pedagogjia/mësuesia dhe shkencat sociale. Në këto rrethana, të treja njësitë bazë bashkëpunuese sigurojnë përputhje me fushat akademike e kërkimore respektive.²¹</p> <p>Stafi akademik në përbërje të departamenteve bashkëpunuese, është angazhuar sipas specialitetit përkatës në fushat e studimit të programit të marrë në vlerësim.²²</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në</p>	<p>Sipas RVB (2023) mësohet se “UAMD është angazhuar në politika integruese, të zhvillimit dhe kualifikimit të mëtijshëm të studentëve të diplomuar duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushën e studimit, interesat dhe përvojat, si dhe përfshirjen në projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore”.²³</p>

¹⁹ Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf

²⁰ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

²¹ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf; Evidenca_Nr.14_Rregullore e Departamentit Pedagogji.pdf; Evidenca_Nr.13_Rregullore e Departamentit Sociologji.pdf

²² Evidenca_Nr.30_Fushat e studimit për stafin akademik përgjegjës për programin MSH MSHS në Departamentet.pdf

²³ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf

bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me punonjësit e Zyrës së Karrierës, Alumni dhe Komunikimit, u mësua se “Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar duke përdorur email, instagram, rrjete sociale, takime ballë për ballë, etj. Me ish-studentët realizohen veprimtari të ndryshme me qëllim, informimi për projekte trajnimi për zhvillim profesional, projekte studimore/konferenca shkencore, këshillim individual “in person”, shkëmbim idesh për përmirësimin e kurrikulave, njoftim për vende të lira pune të ofruara nga agjensi apo biznese të ndryshme me të cilat institucioni bashkëpunon, etj.²⁴</p> <p>Tematikat e trajnimit me studentët e diplomuar lidhen kryesisht me zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe aftësimin e tyre për aplikime për punë, si të shkruajnë një kërkesë ose një letër motivimi, një CV personale, etj.²⁵</p> <p>Zyra përgjegjëse për Karrierën, Alumnin dhe Komunikimin, deklaron se herë pas here organizon aktivitete ku fton përfaqësues të komunitetit të biznesit, studentë dhe alumni. Institucioni dëshmon se nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve në konferenca dhe veprimtari të tjera shkencore.²⁶</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar ne analizen e dokumentacionit te paraqitur dhe verifikimit te tyre gjate vizites ne institucion mendon se programi i studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkenca Sociale është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe të njërive bazë bashkëpunuese për programin e studimit në FE/UAMD, ndaj gjykon se standarti permbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁴ Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf

²⁵ Evidenca_Nr.163_Kalendari i aktiviteteve, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës 2019-2022, Shoqa.pdf; Evidenca_Nr.102_Model Kontrate Pune, UAMD.pdf

²⁶ Evidenca_Nr.131_Njoftime për stafin dhe studentët për konferencat shkencore, FE, 2019-2022.pdf

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FE, në UAMD, i cili ofron programin e studimit të ciklit të dytë demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UAMD, dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit përkatës, sigurimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Sipas dokumentit “Rregullore e Njësive Kryesore, Fakulteti i Edukimit (2019)”²⁷, neni 3 i saj, deklaroi se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator, të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mesimore, kërkimore shkencore dhe administrative të Fakultetit të Edukimit; 2. Rregullorja i shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës akademik me karakter akademik/administrativ, studentët si dhe ndaj çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e FE; 3. Rregullorja e FE disiplinon edhe marrëdhëniet e organeve dhe autoriteteve drejtuese me njësitë përbërëse të tij; <p>Në dokumentin “Rregullore e Departamentit të Psikologjisë (2019)”²⁸, Neni 3, shprehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator, të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mesimore, kërkimore-shkencore dhe administrative të Departamentit të Psikologjisë. • Rregullorja shtrin efektet e saj në të gjitha organet dhe autoritetet drejtuese, grupet përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës akademik me karakter akademik/ndihmës akademik/administrativ, studentët, si dhe në çdo person tjetër fizik

²⁷ Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;

²⁸ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf

	<p>apo juridik që vepron në objektet apo territorin e Departamentit të Psikologjisë.</p> <p>Në nenin 14 të këtij dokumenti, janë përcaktuar detyrat dhe funksionet e drejtuesit të departamentit, ku midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizon shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia, sipas akteve nënligjore në fuqi dhe sigurohet për përmbushjen e saj; • Mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore në Departament, në përputhje me planin vjetor të miratuar, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor dhe akademik të personelit akademik të Departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij; • Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar dhe të kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera; • Analizon çdo vit realizimin e detyrave të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe harton raportin e analizës vjetore të Departamentit të Psikologjisë; <p>Neni 16 i Rregullores së DP, përshkruan detyrat specifike të Përgjegjësit të Grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor, ku (4) Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor, ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim; b) Organizon punën për hartimin e programeve të lëndëve për t'i propozuar më pas për miratim në njësinë bazë; c) Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera; ç) Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe për problemet që lindin informon autoritetet drejtuese;²⁹ <p>Neni 17 i Rregullores së DP, rendit detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Programit të studimit, ku mes të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koordinon punën për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik;
--	--

²⁹ Evidenca Nr.12 Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf

	<p>programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në program. • Përgatit raporte analitike që kanë për bazë të gjeturat nga monitorimi dhe adreson rekomandimet specifike; • Mban kontakte dhe ndihmon në organizim të takimeve me biznese dhe tryeza tjera me qëllim avokimi, analize, si dhe tryeza ad hoc; • Mbikëqyr studentët gjatë kryerjes së Praktikave apo implementimit të aktiviteteve; • Organizon vlerësimin e brendshëm të Programit të studimit;³⁰ <p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, 2019”, Neni 9 i tij, deklarohet se “Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” përbëhet nga struktura e Personelit Akademik specifik sipas profilit, të Departamenteve Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji, Përgjegjësit të Departamentit Psikologji dhe komisioneve përkatëse që ngrihen sipas nevojave të punës për mbarëvajtjen e programit”. Neni 10 i Rregullores, specifikon se: (1) “Përgjegjësi i departamentit të Psikologjisë, që është edhe koordinatori i programit, koordinon punën me anëtarët e departamentit të Psikologjisë dhe departamenteve të tjera...”.³¹</p> <p>Sipas RVB (2023) Departamenti i Psikologjisë si departamenti përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e programit master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi brenda fakultetit me njësitë e tjera për të mundur realizimin efektiv të objektivave që ka ky program studimi.³²</p> <p>Tërësia e raporteve dhe relacioneve me shkrim të shkëmbyera në kuadër të veprimtarisë institucionale, përbëjnë jo vetëm një praktikë të mirë pune, por edhe një tregues të qartë të bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.³³</p>
--	---

³⁰ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf

³¹ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

³²Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf

³³Evidenca_Nr.107_Raport për aktivitetin kërkimor shkencor, UAMD. 2018-2019.pdf; Evidenca_Nr.109_Relacion për aktivitetet e organizuara në UAMD për vitin akademik 2018-2019_2019-2020).pdf; Evidenca_Nr.111_Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, UAMD/FE ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Institucioni dokumenton një listë prej 61 bashkëpunimesh me Organizata/Ndërmarrje/Institucione/ të tjera, të dobishme për programin lëndor Praktika Mësimore dhe për të gjithë fakultetin.³⁴</p> <p>Gjithashtu, Departamenti i Psikologjisë, njësia që ka në përgjegjësi programin e studimit të marrë në vlerësim, ka siguruar bashkëpunime³⁵ me institucione, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkia Durrës (Marrëveshje me UAMD) 2. Drejtoria Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar DPAP, Zyra Vendore e Arsimit Durrës 3. Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës 4. Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Durrës 5. Qendra Ditore e të Moshuarve, Durrës 6. Ryder Albania Dega Durrës 7. Urdhri Psikologut në Republikën e Shqipërisë 8. Shkolla e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore, (PLM) Durrës 9. Qendra e Zhvillimit Mendor "Drejt Zhvillimit", Durrës 10. Klinika "Butterfly" Durrës 11. Qendra Komunitare "Sot për të Ardhmen" Durrës 12. Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës.
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës</p>	<p>FE/DP dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me institucione brenda vendit, qendra të shërbimit psiko-social, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj, me synim kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale të studentëve të programit të studimit të marrë në vlerësim, realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.³⁶</p>

Financiare UAMD, 2021-2022.pdf; Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf; Evidenca_Nr.152_Raport i rezultateve të anketimit të studentëve, stafit akademik dhe administratës mbi.pdf; Evidenca_Nr.162_Raport dhe pyetësi për studentët për matjen e nivelit të kënaqësisë me shërbimet e se.pdf;

³⁴ *Evidenca_Nr.170_Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikat profesionale dhe tregun e punës UAMD.pdf;*


³⁵ *Evidenca_Nr.176_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Edukimit dhe në rang Departamenti të Psik.pdf*

³⁶ *Evidenca_Nr.170_Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikat profesionale dhe tregun e punës UAMD.pdf;*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në mënyrë specifike, FE ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DAR, Durrës për realizimin e praktikave profesionale të studentëve që ndjekin programet në fushën e mësuesisë.³⁷</p> <p>UAMD ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe apo institute kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim realizimin e kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.³⁸</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se raporton në instancat përkatëse për bashkëpunimet në funksion të realizimit të programeve të studimeve, përfshin edhe programin Master i Shkencave në “Mësues për Shkencat Sociale”.³⁹</p> <p>Sipas RVB (2023) Departamenti i Psikologjisë, në analizën vjetore të veprimtarisë së vet ka raportuar mbi ecurinë dhe përfitimet e bashkëpunimit me institucione në funksion të realizimit të programit të studimit.⁴⁰</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati rastin të kqyrë dokumentacionin lidhur me raportet analitike vjetore të DP, por verën se mungon formati elektronik në faqen e-ASCAL, referuar Në RVB (2023), Evidenca Nr.78.</p> <p><i>Megjithatë, pavarësisht raporteve mbi veprimtarinë vjetore të departamentit, sugjerohet që të hartohen edhe raporte analitike adresuar mirefilli përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizen e kriterëve 1-4 të standartit I.3 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion konkludon se UAMD/FE siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p> <p>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

³⁷ Evidenca Nr.177 Marrëveshje bashkëpunimi FE me Drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar, Durrës p.pdf

³⁸ Evidenca Nr.172 Informacion mbi projektet ndërkombëtare në UAMD (2016-2021).pdf;

³⁹ Evidenca Nr.133 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf

⁴⁰ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, dhe i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Pika 2 e tij, shprehet se: <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</i></p> <p>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</p> <p>c) rezultatet e të nxënit (objektivat formues) dhe kompetencat profesionale;</p>





	<p>c) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</p> <p>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</p> <p>dh) planin mësimor;</p> <p>e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</p> <p>ë) programin lëndor (Syllabus-et);</p> <p>f) profilin e programit ;</p> <p>g) diplomën dhe suplementin</p> <p>VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, Pika 2.4/a “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, përcakton se : <i>Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në :</i></p> <ol style="list-style-type: none"> i. <i>Mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor ;</i> ii. <i>studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;</i> iii. <i>përgatitje për provime;</i> iv. <i>përgatitje e tezës së diplomës;</i> v. <i>veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private;⁴¹</i> <p>Në dokumentin “Rregullore e Njësisë Kryesore Fakulteti i Edukimit” (2019), Neni 42 “Ciklet dhe programet e studimit”, pika 1 shprehet se: Fakulteti i Edukimit ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlersuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr. Pika 2, shprehet se: <i>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është jo më pak se 60 kredite.</i> Neni 46 i kësaj rregullore, “Për programet e ciklit të dytë të studimeve” pika 2, shprehet se: <i>Programet e studimit “Master i shkencave” realizohen me</i></p>
--	--

⁴¹ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/6/0/f1307ef-8573-422a-a092-6aa6d5e36e3e>;

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>;

<https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM-nr.185.%20dat%C3%AB%2025.03.2021.pdf>.




jo më pak se 120 kredite formiminë vijim të ciklit të parë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" në fushën e arsimit të kryer.⁴²

Sipas dokumentit "Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale (2019), Neni 9 i tij "Struktura e programit dhe plani mësimor", Pika 4, përcakton se: Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS. Me qëllim lehtësimin e integritit të studentëve të diplomuar pranë UAMD-së në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar, ofrohet edhe konvertimi në kredite UsCr. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- i) Lëndët bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- iv) Lëndë plotësuese, fokusuar në përfitim të aftësive dhe kompetencave praktike në mësimdhënie, e zhvilluar pranë institucioneve të arsimit parauniversitar publik apo jo publik, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkuara për këtë qëllim;
- v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës. Pësha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.⁴³

Referuar dokumentit "Plani Mësimor" (viti akademik i pa specifikuar) i programit të studimit Msc në Mësues për Shkencat Sociale, vërehet se lëndët/modulet janë kategorizuar nga A në F, dhe jo nga A-E sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, i ndryshuar.

⁴² Evidenca_Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;


⁴³ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf

	<p>Në Planin Mësimor vërehet se gjenden lëndë të kategorisë C, të tilla si lëndët me zgjedhje, që janë kategorizuar në kategorinë D, dhe lënda praktikë profesionale që i përket kategorisë D, është grupuar në kategorinë E. Ndërsa, provimi/teza e diplomimit është kategorizuar si F.⁴⁴</p> <p>Megjithatë, duke u bazuar në përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, i ndryshuar, lëndët/modulet e Planit Mësimor mund të grupohen në kategori, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - (A) 3 lëndë (15 ECTS) - (B) 8 lëndë (43 ECTS) - (C) 4 lëndë (21 ECTS) - (D) 2 lëndë (11 ECTS) - (E) 1 lëndë <i>praktika profesionale</i> (12 ECTS) - (F) Detyrime përmbyllëse (18 ECTS) <p>Sipas dokumentit “Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)”,⁴⁵</p> <ul style="list-style-type: none"> - (A) 2 LËNDË BAZË - <i>përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</i> (10 ECTS) - (B) 11 LËNDË KARAKTERIZUESE - <i>përgatitje për disiplinën shkencore - artistike</i> (64 ECTS) - (C) 3 LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - <i>nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje</i> (16 ECTS) - (D) 1 LËNDË PLOTËSUESE – <i>gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale</i> (12 ECTS) - (E) DETYRIME PËRMBYLLËSE (18 ECTS) <p>Referuar dokumentit “Kurrikula mësimore e degës”,⁴⁶, respektivisht pjesës në anglisht (fq. 3-4) konstatohet kategorizimi i veprimtarive formuese, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - (A) 2 lëndë (10 ECTS) - (B) 12 lëndë (64 ECTS) - (C) 3 lëndë (16 ECTS) - (D) 1 lëndë (12 ECTS) - (E) Detyrime përmbyllëse (18 ECTS)
--	---

⁴⁴ Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

⁴⁵ Evidenca_Nr.28.2_(Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Master i Shkencave “Mësues i.pdf

⁴⁶ Evidenca_Nr.28.3_(Kurrikula Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” V.A. 2018-2020, ShqipAnglisht.pdf;




GVJ vëren një mospërputhje të parasqyrimin të të dhënave midis tre dokumenteve të mësipërme.

Rezultojnë 8 lëndë të kategorisë B (43 ECTS) në dokumentin “Plani Mësimor”, 11 lëndë të kategorisë B (64 ECTS) në dokumentin “Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)”, dhe 12 lëndë të kategorisë B (64 ECTS) në dokumentin “Kurrikula mësimore e degës”.

Bazuar në “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Nenit 9, pika 2, shprehet se: *Plani mësimor është pasqyra e lëndëve të ofruara nga ky program studimi, ku pasqyrohen lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, dhe shpërndarja e tyre përgjatë kohëzgjatjes normale të programit të studimit në vite dhe semestra.*⁴⁷

Duke qënë se Plani Mësimor është pasqyra e lëndëve të ofruara nga programi i studimit të marrë në vlerësim dhe përbën një dokument të rëndësishëm në procesin e zbatimit të tij, GVJ u përqëndrua në shqyrtimin e mëtejshëm të këtij dokumenti. Të dhënat e paraqitura në Planin Mësimor, janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018 (i ndryshuar), për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategori	Përshkrimi	VKM 41/2018,	Të dhënat në Planin Mësimor Msc në “Mësuesi për Shkencat Sociale”	
			ETCS	%
A	Lëndë bazë	5%-10%	15	12.5%
B	Lëndë karakterizuese	50%-60%	43	36%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	32	26.5%
D	Lëndë plotësuese	10%	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-15%	18	15%
	Totali		120	100%

⁴⁷ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

	<p>Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin “Planin Mësimor”, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, i ndryshuar Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave, nxjerr në pah se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjenden më shumë kredite për lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 12.5% të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori; - Gjenden më pak kredite për lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese) në Planin Mësimor të shprehura në 36% të krediteve, në raport me 50% - 60% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori; - Sipas përcaktimeve të VKM, Nr. 41/2018, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e programit të marrë në vlerësim, përqindja totale e krediteve për lëndë të kategorive A dhe B rezultojnë të jetë 48.5%; - Gjithashtu, gjenden më shumë kredite për lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore) në Planin Mësimor të shprehura në 26.5% të krediteve, në raport me 12% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; - Përsa i përket provës finale, rezultojnë 15% kredite të akorduara, në përputhje me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM nr. 41/2018; <p><i>Për sa më sipër GVJ sugjeron:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të rakordohen të dhënat e pasqyruara në dokumentet, si: Plani Mësimor, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) dhe Kurrikula mësimore e degës Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale; 2. Të rishikohet në Planin Mësimor, shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, me qëllim që të përafrohen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar);
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë</p>	<p>Referuar dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019),⁴⁸ Nenit 7, mes të tjerash, theksohet se: <i>Ky program është në përshtatje me kërkesat dhe</i></p>

⁴⁸ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;




profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

kurrikulën e sistemit parauniversitar për mësimdhënien në shkencat sociale dhe ofron:

- a. Studime të thelluara për mësimdhënien dhe mësimnxënien në shkencat sociale.*
- b. Formim profesional për mësimdhënien në fushat Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar në sistemin e arsimit parauniversitar.*
- c. Studime të thelluara në mësimdhënie dhe mësimnxënie sipas metodave bashkëkohore.*

Sipas Nenit 6 të kësaj Rregullore, specifikohet se: *Masteri i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" synon t'u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Ai gjithashtu synon të japë kontribut në zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies, si dhe komunikimit me fëmijët dhe të rinjtë. Përfundimi me sukses i këtij programi e çon studentin në tregun e punës, pra në fazën tjetër, në zhvillimin e praktikës profesionale dhe më tutje, në provimin e shtetit, për t'u pajisur me licensën për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të nivelit të dytë "Mësues i Shkencave Sociale" janë:*

- 1. Të përgatisë mësues në arsimin parauniversitar në shkencat shoqërore dhe humane.*
- 2. Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla.*
- 3. Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor;⁴⁹*


Lidhur me kriterin 2, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet se programi i studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, ka deklaruar qartë në dokumentet e tij rregullatore se synon formimin e shprehive të veçanta në profesionin e mësuesisë, duke integruar njohuri nga fushat lëndore *Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar të cilat zhvillohen në sistemin e arsimit parauniversitar. Programi përgatit studentin për punësim në*

⁴⁹ *Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf*

	<p>institucione të arsimit parauniversitar, nxit të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së mësimdhënies dhe mësimnxënies, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në fushën përkatëse akademike dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në aspektin profesional.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor” dhe dokumentit “Kurrikula Mësimore e degës Master i Shkencave në “Mësues për Shkencat Sociale”, konstatohet se programi i studimit i marrë në vlerësim, ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Praktika profesionale përfshin 12 kredite (45 orë seminar dhe 255 orë praktikë/kërkim shkencor) në total 300 orë mësimore/10 % nga totali i krediteve të programit të studimit.⁵⁰ - Detyrimet përmbyllëse (diploma), të cilës i janë akorduar 18 kredite/450 orë/ 15% nga totali i krediteve të programit të studimit, të cilat rezultojnë në përputhje me përcaktimet e VKM-së Nr. 41/2018, për këtë kategori (10%-15%).⁵¹
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Referuar dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 5, “Statusi i Masterit të Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”. Cilëson se: <i>Masteri Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” është pjesë e Ciklit të Dytë të studimeve në Fakultetin e Edukimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” realizohet për një periudhë 2 vjeçare me kohë të plotë, e cila merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në këtë fushë, dhe jo më pak se 120 kredite Evropiane (ECTS). Shuma e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite. Neni 7, deklaron se: Programi është menduar për studentët, të cilët kanë përfunduar programin bachelor tre ose katër vjeçar në degë të shkencave sociale ose humane dhe me mesatare të parashikuar sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi. Ky program është në përshtatje me kërkesat dhe kurrikulën e sistemit parauniversitar për mësimdhënien në shkencat sociale dhe ofron:</i></p> <p>a. <i>Studime të thelluara për mësimdhënien dhe mësimnxënien në shkencat sociale.</i></p>

⁵⁰ Evidenca_Nr.28.3_Kurrikula Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” V.A. 2018-2020, ShqipAnglisht.pdf;

⁵¹ Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;




	<p>b. <i>Formim profesional për mësimdhënien në fushat Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar në sistemin e arsimit parauniversitar.</i></p> <p>c. <i>Studime të thelluara në mësimdhënie dhe mësimnxënie sipas metodave bashkëkohore.</i>⁵²</p> <p>Bazuar në RVB (2023), mësohet se “Programi i studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” realizohet për një periudhë 2 vjeçare, me kohë të plotë dhe përgatit mësues në lëndët e profilit shoqëror në arsimin e mesëm të lartë.”⁵³</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Sipas Nenit 15 të dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), pika 2, shprehet se: <i>Programi i Ciklit të Dytë të studimit, Master i Shkencave, organizohet me jo më pak se 120 kredite Evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është jo më pak se 60 kredite.</i>⁵⁴</p> <p>Në RVB (2023), institucioni deklaron se: <i>Programi i studimit master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” organizohet në 120 kredite (ECTS) dhe 25 % e këtyre krediteve janë në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik të studentit.</i>⁵⁵</p> <p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor”,⁵⁶ vërehet se lëndët dhe veprimtaritë formuese të parashikuara për formimin e përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit të marrë në vlerësim, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Psikologji sociale dhe këshillim i nxënësve (5 kredite) – kategoria B; - Metodologjia e mësimdhënies (5 kredite) – kategoria A; - Psikologji motivacioni dhe shkollore (5 kredite) – kategoria C; - Zhvillim Kurrikule (5 kredite) – kategoria C; - Psikologji edukimi (6 kredite) – kategoria B; - Psikologji e zhvillimit në adoleshencë (zgj.) (5 kredite) – kategoria D; <p>Numri total i krediteve për formimin e përgjithshëm psiko-pedagogjik në programin e studimit Msc në Mësues për Shkencat</p>

⁵² Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

⁵³ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

⁵⁴ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

⁵⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

⁵⁶ Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

	<p>Sociale, është 31 kredite ose pak më shumë se 25 % të krediteve që duhet të përmbajë programi i studimit Master në fushën e mësuesisë, sipas përcaktimeve të Ligjit 80/2015 për AL. Në këtë aspekt, programi i studimit i marrë në vlerësim përmbush kriterin 5 të këtij standardi.</p> <p>Lidhur me pikën 4, të Nenit 83 të Ligjit 80/2015, i cili përcakton se “Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme”, Institucioni deklaron në RVB (2023) se: Ky program studimi është në përmbajtjen e lëndëve të parashikuara, i ngjashëm në 80% me programe të tjera që formojnë mësues për lëndët shoqërore në arsimin e mesëm të lartë, të ofruara nga IAL, sipas urdhërit Nr. 225, Dt.07.05.2018 nga MASR për përafrimin e programeve në fushën e mësuesisë të IAL dhe përshtatjes së mëtejshme në vijim të kurseve të dakortësuara nga grupi i punës i ngritur për përafrimin e programeve të mësuesisë në master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.⁵⁷</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Kreu VII “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69 “Për format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, mes të tjerash përcakton se “...Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë”.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 14 “Struktura akademike e studimeve”, pika 1, shprehet se: Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” realizohet me kohë të plotë në dy vite akademike, i ndarë në katër semestra, gjatë të cilëve studenti fiton 120 ECTS. Programi është në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamentet Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji, dhe është miratuar me vendim të senatit akademik të UAMD.</p> <p>Sipas Nenit 18 “Gjuha e studimeve”, specifikohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” ofrohet në gjuhën Shqipe. 2. Në këtë program mund të ofrohen kurse të ndryshme në një nga gjuhët e Bashkimit Europian, me propozim nga departamenti dhe miratimin në dekanat.

⁵⁷ Evidenca_Nr.24_Gruplëndët e përcaktuara në masën 80% nga grupi i punës për master i shkencave “Mësues i.pdf

3. Në rastin e kursit që ofrohet në gjuhë të huaj, studentët kanë detyrimin për të dëshmuar njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin B2.

Referuar Nenit 27, të kësaj Rregullore, “Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”, përcaktohet se:

1. Pranimi në programin e ciklit të dytë të studimit është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimit të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit. Njësia kryesore mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve të cilat, pasi miratohen nga Senati Akademik, shpallen nga institucioni dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
2. Kriter pranimi në “Masterin e Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë përgjegjëse të Arsimit të Lartë dhe me vendim të Senatit Akademik. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
3. Njësia kryesore mund t’u njohë studentëve kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programin e studimit “Master i shkencave”. Vlerësimi do të bëhet mbështetur në përputhshmërinë midis kurrikulës së programit “Master profesional” dhe “Master të shkencave”, sipas përcaktimeve të përmbajtura në rregulloren e transferimeve.⁵⁸

Përveç kriterëve të përgjithëshme të pranimit të studentëve, njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, propozon edhe kritere specifike,⁵⁹ të tilla si:

- Nota mesatare e bachelorit vlerësohet 40%;
- Përputhshmëria e programit të studimit vlerësohet 40%;
- Studentët që kanë mbaruar UAMD vlerësohet 20%;

⁵⁸ Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

⁵⁹ Evidenca Nr.127_Kriteret e pranimit të studentëve Fakulteti i Edukimit V.A. 2021-2022.pdf; Evidenca Nr.198 Shkresë nga MASR për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve V.A 2023-2024.pdf;


	Për sa më lartë, Institucioni dëshmon se forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve në programin e studimit të marrë në vlerësim, realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës, me Urdhër Nr.7238/1, datë 31.08.2018 “Për miratimin e riorganizimit të programeve të Fakultetit të Edukimit (UAMD)”, programi i studimit i marrë në vlerësim, pësoi disa ndryshime në kurrikul, deri në 20%, duke përfshirë edhe ndryshimin e emërimit nga “Master i Shkencave” për Mësimdhënie në Psikologji Sociologji, në “Master i Shkencave” në Mësues i Shkencave Sociale. ⁶⁰ Sipas RVB (2023), programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, pas riemërimit dhe përafrimit me programet e tjera të mësuesisë në profilin e shkencave shoqërore, ka në përmbajtjen e kurrikulës 80% ngjashmëri me programet e tjera të ofruara nga IAL me të njëjtin emërtim. ⁶¹
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, shoqërohet me kodin përkatës UAMD-MSH-70114-MSHS, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MAS, në udhëzimin Nr.31 Dt. 15.11.2022, “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”. ⁶² Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Lëndët e këtij programi studimi, sikurse ato të programeve të tjera, pranë Fakultetit të Edukimit, UAMD nuk kanë akoma kodet e tyre të vecanta.</i> ⁶³
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale, në tërësinë e dokumentacioneve që e shoqërojnë, dëshmon se</i>

⁶⁰ Dokumenti “Shkresë Nr.7238/1, datë 2018-08-31” e-ASCAL.

⁶¹ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf;

⁶² Evidenca_Nr.120_Kodifikimi i programeve të studimit në UAMD.pdf;

⁶³ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf;





	<p><i>kryesisht është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Lidhur me këtë standard, GVJ sugjeron:</i></p> <p>1) <i>Të rakordohen të dhënat e pasqyruara në dokumentet, si: Plani Mësimor, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) dhe Kurrikula mësimore e degës Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale;</i></p> <p>2) <i>Të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, me qëllim që të përafrohen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar);</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cllësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në DVV (e-ASCAL) dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore, dhe Departamenti Psikologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Mësuesi për Shkencat Sociale, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike. Fakulteti i Edukimit, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. FE ka në përbërje të tij 7 njësi bazë, nga të cilat 6 departamente dhe Qendra për Edukimin në Vazhdim.⁶⁴</p> <p>Referuar dokumentit “Evidenca_Nr.33.1_Të dhëna tabelore për personelin akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Edukimit, V.pdf”, rezulton se Fakulteti i Edukimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 79 pedagogë efektivë (PAE)⁶⁵ nga ku:</p>

⁶⁴ Evidenca_Nr.33_Organograma e Fakultetit të Edukimit, UAMD.pdf; Evidenca_Nr.95_Struktura e përgjithshme e UAMD, 2019.pdf;

⁶⁵ Evidenca_Nr.33.1_Të dhëna tabelore për personelin akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Edukimit, V.pdf;




Fakulteti i Edukimit	PAE
Prof. Dr.	3
Prof. As. Dr.	18
Dr.	50
MSc.	8
Gjithsej	79

Departamenti i Psikologjisë është njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, “Master i Shkencave” në Mësues për Shkencat Sociale. Për organizimin e këtij programi, Departamenti i Psikologjisë bashkëpunon ngushtësisht me Departamentin e Pedagogjisë dhe Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin e Edukimit.⁶⁶

Departamenti i Psikologjisë, përmbush detyrimet për numrin minimal të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe shkallën e kualifikimit të stafit akademik. Numri i stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë,⁶⁷ për vitin akademik 2022-2023 është si më poshtë:

Departamenti Psikologjisë	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	
Prof. As. Dr.	2	
Dr.	7	
MSc.	-	1
Gjithësej	10	1
Totali		11

⁶⁶ Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf;

⁶⁷ Evidenca_Nr.32_Stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Psikologjisë, 2023.pdf;

	GVJ konkludon se njësia kryesore (FE) dhe njësia bazë (DP) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Referuar të dhënave tabelore për vitin kademik 2022-2023 (<i>Evidenca_Nr.211_Tabelat_përmbledhëse_ASCAL_MSH_MSHS.pdf; fq. 1</i>), vërchet se njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit nuk ka në organikën e saj personel ndihmës akademik/ administrative për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, etj.⁶⁸</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore për praktikat profesionale në programet e studimit të departamentit të psikologjisë” (2019), Neni 4, shprehet se: “Praktika mësimore përbën një element të rëndësishëm në kurrikulat e programeve Bachelor dhe Master... Në nivel master, praktika zhvillohet në semestrin e katërt, për një periudhë 3 mujore, ku studenti duhet të plotësoj 75 orë. Neni 8, (c) specifikon se: “Për studentët që frekuentojnë programet Master Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” dhe “Mësimdhënie në Psikologji-Sociologji”, praktika do të kryhet pranë shkollave të mesme publike apo private”. Neni 9, mes të tjerash specifikon se: “Për organizimin e praktikës ndiqen këto procedura: (a) Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë përcakton pedagogët udhëheqës dhe grupet e studentëve që do të kenë nën mbikqyrje për kryerjen e praktikës”. Në Nenin 10 janë renditur përgjegjësitë e pedagogut udhëheqës.⁶⁹</p> <p>FE dhe DP, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik për realizimin e praktikave mësimore.</p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale	<p>Sipas dokumentit “Rregullore e Departmentit të Psikologjisë (2019)”, Neni 17, përcaktohet se: <i>Koordinatori i Programit të studimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:</i></p> <p>a) <i>Koordinon punën për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit;</i></p> <p>b) <i>Kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në program. Punon ngushtë me Administratorin e UAMD për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të programit; si dhe për administrimin e të</i></p>

⁶⁸ Evidenca_Nr.211_Tabelat_përmbledhëse_ASCAL_MSH_MSHS.pdf;

⁶⁹ Evidenca_Nr.41_Rregullore_për_praktikat_mësimore_në_programet_e_studimit_të_Departamentit_të_Psikologjisë.p





<p>në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p><i>ardhurave nga ky cikël studimesh.</i></p> <p>c) <i>Përgatit raporte analitike që kanë për bazë të gjeturat nga monitorimi dhe adreson rekomandimet specifike;</i></p> <p>Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë.⁷⁰</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 10, përcaktohet se: (1) <i>Përgjegjësi i departamentit të Psikologjisë, që është edhe koordinatori i programit, koordinon punën me anëtarët e departamentit të Psikologjisë dhe departamenteve të tjera të sipërpërmendura, në mënyrë që programi të hartohet në përputhje me udhëzimet mbi ligjin e arsimit të lartë, dhe më pas të të kalojë për miratim nga Senati Akademik dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</i>⁷¹</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore për praktikat profesionale në programet e studimit të departamentit të psikologjisë” (2019), Neni 9, mes të tjerash specifikon se: “Për organizimin e praktikës ndiqen këto procedura: (a) Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë përcakton pedagogët udhëheqës dhe grupet e studentëve që do të kenë nën mbikqyrje për kryerjen e praktikës”.⁷²</p> <p>Referuar evidencës “Lista e mentorimit - lektorët me studentët përkatës Departamenti Psikologji, V.A. 2018-2019”, vërehet se Institucioni harton dokumente që dëshmon se angazhon personel akademik/pedagogë lektorë në rolin e mentorit për studentët.⁷³</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Megjithatë, <u>GVJ sugjeron:</u></i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>të harmonizohen të dhënat tabelore lidhur me numrin e PAE dhe PAK në nivel fakulteti dhe departamenti për vitin akaedimk 2022-2023;</i> - <i>të plotësohet organika me personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, etj.</i> <p><i>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

⁷⁰ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

⁷¹ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

⁷² Evidenca_Nr.41_Rregullore për praktikat mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p

⁷³ Evidenca_Nr.83_Lista e mentorimit - lektorët me studentët përkatës Departamenti Psikologji, V.A. 2018-2019




Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë përgjegjës për Programin e Studimit Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale” dëshmon se disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë, të shtjelluara në mënyrë të hollësishme në dokumente rregullore të përgjithëshme dhe të posaçme, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Njesisë Kryesore Fakulteti i Edukimit (2019); ⁷⁴ - Rregullore e Departamentit të Psikologjisë (2019); ⁷⁵ - Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale (2019); ⁷⁶ - Rregullore për praktikat profesionale në programet e studimit të departamentit të psikologjisë (2019); ⁷⁷ - Rregullore Diplomimi (2019); ⁷⁸
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale”, përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ndarjen e lëndëve në vite e semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore, dhe komponentë të tjerë informues. Plani Mësimor i programit të studimit, përmban 19 lëndë / module, duke përfshirë 2 lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe diplomimin. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite. ⁷⁹</p> <p>Referuar dokumentit të sipër shënuar, vërehet se dokumenti i Planit Mësimor nuk përmban vitin akademik, dhe nuk janë pasqyruar në fund të planit të dhënat lidhur me “Totalin” dhe “Totalin e përgjithshëm”. Referuar dokumenteve të planit mësimor 2018-2019, 2019-2020, 2020-</p>

⁷⁴ Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;

⁷⁵ Evidenca Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf

⁷⁶ Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

⁷⁷ Evidenca Nr.41_Rregullore për praktikat mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p

⁷⁸ Evidenca Nr.34_Rregullore e diplomimit për studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Edukimit.pdf;

Evidenca Nr.36_Rregullore diplomimi për programet e studimit të departamentit të Psikologjisë, 2019.pdf;

⁷⁹ Evidenca Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf



35


	<p>2021, 2021-2022, 2022-2023 (fq.30–39), vërehet se nuk janë pasqyruar orët për studim individual.⁸⁰</p> <p><i>GVJ sugjeron të pasqyrohen të gjitha të dhënat e kërkuara në formatin e Planit Mësimor për të siguruar informacion më të plotë dhe të qartë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pika 2.1 “Kreditet sipas ECTS-së”, germat (e) dhe (ë), lidhur me kriterin 3, shprehen si më poshtë:</p> <p><i>e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.</i></p> <p><i>ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.</i></p> <p>Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Fakultetit të Edukimit (2019), Neni 47 “Pranimet në programet e ciklit të dytë të studimeve”, Neni 57 “Transferimi i studimeve”.⁸¹ - Rregullore e Departmentit të Psikologjisë (2019), Neni 36 “Për pranimet në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve”, Neni 44 “Transferimi i studimeve, njohja dhe njesimi i diplomave”, Neni 47 “Mobiliteti studentor”.⁸² - Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale (2019), Neni 27 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave

⁸⁰ Evidenca_Nr.211_Tabelat_përmbledhëse_ASCAL_MSH_MSHS.pdf;

⁸¹ Evidenca_Nr.11_Rregullore_e_Fakultetit_të_Edukimit.pdf;


⁸² Evidenca_Nr.12_Rregullore_e_Departamentit_Psikologji.pdf;

	<p>Sociale”, Neni 31 “Ndërpreja, rifillimi i studimeve dhe çrregjistrimi”, Neni 32 “Transferimi i studimeve”.⁸³</p> <p>Programi i studimit i marrë në vlerësim përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Referuar dokumentit “Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023, në programet e studimit të ciklit të dytë, pranë Departamentit të Psikologjisë”, vërehet se njësia bazë ka përcaktuar kriteret e përgjithëshme dhe specifike për pranimet në programin e studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale për vitin akademik 2022-2022.⁸⁴</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaroi se: “Të gjitha informacionet, përvoja i përket programit, janë transparente dhe bëhen publike, duke shfrytëzuar rrugët formale, si shpalljet pranë mjediseve të hapuara në Fakultetin e Edukimit, në faqen zyrtare të UAMD apo në faqet përkatëse të rrjeteve sociale të fakultetit dhe departamentit të Psikologjisë. Përveç se shpallen nga institucioni, kriteret vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MAS dhe shpallen në portalin U-Albania”.⁸⁵</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 15, shprehet se Syllabuset organizohen në module, lëndë dhe përmbajnë informacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) titullin e lëndës; b) objektivat e lëndës; c) nëndarjen në module ose në çështje; d) raportin e elementëve të orëve mësimore në auditor; dh) kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës; e) formën e kontrollit të dijeve; ë) numrin e krediteve të lëndës dhe moduleve përkatëse të saj, ngarkesën përkatëse të studentit në auditor dhe si punë të pavarur, mënyrën e vlerësimit për secilin modul dhe gjithë lëndën, etj; f) literaturën kryesore dhe ndihmëse;

⁸³ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

⁸⁴ Evidenca Nr.84 Memo Departamenti i Psikologjisë për kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit.pdf;

⁸⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf



37
XZ

	<p><i>g) titullarin e lëndës.</i></p> <p>Bashkëngjitur këtij dokumenti gjendet edhe formati i miratuar për hartimin e syllabusit (fq. 24-27).⁸⁶</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Syllabuset MSH MSHS bashke.pdf</i>), për programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të marrë në vlerësim, vërehet se të gjitha syllabuset përfshijnë jo vetëm rubrikat e rekomanduara në formatin e miratuar në Rregulloren e Programit të Studimit MSH në MSHS (2019), por edhe një rubrikë shtesë “Kodi i etikës”. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/ specifike të formimit në atë lëndë, temat mësimore, formën e kontrollit të dijes, literaturën bazë të detyruar dhe të rekomanduar, etj. (<i>Syllabuset MSH MSHS bashke.pdf</i>);</p> <p>Për sa më sipër, mund të vlerësohet se syllabuset përmbajnë elementet e përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar), “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”.</p> <p>Sipas RVB (2023), “syllabuset, janë të depozituara në një dosje të vecantë pranë Departamentit të Psikologjisë”.⁸⁷</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore e Njësisë Kryesore Fakulteti i Edukimit” (2019), Neni 42, pika 6, përcaktohet se: <i>Për programe studimi të akredituara, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 për qind dhe t’i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe për to njoftohet Ministria e Arsimit, jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.</i>⁸⁸</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 15, pika 8, shprehet se: <i>Programet e reja dhe ndryshimet në masën mbi 20 për qind të përmbajtjes së programeve të studimit të akredituara, të shprehur në kredite, hartohen nga njësia bazë, shqyrtohen nga Dekanati, miratohen në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim Ministrisë së Arsimit.</i>⁸⁹</p>

⁸⁶ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

⁸⁷ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf

⁸⁸ Evidenca_Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;


⁸⁹ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

	<p>Për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës, me Urdhër Nr.7238/1, datë 31.08.2018 “Për miratimin e riorganizimit të programeve të Fakultetit të Edukimit (UAMD)”, programi i studimit i marrë në vlerësim, pësoi disa ndryshime në kurrikul, deri në 20%, duke përfshirë edhe ndryshimin e emërimit nga “Master i Shkencave” për Mësimdhënie në Psikologji Sociologji, në “Master i Shkencave” në Mësues i Shkencave Sociale.⁹⁰</p> <p>Institucioni deklaroi në RVB (2023), se: Në fillim të çdo viti akademik janë konsideruar dhe marrë në shqyrtim të gjitha propozimet e bëra nga lektorët përgjegjës apo studentët për ndryshimet e mundshme të kurrikulës të studimeve dhe programeve lëndore, në përputhje me zhvillimet aktuale, nevojat e studentëve dhe përditësimin e literaturës. Dosja e plotë e programit është e arkivuar pranë departamentit të Psikologjisë në shqip dhe anglisht.⁹¹</p> <p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit (2020-2025), institucioni ka përcaktuar parimet udhëzuese për zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe liston masat bazë që duhet të merren, në mënyrë që Departamenti i Psikologjisë të përballojë sfidat e së ardhmës në lidhje me tregun e punës, profesionin e rregulluar të mësuesit dhe zhvillimin në përputhje me Masterin e Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (fq.3).⁹²</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale është i detajuar, përgjithësisht informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron të pasqyrohen të gjitha të dhënat teknike të kërkuara në formatin e Planit Mësimor për të siguruar informacion më të plotë dhe të qartë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

⁹⁰ Dokumenti “Shkresë Nr.7238/1, datë 2018-08-31” e-ASCAL.

⁹¹ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf

⁹² Evidenca_Nr.9_Plani i zhvillimit strategjik të Programit MSH MSHS 2020-2025.pdf



39



Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Sipas dokumentit “Rregullore e Departamentit të Psikologjisë” (2019), Neni 32, shprehet se: <i>Programet e studimeve organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i>⁹³</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, i referohet nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është riorganizuar në vitin 2018, dhe miratuar nga MAS me shkresë Nr.7238/1 prot, datë 31.08.2018 “Për miratimin e riorganizimit të programeve të Fakultetit të Edukimit (UAMD)”. Gjatë këtij procesi, emërtimi i programit pësoi ndryshime në kurrikul, deri në 20%, duke përfshirë edhe ndryshimin e emërimit nga Master i Shkencave për “Mësimdhënie në Psikologji-Sociologji”, në Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale”.⁹⁴</p> <p>Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve mësimore në programin e studimit master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”, shpërndarja e lëndëve dhe praktikës profesionale, bëjnë të mundur që studentët të thellojnë njohuritë e tyre psiko-edukative të njohurive dhe aftësive të tyre praktike si mësimdhënës, në përputhje me kurrikulën e ciklit të lartë të mesëm për shkencat shoqërore dhe në lidhje me kërkesat e tregut dinamik të punës, dukë i bërë ata më të aftë për këtë treg.⁹⁵</p> <p>Programi i riorganizuar synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Gjithashtu, ai synon të japë kontribut në zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies, si dhe komunikimit me fëmijët dhe të rinjtë. Përfundimi me sukses i këtij programi e çon studentin në tregun e punës, pra në fazën tjetër, në zhvillimin e praktikës profesionale dhe më tutje, në provimin e shtetit, për t’u pajisur me licensën për ushtrimin e profesionit të mësuesit.⁹⁶</p>

⁹³ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

⁹⁴ Dokumenti “Shkresë Nr.7238/1, datë 2018-08-31” e-ASCAL.

⁹⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf


⁹⁶ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

	<p>Referuar dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 5, gërma (a), përshkruan se: <i>Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” realizohet për një periudhë 2 vjeçare me kohë të plotë, e cila merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në këtë fushë, dhe jo më pak se 120 kredite Evropiane (ECTS).</i>⁹⁷</p> <p>Për sa më sipër, dëshmohet se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut në fushën e mësuesisë për lëndët shoqërore.</p> <p>Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 23, fq. 80, në dokumentin “Evidenca Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf”, tregojnë se numri i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën, vjen duke u ulur nga viti në vit, në shifrat si më poshtë,⁹⁸</p> <table border="1" data-bbox="628 920 1485 1122"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të punësuar në përputhje me diplomën.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1 student</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>0 student</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>12 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>12 studentë</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Student të punësuar në përputhje me diplomën.	2022-2023	1 student	2021-2022	0 student	2020-2021	12 studentë	2019-2020	12 studentë
Viti akademik	Student të punësuar në përputhje me diplomën.										
2022-2023	1 student										
2021-2022	0 student										
2020-2021	12 studentë										
2019-2020	12 studentë										
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Mësuesi i Shkencave Sociale, vërehet se programi i studimit është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lidhur me shpërndarjen e lëndëve/moduleve sipas kategorive përkatëse, vërehet se lëndët/modulet janë kategorizuar <u>nga A në F, dhe jo nga A-E, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, i ndryshuar.</u></p> <p>Në Planin Mësimor, gjenden lëndë të kategorisë C, të tilla si lëndët me zgjedhje, që janë kategorizuar në kategorinë D, dhe lënda praktikë profesionale e kategorisë D, është grupuar në kategorinë E. Ndërsa, provimi/teza e diplomimit e kategorisë E, është grupuar në kategorinë F.⁹⁹</p>										

⁹⁷ Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

⁹⁸ Evidenca Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf

⁹⁹ Evidenca Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf




	<p>Bazuar në përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, i ndryshuar, lëndët/modulet e shpërndara për çdo vit akademik të Planit Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, ¹⁰⁰ rezultojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Në vitin e I-rë akademik zhvillohen 12 lëndë/60 kredite:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 3 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 15 kredite); - 5 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/25 kredite); - 4 lëndë e kategorisë C (nëndisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje / 20 kredite); ▪ <u>Në vitin e II-të akademik zhvillohen 7 lëndë/60 kredite:</u> <ul style="list-style-type: none"> - 3 lëndë e kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 18 kredite); - 2 lëndë e kategorisë C (nëndisiplina dhe lëndë me zgjedhje/ 12 kredite); - 1 lëndë e kategorisë D (praktika 12 kredite); - 1 lëndë e kategorisë E (diploma/ 18 kredite); <p>Në dokumentin Plani Mësimor, praktika profesionale rezulton me 12 kredite/300 orë. Në formatin e këtij plani mësimor nuk janë pasqyruar të dhëna për shtrirjen/periudhën kohore për realizimin e 300 orëve të praktikës profesionale, si dhe nuk gjendet ndonjë shënim në fund të planit për të informuar rreth saj. ¹⁰¹</p> <p>Referuar të dhënave në tabelën nr. 10 të dokumentit <i>Evidenca_Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf</i> (fq. 38), në Planin Mësimor të programit të studimit Msc MSHS (2022-2023), kostatohet se praktika profesionale (kategoria D) realizohet në vitin e dytë, semestri i katërt, me 0 orë leksione në auditor, 75 orë seminare në auditor dhe në kolonën fundit “<i>gjithsej</i>”, shënohet 45 orë në auditor. ¹⁰²</p> <p><u>GVJ: vëren</u> se të dhënat që gjenden në Planet Mësimore të shqyrtuara më lartë, janë të paplota dhe nuk informojnë qartësisht për shpërndarjen dhe realizimin e 300 orëve mësimore të parashikuara për lëndën e praktikës profesionale.</p> <p>Sipas “<i>Rregullores së praktikave mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë</i>” (2019), Neni 4, shprehet se “<i>Në nivel master, praktika zhvillohet në semestrin e katërt, për një periudhë 3 mujore, ku studenti duhet të plotësoj 75 orë</i>”. Neni 8/c, përcakton se: “<i>Për studentët që frekuentojnë programet Master Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” dhe “Mësimdhënie në Psikologji-Sociologji”,</i></p>
--	--

¹⁰⁰ *Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf*

¹⁰¹ *Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;*

¹⁰² *Evidenca_Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf*

praktika do të kryhet pranë shkollave të mesme publike apo private". Neni 9/g, përshkruan se: "Pas miratimit, studenti paraqitet në institucionin përkatës dhe nis procesin e praktikës, i cili zgjat 3 muaj dhe ka si kriter që studenti të kryej 75 orë fizike në institucion".¹⁰³

Nisur nga përcaktimet e mësipërme të *Rregullores së praktikave mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë*" (2019), mund të rezultojë se lënda Praktikë Profesionale e vlerësuar me 12 ECTS/ 300 orë mësimore, zhvillohet vitin e dytë, semestri i dytë, zgjat 3 muaj/ 12 javë/ mesatarisht 20 orë mësimore në javë (nëse studenti realizon 4 orë mësimore x 5 ditë në një javë) = 240 orë në auditor dhe 60 orë punë individuale e studentit.

Por, shqyrtimi i syllabusit të lëndës Praktikë Profesionale, nxori në pah se ngarkesa lëndore është vlerësuar me 5 ECTS/125 orë mësimore, nga të cilat 60 orë mësimore realizohen në auditor (45 leksione dhe 15 seminare), duke nënkuptuar se 65 orë realizohen si orë pune individuale e studentit. Lënda Praktikë Profesionale zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë.¹⁰⁴

GVJ rekomandon të qartësohen dhe rakordohen të dhënat në dokumentet e shqyrtuara më sipër, lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe realizimin në terren të lëndës Praktikë Profesionale.

Diploma (18 kredite/450 orë mësimore individuale) realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë.¹⁰⁵

Sipas dokumentit "*Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale*" (2019), Neni 20, pika 2, shprehet se "*Diplomimi në Masterin e Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" bëhet me mbrojtjen e një teze diplome".¹⁰⁶*

Punimi i diplomës është një punë kërkimore e cila realizohet në mënyrë individuale dhe të pavarur për një çështje a problem nga fusha e arsimit dhe e edukimit në përgjithësi e cila paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të programit. Ai synon të demonstrojë aftësitë analitike të studentit, aftësitë e tij për të integruar perspektivat teorike me materiale të ndryshme empirike, për të shprehur një qëndrim të caktuar profesional, provon zbatimin e një zgjidhjeje bazuar në një evidencë

¹⁰³ Evidenca Nr.41 Rregullore për praktikat mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p;

¹⁰⁴ Silabuset MSH MSHS bashke.pdf (fq.117);

¹⁰⁵ Evidenca Nr.28.1 Plani Mësimor Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;

¹⁰⁶ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;

	<p>empirike, identifikon dhe strukturon probleme të reja, zhvillon zgjidhjen e një problemi ose prezanton ide dhe teori të reja.¹⁰⁷</p> <p>Për sa më lartë, GVJ vlerëson se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Megjithatë, <u>GVJ sjell në vëmendje të institucionit</u> nevojën për të rishikuar disa aspekte teknike lidhur me të dhënat/elementët informuese që duhet të pasqyrohen në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, përfshi edhe elementet informuese për lëndën Praktikë Profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Referuar dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 14 “Struktura akademike e studimeve”, pika 1, shprehet se: “Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” realizohet me kohë të plotë, në dy vite akademike, i ndarë në katër semestra, gjatë të cilëve studenti fiton 120 ECTS. Programi është në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamentet Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji, dhe është miratuar me vendim të senatit akademik të UAMD”. Neni 15 “Për komponentët mësimorë të programit”, specifikon se “Veprimtaria mësimore e këtij programi kryhet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike, të tilla si: leksione, seminare, detyra kursi, projekte, prezantime, etj. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 80%”.¹⁰⁸</p> <p>Sipas Planit Mësimor, praktika profesionale zë 10% të totalit të krediteve në programin e studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, e vlerësuar me 12 kredite / 300 orë mësimore.¹⁰⁹</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin e GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të marrë në vlerësim, u shpjegua se “Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t’u punuar në auditor ose jashtë auditorit, si dhe teza e diplomimit synojnë që të lidhin ngushtësisht teorinë me praktikën”.</p> <p>Për sa më sipër, dëshmohet se struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.</p>

¹⁰⁷ Evidenca Nr.35 Manual për punimin e diplomës master në Fakultetin e Edukimit.pdf; (fq. 4).

¹⁰⁸ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf.

¹⁰⁹ Evidenca Nr.28.1 Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), ¹¹⁰ Neni 9, pikat 4, 6 dhe 7, respektivisht shprehen se:</p> <p>(4) <i>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS. Me qëllim lehtësimin e integritit të studentëve të diplomuar pranë UAMD-së në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar, ofrohet edhe konvertimi në kredite UsCr. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>i) Lëndët bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;</i> <i>ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;</i> <i>iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;</i> <i>iv) Lëndë plotësuese, fokusuar në përfitim të aftësive dhe kompetencave praktike në mësimdhënie, e zhvilluar pranë institucioneve të arsimit parauniversitar publik apo jo publik, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;</i> <i>v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës. Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.</i> <p>(6) <i>Lëndët e detyrueshme përfshijnë veprimtari shkencore të fushës përkatëse të diplomimit ose të formimit të përgjithshëm, të cilat janë të përcaktuara në kurrikulat mësimore.</i></p> <p>(7) <i>Lëndët me zgjedhje përfshijnë veprimtari shkencore të fushës përkatëse të diplomimit, të cilat janë të orientuara drejt një specializimi më të ngushtë, të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga njësi bazë, dhe koherente me programin e</i></p>
---	--

¹¹⁰ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf.

studimit, të realizuara këto gjatë 2 viteve akademike të programit të studimit.

Referuar Planin Mësimor, ¹¹¹ vërehet se veprimtaritë formuese janë ndarë gabimisht në kategori nga A-F, të shprehura në %, të cilat mund të përmblihen dhe paraqiten në kategori nga A-E, si më poshtë:


Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018, (% e krediteve)	Të dhënat në Planin Mësimor "Msc në Mësuesi per Shkencat Sociale"	
			ETCS	%
A	Lëndë bazë	5%-10%	15	12.5%
B	Lëndë karakterizuese	50%-60%	43	36%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	32	26.5%
D	Lëndë plotësuese	10%	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-15%	18	15%
	Totali		120	100%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në tabelën e mësipërme për Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, i ndryshuar Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave, nxjerr në pah se:

- Gjenden më shumë kredite për lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 12.5% të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Gjenden më pak kredite për lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese) në Planin Mësimor të shprehura në 36% të krediteve, në raport me 50% - 60% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;

¹¹¹ Evidenca_Nr.28.1_Plani Mësimor Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale".pdf

	<ul style="list-style-type: none"> - Sipas përcaktimeve të VKM, Nr. 41/2018, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e programit të marrë në vlerësim, përqindja totale e krediteve për lëndë të kategorive A dhe B rezulton të jetë 48.5%; - Gjithashtu, gjenden <i>më shumë kredite për lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore)</i> në Planin Mësimor të shprehura në 26.5% të krediteve, në raport me 12% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; - Praktika profesionale (kategoria D) zë 10 % të totalit të krediteve, vlerësuar me 12 kredite; - Përsa i përket provës finale, rezultojnë 15% kredite të akorduara, në përputhje me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM nr. 41/2018; <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ risjellë në vëmendje të institucionit sugjerimin për të rishikuar Planin Mësimor lidhur me ndarjen sipas veprimtarive formuese nga A-E, si dhe shpërndarjes së ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, me qëllim që të pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar);</u></i></p> <p>Pavarësisht, lapsuseve/gabimeve teknike të referuara më lartë lidhur me ndarjen dhe ngarkesën në kredite sipas veprimtarive formuese, GVJ vlerëson se raportet midis formimit teorik (90%) dhe praktik (10%) mundësojnë arritjen e <u>objektivave kryesore formuese</u>, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 6, specifikohet se: <i>Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të nivelit të dytë “Mësues i Shkencave Sociale” janë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Të përgatisë mësues në arsimin paraniversitar në shkencat shoqërore dhe humane.</i> 2. <i>Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla.</i>
--	--




	<p>3. <i>Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor;</i>¹¹²</p> <p>Procedurat për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve janë parashikuar në Nenin 44 të dokumentit “<i>Rregullore e Departamentit të Psikologjisë</i>” (2019). Ndërsa procedurat për mobilitetin studentor në kuadrin të projekteve e programeve ndërkombëtare, janë përshkruar në Nenin 47 të kësaj Rregullore.¹¹³</p> <p>Në Tabelën nr. 20, fq.76, <i>Evidenca_Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf</i>; rezultojnë pjesmarrës në projekte ndërkombëtare: 1 student në Universitetin e Janit, Spanjë; 1 student në Universitetin e Palermos; 1 student në Universitetin La Sapienza.¹¹⁴</p> <p>Kjo praktikë e mirë duhet të zgjerohet më tej, por <u><i>nuk ka informacion nëse studentët pjesëmarrës i përkasin programit të studimit të marrë në vlerësim, apo ndonjë programi tjetër.</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Neni 15, i <i>Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale</i> (2019),¹¹⁵ përcakton se: (5) Silabusi hartohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kërkesat e statutit të UAMD-së dhe sipas formatit të parashikuar në aneksin bashkëngjitur kësaj rregulloreje (Shtojca 1). (6) <i>Syllabuset organizohen në module, lëndë dhe përmbajnë informacionin e mëposhtëm:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> a) titullin e lëndës; b) objektivat e lëndës; c) nëndarjen në module ose në çështje; d) raportin e elementëve të orëve mësimore në auditor; dh) kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës; e) formën e kontrollit të dijeve; ë) numrin e krediteve të lëndës dhe moduleve përkatëse të saj, ngarkesën përkatëse të studentit në auditor dhe si punë të pavarur, mënyrën e vlerësimit për secilin modul dhe gjithë lëndën, etj; f) literaturën kryesore dhe ndihmëse; g) titullarin e lëndës. <p>Referuar programeve lëndore/syllabuseve vërehet se të gjitha respektojnë formatin e miratuar, i cili përputhet plotësisht me elementet e modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41,</p>

¹¹² *Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf*

¹¹³ *Evidenca Nr.12 Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf*;

¹¹⁴ *Evidenca Nr.211 Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf*;

¹¹⁵ *Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf*.

	<p>datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, Pika 2.8 “Programi lëndor (syllabus-et)”, (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, (Shtojca 3 “Programi i lëndës”). Lidhur me elementin e literaturës bazë të detyruar dhe të rekomanduar, janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të saj. Gjenden syllabuse që kanë përfshirë botime të 5 viteve të fundit. (Shiko fq. 48, 65, 103; <i>Syllabuset MSH MSHS bashke.pdf</i>). Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të vijojnë përpjekjen për të përditësuar literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar. ¹¹⁶</p> <p>Në RVB (2023), institucioni deklaron se: <i>Departamenti përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” i kushton rëndësi të vecantë përditësimit dhe miratimit të programeve të lëndëve në fillim të çdo viti akademik. Syllabuset përgatiten duke respektuar formatin tip dhe lirinë akademike.</i> ¹¹⁷</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit dëshmon se garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Në dokumentin Rregullore e Departamentit të Psikologjisë (2019), Neni 35, pika 2, specifikohet se: <i>Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Studimet në këtë program përmbillen me tezë diplome dhe studentët pajisen me diplomë në fushën e arsimimit të kryer.</i> ¹¹⁸</p> <p>Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 7, shprehet se: <i>Programi është menduar për studentët, të cilët kanë përfunduar programin bachelor tre ose katër vjeçar në degë të shkencave sociale ose humane dhe me mesatare të parashikuar sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi. Ky program është në përshtatje me kërkesat dhe kurrikulën e sistemit parauniversitar për mësimdhënien në shkencat sociale dhe ofron:</i></p> <p>a) <i>Studime të thelluara për mësimdhënien dhe mësimnxënien në shkencat sociale.</i></p>

¹¹⁶ *Syllabuset MSH MSHS bashke.pdf*,

¹¹⁷ *RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf*

¹¹⁸ *Evidenca Nr.12 Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf*;

	<p>b) <i>Formim profesional për mësimdhënien në fushat Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar në sistemin e arsimit parauniversitar.</i></p> <p>c) <i>Studime të thelluara në mësimdhënie dhe mësimnxënie sipas metodave bashkëkohore.</i>¹¹⁹</p>													
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Përmbajtja teorike dhe organizimi praktik i lëndëve mësimore dhe praktikës profesionale në këtë program studimi, inkurajon studentët të vijojnë studimet e kualifikimet e mëtejshme dhe punësimin e tyre, duke iu përshtatur nevojave të tregut.</i>¹²⁰</p> <p>Institucioni dëshmon për një numër studentësh praktikantë dhe një alumni/ish i diplomuar i punësuar, por pa specifikuar pozicionin/vendin e punës.¹²¹</p> <p>Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 23, fq. 80, (<i>Evidenca_Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf</i>), tregojnë se numri i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën, vjen duke u ulur nga viti në vit, në shifrat si më poshtë:¹²²</p> <table border="1" data-bbox="635 1070 1493 1272"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Student të punësuar në përputhje me diplomën.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1 student</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>0 student</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>12 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>12 studentë</td> </tr> </tbody> </table>				Viti	Student të punësuar në përputhje me diplomën.	2022-2023	1 student	2021-2022	0 student	2020-2021	12 studentë	2019-2020	12 studentë
Viti	Student të punësuar në përputhje me diplomën.													
2022-2023	1 student													
2021-2022	0 student													
2020-2021	12 studentë													
2019-2020	12 studentë													
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Megjithatë, GVJ tërheq vëmendjen për të rishikuar disa aspekte teknike, të lidhura kryesisht me të dhënat informuese që duhet të pasqyrohen në Planin Mësimor. GVJ gjykon se standarti permbushet plotësisht</i></p>													
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>											

¹¹⁹ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;

¹²⁰ RAPORTI VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf

¹²¹ Evidenca Nr.70 Informacion mbi punësimin e të diplomuarve Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Social.pdf; Evidenca Nr.69 Të dhëna nga Alumni mbi punësimin e të diplomuarve, programet master FE, 2021- 2022.pdf;

¹²² Evidenca Nr.211 Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf;

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës, me Urdhër Nr.7238/1, datë 31.08.2018 “Për miratimin e riorganizimit të programeve të Fakultetit të Edukimit (UAMD)”, programi i studimit i marrë në vlerësim, pësoi disa ndryshime në kurrikul, deri në 20%, duke përfshirë edhe ndryshimin e emërimit nga “Master i Shkencave” për Mësimdhënie në Psikologji Sociologji, në “Master i Shkencave” në Mësues i Shkencave Sociale.¹²³</p> <p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit të marrë në vlerësim dhe përshtatjen e tij sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, institucioni ndjek procedura të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse. Sipas dokumentit “Rregullore e Departamentit të Psikologjisë” (2019) Neni 88, shprehet se: <i>Vlerësimi i Programeve të studimit kryhet në fund të çdo viti nga grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</i>¹²⁴</p> <p>Përmirësimi i programit të studimit udhëhiqet nga parimi i cilësisë, i cili gjen shprehje në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 8, pika 3, ku përshkruhet se: <i>Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës, si në aspektin e kërkesave edhe të pritshmërive, të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Ai gjithashtu nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së programit Masterit të Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.</i></p> <p>Sipas Nenit 9, të kësaj Rregullore, <i>Programi Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” është strukturë mësimore-kërkimore që vepron brenda Departamentit të Psikologjisë, Departamentit të</i></p>

¹²³ Dokumenti “Shkresë Nr.7238/1, datë 2018-08-31” e-ASCAL.

¹²⁴ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

51

	<p><i>Sociologjisë dhe Departamentit të Pedagogjisë, pranë Fakultetit të Edukimit.</i> ¹²⁵ Këto departamente bashkëpunojnë midis tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit të marrë në vlerësim. Institucioni dëshmon se tre departamentet përgjegjëse kanë institucionalizuar këtë kooperim, përmes aktit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, me Nr. 297 Prot., datë 15.10.2020. Sipas Nenit 5 të këtij dokumenti, deklarohet se: <i>Marreveshja e bashkëpunimit do të zgjasë për aq kohë sa do të jetë aktiv ky program studimi nga data e nënshkrimit nga të treja palët.</i> ¹²⁶</p> <p>Në RVB (2023), deklarohet se: <i>Institucioni njofton dhe garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve të programeve master në panairin e punës si dhe në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve apo të ndërveprimit praktik me institucionet partnere, në funksion të transferimit të njohurive, të punësimit të tyre dhe përmirësimit të programit. Në këtë kontekst, gjatë këtyre takimeve departamentet konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</i> ¹²⁷</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se: <i>Departamenti i Psikologjisë, Departamenti i Pedagogjisë dhe Departamenti i Sociologjisë, në Fakultetin e Edukimit, konsultohen vazhdimisht për ecurinë e programit të studimit, shkëmbejnë informacione, zhvillojnë aktivitete me interes të përbashkët, si dhe diskutojnë dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i></p> <p>Gjithashtu, stafi akademik tregoi se: <i>Bashkëpunimi i UAMD/FE-së me institucionet partnere për praktikën, kanë qënë frytdhënëse për të diskutuar mbi çështje të përmbajtjes së programit dhe sfidat që ndeshen në tregun e punës. Këto diskutime kanë shërbyer për të analizuar dhe gjykuar mbi nismat e departamentit për të rishikuar, përmirësuar dhe riorganizuar programet që ofron.</i> ¹²⁸</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe</p>	<p>FE/DP nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Institucioni ka</p>

¹²⁵ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf

¹²⁶ Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf;

¹²⁷ RAPORTI VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS.pdf;

¹²⁸ Evidenca_Nr.109 (Relacion për aktivitetet e organizuara në UAMD për vitin akademik 2018-2019, Panairi i Punës, fq.21);

Evidenca_Nr.177.1_Pyetësorët mbi progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet për prakti.pdf;

Evidenca_Nr.177.2_Pyetësorët mbi progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit për praktikën mësimore mes .pdf;

konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.

ngritur dhe vënë në funksion NJSBC, e cila sipas dokumentit “Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë”, Neni 9, pika 1, mes të tjerash shprehet se: *Në funksion të realizimit të funksionit të saj institucional NjBSC-ja duhet: (c) Të përgatisë formularët standardë për çështje të tilla si pyetesorët për studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni.*¹²⁹

Sipas dokumentit “Rregullore e Fakultetit të Edukimit” (2019), Neni 92, pika 1, shprehet se: *Studentët gjatë ndjekjes së studimeve kanë të drejtë (b) të përfaqësohen në organet UAMD-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi; (c) të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes të AUMD-së, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore; (dh) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë.*¹³⁰

Bazuar në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 34, pika 1, shprehet se: *Departamenti i Psikologjisë, në bashkëpunim me departamentet e Sociologjisë dhe Pedagogjisë organizojnë punën për hartimin dhe sigurimin e cilësisë në programin Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”, nëpërmjet anketave, vëzhgimeve dhe kontrollove periodike.*¹³¹

Nga ana tjetër, institucioni ruan kontakte të drejtëpërdrejta dhe të vazhdueshme me studentët nëpërmjet Koordinatorit të programit të studimit (Neni 10 i Rregullores).¹³²

Gjatë vizitës në institucion, koordinatorja e programit të studimit shpjegoi se *ruan kontakte me studentët gjatë periudhës së studimit edhe pas diplomimit të tij. Shpesh ish të diplomuarit, pavaresisht se ku gjenden të punësuar, vijojnë të bashkëpunojnë profesionalisht me pedagogët e tyre në kuadër të aktiviteteve të ndryshme shkencore, workshope, trajnime, etj. Kjo marrëdhënie, u jep mundësi palëve që të diskutojnë profesionalisht për kërkesat e reja në tregun e punës dhe t'i reflektojnë ato në procesin e përmirësimit programit të studimit.*

¹²⁹ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf>;

¹³⁰ [Evidenca_Nr.11_Rregullore_e_Fakultetit_të_Edukimit.pdf](#);

¹³¹ [Evidenca_Nr.15_Rregullore_e_Masterit_Shkencor_“Mësues_i_Shkencave_Sociale”.pdf](#); [Evidenca_Nr.94.1_Vlerësimi_i_studentëve_për_programin_Master_i_Shkencave_“Mësues_i_Shkencave_Sociale”_V.pdf](#);

¹³² [Evidenca_Nr.15_Rregullore_e_Masterit_Shkencor_“Mësues_i_Shkencave_Sociale”.pdf](#);


	<p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Në kontaktet e ngushta me lektorët udhëheqës të tezave të kërkimit, studentët nxiten të jenë aktivë dhe përfshihen në organizimet me natyrë shkencore për të kontribuar me arritjet e tyre empirike përmirësimin e programit dhe përputhjen e tij me nevojat e studentëve dhe tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe Praktikave mban kontakte me studentët e diplomuar, duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Studentët Alumni kanë të drejtën të angazhohen dhe janë të lidhur fortë me universitetin, përmes anëtarësimit në asamble apo bordin drejtues Alumni dhe përmes ndarjes së përvojave dhe arritjeve profesionale.</i> ¹³³</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit të marrë në vlerësim (Urdhër Nr.7238/1, datë 31.08.2018), Fakulteti Edukimit/ Departamenti i Psikologjisë, përshtatën programin e studimit nga “Master i Shkencave” për Mësimdhënie në Psikologji Sociologji, në “Master i Shkencave” në Mësues i Shkencave Sociale. ¹³⁴</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se ky proces i përshtatjes së programit të studimit u parapri fillimisht me studimin dhe analizën e tregut të punës, dhe më tej, në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, agjensi partnere, shoqata dhe institucione të arsimit, procesi u pasurua me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e mësimdhënies së shkencave sociale dhe qytetarisë në sistemin parauniversitar.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë UAMD/FE dhe njësia përgjegjëse për programin e marrë në vlerësim, dëshmon se nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p> <p>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

¹³³ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf; Evidenca_Nr.163_Kalendari i aktiviteteve, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës 2019-2022, Shoqa.pdf;

¹³⁴ Dokumenti “Shkresë Nr.7238/1, datë 2018-08-31” e-ASCAL.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në dokumentin “Plani i zhvillimit strategjik të FE, 2020-2025”, deklarohet se:</p> <p><i>Fakulteti i Edukimit, në veprimtarinë e tij synon të arrijë standartet akademike më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare për një përgatitje sa më të mirë të studentëve. Misioni i Fakultetit të Edukimit është përgatitja e individëve të kualifikuar në shkencat e edukimit dhe fushave të ngjashme me to për tregun e punës. Pjesë e rëndësishme e misionit të Fakultetit të Edukimit është të ndihmojë studentët në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe dispozitave të nevojshme për t’u bërë mësues profesionistë, efektive dhe bashkëkohorë në një shoqëri që është gjithnjë në ndryshim.</i></p> <p>Vizioni i Fakultetit të Edukimit përqëndrohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të jetë pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, të përgatitë studentë të denjë për tregun e punës, të aftë të influencojnë botën akademike dhe të përballojnë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare.</i> - <i>Të gërshetojë teorinë me praktikën në kushte dhe mundësi bashkëkohore, për një përgatitje sa me efektive të studentëve;</i> - <i>Të nxisë tek studentët dashurinë dhe respektin ndaj vendit të tyre, duke u mbështetur në baza të etikës profesionale, vlerave universale, si edhe përfitim të një kulture të gjerë pluraliste në mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave... (fq. 4-5).¹³⁵</i> <p>Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 6, përcakton se: Masteri i Shkencave “ Mësues i Shkencave Sociale” synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të nivelit të dytë “ Mësues i Shkencave Sociale” janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përgatisë mësues në arsimin paranuiversitar në shkencat shoqërore dhe humane; 2. Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla;


¹³⁵ Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Edukimit, 2020-2025.pdf;

	<p>3. Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor;</p> <p>Neni 7 i këtij dokumenti, shprehet se: Ky program është në përshtatje me kërkesat dhe kurrikulën e sistemit parauniversitar për mësimdhënien në shkencat sociale dhe ofron:</p> <p>d. Studime të thelluara për mësimdhënien dhe mësimnxënien në shkencat sociale;</p> <p>e. Formim profesional për mësimdhënien në fushat Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar në sistemin e arsimit parauniversitar;</p> <p>f. Studime të thelluara në mësimdhënie dhe mësimnxënie sipas metodave bashkëkohore;¹³⁶</p> <p>Në dokumentin “Plani i zhvillimit strategjik të programit MSH MSHS, 2020-2025” janë parashtruar prioritetet e zhvillimit strategjik të programit të studimit të marrë në vlerësim (fq.5-6) të cilat përputhen me objektivat madhorë të UAMD/FE.¹³⁷</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Programi është strukturuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave strategjike për zhvillimin e arsimit parauniversitar në vend, të cilat bazohet në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave shkencore të thelluara, në kuadër të zhvillimit të mësimdhënies.</i>¹³⁸</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit</p>	<p>Në dokumentin “Kodi etikës të UAMD” (2012, i ndryshuar në 2017), Neni 5, shprehet se: (1) <i>Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkime, në punime shkencore dhe në metodologjinë e mësimdhënies. Personeli akademik duhet t’i permbahet përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performancë të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe</i></p>

¹³⁶ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf);

¹³⁷ Evidenca Nr.9 Plani i zhvillimit strategjik të Programit MSH MSHS 2020-2025.pdf;

¹³⁸ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




<p>akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët.¹³⁹</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale” (2019), Neni 8, shprehet se: (1) Liria akademike garantohet nëpërmjet të drejtës për të organizuar veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimore-shkencore, sipas nevojave të programit, për të promovuar personelin akademik dhe çënohet kur ka ndërhyrje të jashtme, të çensurës apo pengesave për të zhvilluar veprimtarinë akademike. Liria akademike është parakusht i zhvillimit të mendimit kritik, i avancimit të dijeve dhe zhvillimit intelektual.¹⁴⁰</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Fakulteti i Edukimit dhe departamentet përgjegjës të organizimit të programit të studimit garanton dhe mundëson lirinë akademike të stafit akademik, në hartimin dhe planifikimin e kurrikulës së programit, objektivave dhe literaturës së nevojshme për zhvillimin e kurseve të studimit, duke pasur parasysh interesat kërkimore dhe fushat e studimit të stafit. Institucioni promovon ideimin e financimin e projekteve kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe përfshirjen e stafit në projektet ndërkombëtare Erasmus me fokus mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.¹⁴¹</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore-shkencore. Për përmbushjen e këtij kriteri, FE/DP udhëhiqet nga “Kodi i Etikës së UAMD (2017)”, Neni 5 pika 3, që përcakton se: <i>Pesoneli akademik duhet të përmirësojë vazhdimisht metodologjinë, në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t’ju shpjegojë atyre metodat e vlerësimit.</i>¹⁴²</p> <p>Sipas Statutit të UAMD, Neni 82, pika 4, shprehet se: <i>Çdo anëtar i personelit akademik të universitetit, si dhe çdo student i tij, ka të drejtë të zhvillojë aktivitet kërkimor shkencor dhe inovativ. Veprimtaria kërkimore-shkencore e krijuese rregullohet përmes rregullores së universitetit dhe rregulloreve të njëjësive kryesore dhe njëjësive bazë të tij, bazuar në këtë statut dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>¹⁴³</p>


¹³⁹ Evidenca Nr.45 KODI ETIKËS UAMD.pdf;

¹⁴⁰ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf);

¹⁴¹ RAPORT I VLERËSIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁴² Evidenca Nr.45 KODI ETIKËS UAMD.pdf;

¹⁴³ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>




57



	<p>Në RVB (2023), institucioni deklaroi se studentët angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, përgjithësisht me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - detyra individuale apo projekte në fund të çdo kursi ku studentët nxiten të të hulumtojnë në literaturë ose në terren; - temën e diplomimit, në fund të përfundimit të studimeve, ku studentët duhet të angazhohen për 1 semestër në hulumtimin në terren, me udhëheqjen e lektorëve; - studentët dhe alumni informohen online në faqen zyrtare të institucionet dhe rrjete sociale, mbi thirrjet më të fundit për pjesëmarrje në konferenca studentore dhe ato në rang universiteti, në të cilat inkurajohet pjesëmarrja me kontributin e tyre studimor apo si dëgjues e bashkëorganizues;¹⁴⁴ <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik dëshmoi se studentët e programit të marrë në vlerësim angazhohen nga pedagogët e tyre në detyra kursi me karakter studimor me qëllim zhvillimin e aftësive për të hulumtuar dhe shqyrtuar literaturën përkatëse. Gjithashtu, studentët angazhohen në realizimin e projektit kërkimor në kuadër të punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. FE/DP përfshin studentët në aktivitetet shkencore të organizuara në nivel fakulteti, në projekte mobiliteti dhe veprimtari të ndryshme studimore, me përfshirje edhe të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Referuar Statutit të UAMD, Neni 82, shprehet se: (5) <i>Veprimtaria kërkimore shkencore brenda universitetit planifikohet dhe mbështetet financiarisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kriteret për mbështetjen financiare miratohen nga Senati Akademik. Shpallja e konkurseve për mbështetje financiare bëhet në muajin nëntor dhe Brenda muajit prill të vitit pasqrdhës bëhet shpallja e fituesve për financim të plotë ose të pjesshëm nga fondet e universitetit.</i> (6) <i>Personeli akademik, individualisht apo në grup, ka të drejtën që të aplikojë për mbështetje apo financim nga universiteti, si dhe nga organizmat shtetërore apo private për realizimin e projekteve kërkimore-shkencore.</i> (7) <i>Personelit akademik, në të gjitha rastet i garantohet e drejta e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare, në të cilat është përzgjedhur nga komisioni organizator dhe është përfshirë në programin e konferencës. Në këto raste njoftohet drejtuesi i njësisë bazë, duke bashkëngjitur njoftimin dhe ftesën, ose programin drejtuesit të njësisë kryesore.</i> ¹⁴⁵</p>

¹⁴⁴ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁴⁵ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>





	<p>Sipas dokumentit “Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore të zhvilluara në UAMD (2021), Neni 5, përcakton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me propozim të Senatit Akademik, Bordi I Administrimit përcakton fondet dedikuar kërkimit shkencor në UAMD, të ndara në dy grupe: <ul style="list-style-type: none"> a. Fonde për financimin e projekteve kërkimore – shkencore; b. Fonde për financimin e organizimit apo pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore-shkencore (konferenca, workshope, etj.) dhe botimin e artikujve në revista me impact factor apo të indeksuara ne Scopus;¹⁴⁶ <p>Në RVB (2023), institucioni deklaron se: <i>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë, si përgjegjës kryesor për programin e studimit mbështetet financiarisht nga institucioni. Bordi i Administrimit përcakton fondet dedikuar kërkimit shkencor në UAMD për financimin e projekteve/aktiviteve kërkimore-shkencore dhe për botimin e artikujve në revista me impakt faktor apo te indeksuara. Stafii akademik mund të marrë pjesë në projekte të financuara nga institucioni dhe kryen aktivitetet kërkimor shkencor jashtë ngarkesës së tij të parashikuar në kontratën e punës dhe paguhet me honorare sipas përcaktimit në kostot financiare të projektit.</i>¹⁴⁷</p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, garanton orientim në fushën përkatëse të studimeve dhe kërkimit shkencor. Programi synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Programi është hartuar në përshtatje me kërkesat dhe kurrikulën e sistemit parauniversitar për mësimdhënien në shkencat sociale, në fushat Psikologji - Sociologji - Filozofi - Edukim qytetar në sistemin e arsimit parauniversitar.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>GVJ gjykon se standarti permbushet plotesisht</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

¹⁴⁶ Evidenca Nr.47 Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore të zhvilluara në UAMD.pdf

¹⁴⁷ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Njësia përgjegjëse që ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, ngre dhe mbështet grupet lëndore/mësimore, kërkimore-shkencore të departamentit, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Departamentit të Psikologjisë (2019), Neni 15, pika 1, që shprehet se: <i>Grupet mësimore, kërkimore-shkencore të Departamentit të Psikologjisë ngrihen në funksion të numrit të anëtarëve të Departamentit</i>, si dhe Neni 16, pika 1, që shprehet se: <i>Departamenti në përputhje me numrin e personelit akademik, fushat kërkimore shkencore, disiplinat, profilet, ciklet e studimit propozon grupet mësimore e kërkimore. Departamenti me mbledhje të posaçme propozon ndarjen e grupeve mësimore kërkimore si dhe lektorët përkatës duke ju referuar kryesisht profilit dhe vijueshmërisë së studimeve si dhe preferencës.</i>¹⁴⁸</p> <p>Departamenti i Psikologjisë dëshmon se siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore brenda fakultetit, si Departamenti i Pedagogjisë dhe Departamenti i Filozofisë, me qëllim realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.¹⁴⁹</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Stafi akademik i departamenteve Psikologji, Sociologji-Filozofi dhe Pedagogji, të përfshirë në programin e studimit realizon kërkim shkencor në fushat prioritare të edukimit dhe ato sociale.</i>¹⁵⁰</p> <p>Si pjesë përbërëse e FE/UAMD, Departamenti i Psikologjisë dëshmon se është përfshirë në bashkëpunime ndër-institucionale, me struktura të tjera mësimore kërkimore-shkencore, në kuadër të projekteve Erasmus+.¹⁵¹</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Përmes programeve Erasmus+ dhe marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, siguron bashkëpunimin ndër-institucional me institucione brenda dhe jashtë vendit për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</i>¹⁵²</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime</p>	<p>Fakulteti i Edukimit/Departamenti i Psikologjisë dëshmon se angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe</p>


¹⁴⁸ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

¹⁴⁹ Evidenca_Nr.27_Marrëveshje bashkëpunimi mes Dep Psikologji, Sociologji dhe Pedagogji për organizimin e .pdf

¹⁵⁰ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁵¹ MSh Mesues i Shkencave Sociale Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.pdf; Evidenca_Nr.172_Informacion mbi projektet ndërkombëtare në UAMD (2016-2021).pdf;

¹⁵² RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




<p>e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>studentët për realizimin e këtyre objektivave. Institucioni dokumenton një sërë marrëveshjes të realizuara në kuadër projektesh me karakter studimor, kërkimor dhe shkencor që angazhojnë personelin akademik dhe studentët e FE/DP.¹⁵³</p> <p>Gjithashtu, Institucioni dëshmon se mbështet financiarisht personelin akademik në publikimin e kërkimit shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me Scopus.¹⁵⁴</p> <p>Në dokumentin “Raporti Vjetor – Veprimtaria Mësimore e Kërkimore Shkencore e FE/UAMD (2021-2022), me të tjerash raportohet se: <i>Fakulteti i Edukimit ka një politikë aktive, në lidhje me kërkimin shkencor, duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me përfshirjen akademike në rrjetet e kërkimit shkencor.</i>¹⁵⁵</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Fakulteti i Edukimit dhe njësitë bazë, për realizimin e objektivave në lidhje me kërkimin shkencor dhe ndërkombëtarizimin, angazhojnë stafin akademik dhe studentët për të zhvilluar dhe marrë pjesë në projekte me natyrë kërkimore shkencore, por edhe në fushata kombëtare e lokale ndërgjegjëzuese e informuese, në përputhje me planin strategjik të institucionit dhe fushat e programeve të kërkimit kombëtar dhe zhvillimit nga AKKSHI.</i>¹⁵⁶</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Fakulteti i Edukimit, gjatë periudhës që mbulon këtë raport vetëvlerësimi, ka organizuar dhe ka qenë bashkëorganizator për një sërë konferenca e aktivitete shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, për të nxitur arritjen e objektivave të programit në përputhje me standardet dhe kriteret e kërkimit shkencor në miratuara në UAMD.</i>¹⁵⁷</p> <p>Në dokumentin “Raporti Vjetor – Veprimtaria Mësimore e Kërkimore Shkencore e FE/UAMD (2021-2022), me të tjerash raportohet se: <i>Gjatë këtij viti akademik Fakulteti i Edukimit organizoi në 25 Mars 2022, Konferencën e shtatë ndërkombëtare me titull “Innovations and</i></p>

¹⁵³ MSh Mesues i Shkencave Sociale Drejtorja e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.pdf;

¹⁵⁴ Evidenca 16 Kerkese per rimbursim botim artikulli ne Scopus.pdf;

¹⁵⁵ Evidenca Nr.133 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf;

¹⁵⁶ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁵⁷ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;





	<p><i>Perspectives of Contemporary Education” në bashkëpunim me: Kibbutzim College, TEL AVIV, Israel, University of Bari “Aldo Moro”, Italy, University of Foggia, Italy, Tagarong Institute of Management and Economics, Russia, AAB College, Pristina, Kosovo, University “Hasan Prishtina”, Kosovo, University of Tetovo, NORTH MACEDONIA, Bitlis Eren University, Turkey, University “Ismail Qemali”, Vlora, , University of Tirana, ,University “Aleksandër Xhuvani” Elbasan,, University “Fan S Noli” Korça. Në këtë konferencë morrën pjesë 119 pjesëmarrës dhe u angazhua i tërë stafi i Fakultetit të Edukimit.¹⁵⁸</i></p> <p>Departamenti i psikologjisë ka zhvilluar veprimtari, takime, fushata ndërgjegjësimi duke përfshirë studentët.¹⁵⁹</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale</i>, formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar të punës. Në dokumentin “<i>Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale</i>” (2019), Neni 6, shprehet se: <i>Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit. Ai gjithashtu synon të japë kontribut në zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies, si dhe komunikimit me fëmijët dhe të rinjtë. Përfundimi me sukses i këtij programi e çon studentin në tregun e punës, pra në fazën tjetër, në zhvillimin e praktikës profesionale dhe më tutje, në provimin e shtetit, për t’u pajisur me licensën për ushtrimin e profesionit të mësuesit.</i></p> <p><i>Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të nivelit të dytë “ Mësues i Shkencave Sociale” janë: (1) Të përgatisë mësues në arsimin paranuiversitar në shkencat shoqërore dhe humane. (2) Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla. (3) Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor;¹⁶⁰</i></p>

¹⁵⁸ Evidenca Nr.133 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf;

¹⁵⁹ Evidenca Nr.88_Kalendari i aktiviteteve V.A. 2022-2023 Departamenti i Psikologjisë.pdf;

¹⁶⁰ Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;




	Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Programi i studimit master i shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" ka kaluar ndër vite në proçese të riorganizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm ... Në këtë mënyrë, programi i studimit ka formuar mësimdhënës në shkencat sociale për arsimin e mesëm të lartë, konkurrues me programet e tjera të mësuesisë në IAL kombëtare.</i> ¹⁶¹
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Departamenti i Psikologjisë, përgjegjës për realizimin e programit të studimit, dëshmon se merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit të Mësuesit, sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Për mbarëvajtjen dhe përditësimin e programit të studimit master i shkencave "Mësues i Shkencave Sociale", Departamenti i Psikologjisë dhe ai Sociologji-Filozofi kanë marrë parasysh dhe kanë zbatuar udhëzimet dhe kërkesat e MAS për të përafuar përmbajtjen e programeve të studimit në fushën e mësuesisë, ofruara nga të gjitha IAL si dhe me Koalicionin për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri dhe më tej me IZHA ... Për të rritur efektivitetin e praktikës profesionale të studentit është hartuar ... rregullorja e zhvillimit të praktikës profesionale ... në përputhje me kërkesat ligjore të urdhrat të MAS për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.</i>¹⁶²</p>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale</i> përputhet me aktet ligjore në vend, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 (i ndryshuar me Ligjin Nr.10357, dt. 16.12.2010, me Ligjin Nr.10470, dt. 13.10.2011 dhe Ligjin Nr.90/2015, dt. 17.07.2014) "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", Nenin 8 të tij që përcakton kriteret për të diplomuarit përpara se të ushtrojnë një profesion të rregulluar, duhet që: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në Urdhrin e Profesionit përkatës, që në rastin e mësuesit janë Drejtoritë Arsimore Rajonale.¹⁶³

¹⁶¹ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁶² RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁶³ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf>

	<p>- Urdhër nr.437, datë 20.07.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.¹⁶⁴</p> <p>Në RVB (2023) Institucioni sqaron se: <i>Programi i studimit master i shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” është në përputhje të plotë me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor Nr. 80/2015, si dhe me vizionin e direktivat europiane në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale, dhe më specifikisht me edukimin fillestar të mësuesve në Europë.</i>¹⁶⁵</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konkludon se programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i></p> <p><i>Arritja e këtij standardi dëshmohet nga dokumentimi i një sërë marrëveshjeve që Institucioni ka realizuar në kuadër projektsh me karakter studimor, kërkimor dhe shkencor që angazhojnë personelin akademik dhe studentët e FE/DP. GVJ gjykon se standarti permbushet plotësisht</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁶⁴ <https://arsimiparauniversitar.gov.al/urdher-nr-437-date-20-07-2022-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-rregulloren-per-organizimin-dhe-zhvillimin-e-pratikave-profesionale-per-profesionin-e-rregulluar-te-mesuesit/>

¹⁶⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. Në dokumentin “Rregullore e Departamenti-t të Psikologjisë” (2019), Neni 48 i tij, shprehet se:</p> <p><i>Në Departamentin e Psikologjisë çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura si më poshtë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Në orë leksione;</i> <i>Në orë seminare;</i> <i>Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët;</i> <i>Në orë ushtrime;</i> <i>Në orë laborator;</i> <i>Në projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup;</i> <i>Në provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare;</i> <i>Në formën e seancave të praktikës profesionale të zhvilluara në auditor, si një komponent mësimor i veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi;</i> <i>Në formën e praktikës profesionale, si veprimtari të tjera të zhvilluara në laboratorë të Departamentit/Fakultetit, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat Departamenti i Psikologjisë /Fakulteti i Edukimit ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe/ose në ente publike dhe private të zgjedhura nga vetë studenti e të dakortësuara me pedagogun përkas të praktikës;</i>

j) Apo çdo formë tjetër të miratuar nga Njësia kryesore.¹⁶⁶

Në dokumentin “Rregullore e Masterit Shkencor Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 16, pika 4, përshkruan se: Ndarja e orëve mësimore sipas elementëve të mësipërme të studimit për çdo kurs, përcaktohet në silabusin e kursit të miratuar nga njësia bazë, në bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës. Në nenin 22 të kësaj Rregullore, “Për format e kontrollit të dijeve, kriteret dhe shkalla e vlerësimit”, specifikohet se: (b) Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm). Format dhe kriteret e vlerësimit për studentin përcaktohen në planin e kursit (silabusin) dhe u bëhen të ditura studentëve.¹⁶⁷

Referuar programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, vërehet se në krye të syllabusit është shënuar ngarkesa mësimore që detajon numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe orët individuale. Në rubrikën “Forma e kontrollit të dijeve”, vërehet se janë shënuar “Frekuentimi” dhe “Kontrolli i vazhdueshëm” që përfshin të dhëna për provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar, shoqëruar me sistemin e vlerësimit të dijeve. Gjendet disa syllabuse të cilat kanë trajtuar në brendi të rubrikës “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit” edhe çështje të metodologjisë së kursit, si: praktikën, ndërtimin e mësimëve tip, ushtrime, diskutimin e miniprojekteve (fq/19) ose format dhe metodat kryesore të mësimdhënies (fq. 26). Disa syllabuse, mes të tjerash, kanë përfshirë në rubrikën “Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës” edhe disa forma të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive të tilla si, detyra e kursit që përgatitet me shkrim, në mënyrë të pavarur dhe mbrohet përpara auditorit (fq. 6, 37, 43, 48), ose diskutimin e rasteve konkrete dhe studimin në terren (fq. 30, 55, 74, 82, 110, 121).¹⁶⁸

Sipas Tabelës nr. 15, fq. 66, institucioni deklaron¹⁶⁹ se format e kontrollit të njohurive, për vitin akademik 2022-2023, janë shprehur në % si më poshtë:

Nr.	Forma e kontrollit të njohurive	%
1	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	0%

¹⁶⁶ Evidenca Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

¹⁶⁷ Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

¹⁶⁸ Dokumenti Silabuset MSH MSHS bashke.pdf;

¹⁶⁹ Evidenca Nr.211_Tabelat përmbledhëse ASCAL MSH MSHS.pdf;

2	Plotësimi i detyrimeve (laboratore/detyra kursi)	10%
3	Testime gjatë vitit	40%
4	Provimi përfundimtar	50%

Shqyrtimi i të dhënave në tabelën e mësipërme, tregon se: Pjesëmarrja aktive në seminare nuk zë peshë të shprehur në %, krahasuar me format e tjera të kontrollit të njohurive. Laboraret/detyrat e kursit merren në konsideratë vetëm 10%, krahasuar me testimin 40% dhe provimin përfundimtar 50 %. Pra, peshën më të madhe për kontrollin e njohurive e kanë testimet dhe provimi përfundimtar (90%).

GVJ sugjeron që të balancohet shpërndarja e shprehur në % midis formave të kontrollit të dijeve, duke ju dhënë peshë dhe rëndësi të gjitha formave të kontrollit të njohurive. Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: *Një rëndësi e vecantë i kushtohet praktikës profesionale, e cila synon thellimin e njohurive teorike dhe profesionale të studentëve, si dhe t'u japë përvojë praktike në masë të nevojshme për t'i aftësuar në ushtrimin e aktivitetit profesional.*¹⁷⁰

*Gjatë viteve të fundit janë programuar dhe realizuar orë të hapura nga stafi i fakultetit apo dhe nga staf i ftuar.*¹⁷¹

Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit, bazohen kryesisht në leksionet, seminarat, ushtrimet, detyrat studimore/hulumtuese, studime rasti dhe praktika profesionale. Mësimdhënia organizohet në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: diskutim, eksplorim, analizë, reflektim, nxitje e mendimit kritik, referime dhe prezantime në PowerPoint, etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën mësimore. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në projekte studimore / mobiliteti, në aktivitete shkencore kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FE/DP në bashkëpunim me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit, si

¹⁷⁰ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;


¹⁷¹ Evidenca Nr.108 Forume, Seminare dhe Workshop-e akademike të organizuara në UAMD, 2018-2021.pdf; Evidenca Nr.86 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Psikologjisë V.A. 2022-2023; Evidenca Nr.88 Kalendari i aktiviteteve V.A. 2022-2023 Departamenti i Psikologjisë.pdf;

	dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Referuar dokumentacionit që përfshin CV-në profesionale të personelit akademik të DP, vërehet se secili prej tyre është i kualifikuar me grada shkencore e tituj akademikë, si dhe ka përvojë të pasur në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.¹⁷²</p> <p>Në dokumentin “Raport vjetor mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE (2021-2022)”, lidhur me mësimdhënien, të nxënët dhe vlerësimi, raportohet se: <i>Në ciklin e dytë të studimeve promovohet mësimdhënia nga lektorë me gradën shkencore “Doktor” ose me titujt akademik të kategorisë “Profesor” dhe të përzgjedhur bazuar në profilin dhe përgatitjen akademike. Gjithashtu, përfaqësues nga fusha e edukimit apo fusha të tjera, janë ftuar në mësimdhënie pranë ciklit të dytë të studimeve. Procesi mësimor dhe mësimdhënia janë integruar me veprimtarinë kërkimore duke përfshirë dhe studentët si pjesë e kërkimit (fq. 10).¹⁷³</i></p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: <i>Personeli akademik, për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nxit studentin për të qenë pjesë aktive e procesit mësimor, përmes punimit të detyrave të kursit me kriteret të qarta kërkimore të shkrimit akademik, si dhe nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive, të cilat shoqërohen nga një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit, të cilat ndihmojnë në prezantime më cilësore.¹⁷⁴</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se duke u nisur nga natyra dhe kërkesat e lëndës, stafi akademik përkatës zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënët, të cilat i përgjigjen objektivave dhe natyrës specifike të lëndës, si dhe diversitetit të nevojave dhe sfidave personale të studentëve. Personeli akademik ofron metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, duke respektuar ritmin e studentëve, si dhe demonstroi se është i hapur për të përmirësuar në vazhdimësi mësimdhënien e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në</p>	<p>Në “Kodin e Etikës” (2017), Nenin 5 “Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike”, pika 3 që përcakton se: <i>Pesoneli akademik duhet të</i></p>

¹⁷² Evidenca_Nr.32.1_CV e stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë.pdf;

¹⁷³ Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf;

¹⁷⁴ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




<p>përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p><i>përmirësojë vazhdimisht metodologjinë, në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'ju shpjegojë atyre metodat e vlerësimit.</i>¹⁷⁵</p> <p>UAMD/FE/DP dëshmon se është përfshirë në projekte studimore dhe mobiliteti me institucione të ndryshme jashtë vendit, të cilat synojnë të mbështesin personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.¹⁷⁶</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se “UAMD ka një zyrë koordinimi për projektet Erasmus+, dhe të gjitha trajnimet në lidhje me këto projekte janë zhvilluar në nivel universiteti”. Personeli akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se ka përfitur nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e transferimit të përvojës dhe teknikat e mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> <p>Në dokumentin “Raport vjetor mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE” (2021-2022), mes të të tjerash raportohet se: <i>Këtë vit akademik, numri i pedagogëve të FE të cilët kanë zhvilluar leksione në Universitet Europiane, me të cilat UAMD ka marrëveshje, në kuadër të mobilitetit të stafit akademik Erasmus +, ka qenë i konsiderueshëm.</i>¹⁷⁷</p> <p>Institucioni organizon dhe ofron periodikisht trajnime për stafin akademik në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike me specialistë të fushave përkatëse.¹⁷⁸</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si</p>	<p>UAMD/FE/DP respekton procedura dhe kritere (të përgjithëshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin Rregullore e UAMD, Neni 103 dhe 104 i cili përcakton procedurat dhe modalitetet për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t'i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programeve të studimit.¹⁷⁹ Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Master i Shkencave në Mësues për Shkencat Sociale. Në Rregulloren e Programit Master</p>

¹⁷⁵ Evidenca Nr.45 KODI_ETIKËS_UAMD.pdf

¹⁷⁶ Evidenca Nr.172 Informacion mbi projektet ndërkombëtare në UAMD (2016-2021).pdf;

¹⁷⁷ Evidenca Nr.133 Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf;

¹⁷⁸ Evidenca Nr.138 Shembull trajnimi i stafit FE- vlerësimi i kurrikules, 2023.pdf;

¹⁷⁹ Dokumenti gjendet në: <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>

dhe autonominë e përgjegjshmërinë.

Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, 2019, në Nenin 12/c specifikohet se: *Në caktimin e personelit akademik sipas lëndëve, departamentet duhet të marrin në konsideratë:*

- a) *përvojën mësimore dhe kërkimore shkencore në fushën përkatëse;*
- b) *publikimet shkencore të realizuara në fushën përkatëse;*
- c) *gradën/titullin shkencor që mban.*¹⁸⁰

Referuar të dhënave tabelore për vitin akademik 2022-2023, vërehet se *i gjithë personeli akademik i angazhuar për të mbuluar mësimdhënien në programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se ka tituj akademikë dhe grada shkencore, me përjashtim të një rasti që ka kualifikim të nivelit Master i Shkencave.*¹⁸¹

Në këtë aspekt, *GVJ sugjeron të respektohet Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59 i tij “Për kategoritë e personelit akademik”, Pika 6, ku përcaktohet se: Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.*

Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: *Dëshmi e kompetencës së stafit akademik janë kualifikimet e vazhdueshme në fushat e kërkimit e cila dëshmohet nga CV mjaft të pasura.*¹⁸²

Në dokumentin “Raport vjetor mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE” (2021-2022), mes të të tjerash raportohet se: *Në ciklin e dytë të studimeve promovohet mësimdhënia nga lektorë me gradën shkencore “Doktor” ose me titujt akademik të kategorisë “Profesor” dhe të përzgjedhur bazuar në profilin dhe përgatitjen akademike. Gjithashtu, përfaqësues nga fusha e edukimit apo fusha të tjera, janë ftuar në mësimdhënie pranë ciklit të dytë të studimeve ... Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë vitit 2021-2022 janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve dhe praktikave laboratorike, për pajisjen e studentëve me shprehinë e përgjithshme dhe të transferueshme dhe duke synuar:*

- *Për procesin e mësimdhënies e të nxëniet të bëhet përcaktimi i objektivave me qëllim arritjen e kompetencave të përgjithshme a kompetencave lëndore.*

¹⁸⁰ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

¹⁸¹ Evidenca Nr.65 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin Master i Shkencave “Mësues i Shke.pdf; fq.2

¹⁸² RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimin e një mësimdhënie ndërvepruese e fokusuar të studentit dhe përdorimi i një game të gjerë materialesh burimore dhe një stil shqyrtimi që kërkon procesin e të menduarit dhe të analizës, e jo thjesht njohuri faktike. • Në procesin mësimor të kihet parasysh rritja e rolit të studentit duke e shndërruar atë nga një subjekt pasiv në aktiv, kërkues dhe pjesëmarrës. • Përdorimi i TIK në mësim, duke përfshirë platformat online dhe kërkimin, hulumtimin e vlerësimin. • Angazhimi i studentëve në veprimtari kërkimore, në detyra kursi dhe në punën krijuese në lëndë të ndryshme. • Përfshirja e studentëve të vitit të fundit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në kryerjen e mikrotezave (fq. 10-11).¹⁸³ <p>Në të njëjtën kohë, personeli akademik siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë me studentët. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka përfshirja e tutorialit ose mentorimit të studentit. <i>Mentorimi ka si qëllim kryesor asistimin, këshillimin, mbështetjen e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë viteve të studimit në të dy ciklet studimore (Bachelor dhe Master) si dhe përpjekjen për të maksimizuar rritjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën akademike, atë profesionale e më gjerë. Si i tillë, mentorimi duhet të shihet si një proces edukues në të cilin pedagogu mentor shërben si mësues, inkurajues, këshillues dhe mik me studentët me qëllimin përfundimtar të promovimit të zhvillimit profesional dhe personal të tyre.</i>¹⁸⁴</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive me në qendër studentin, duke nxitur aftësitë e tyre krijuese dhe kritike, si dhe autonominë dhe qëndrimet e përgjegjshme. Studentët treguan se ata komunikojnë lirshëm me pedagogët lidhur me mevojat e tyre për të nxënë, si dhe ndiejnë çdo ditë udhëheqjen, përkrahjen, mbështetjen dhe trajtimin e tyre me respekt nga ana e pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format</p>	<p>Referuar Statutit të UAMD, Kreu VII, dëshmohet se institucioni ka ndërtuar dhe vënë në funksion një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë për përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>

¹⁸³ Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf

¹⁸⁴ Evidenca_Nr.116_Mbi Organizimin e Tutorialit_Mentorimit në UAMD.pdf




e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

Neni 81 i tij, përcakton se: *Në UAMD funksionon njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në varësi të rektorit. Ajo përbëhet nga personel i specializuar. Kjo njësi ... (4) organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimit në UAMD.*¹⁸⁵

Në dokumentin “Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në UAMD” , Neni 4 specifikon se: *NjBSC krijon një sistem kuadër cilësie që përcakton mënyrën se si menaxhohet zhvillimi i cilësisë, shpjegon si mbledhen evidencat dhe si vlerësohet cilësia e shërbimit, në mënyrë që të analizohen nevojat dhe të vendosen synimet për zhvillimin e cilësisë”. Neni 6 përshkruan se: *Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: a) Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat.*¹⁸⁶*

Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, UAMD/FE/DP dëshmon se kryen në mënyrë periodike vlerësim dhe analizë të cilësisë së mësimdhënies dhe praktikave profesionale duke përfshirë edhe studentët. Gjithashtu, njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, mban kontakte periodike nëpërmjet Koordinatorit, duke tërhequr mendimin e studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies, si dhe kryen *analiza vjetore* ku merr në shqyrtim rezultatet e pyetësorëve me studentët të realizuara nga NJSBC, dhe reflekton mendimet dhe sugjerimet e tyre në procesin e përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies.¹⁸⁷

¹⁸⁵ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

¹⁸⁶ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar.pdf>

¹⁸⁷ *Evidenca Nr.94.1 Vlerësimi i studentëve për programin Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” V.pdf; Evidenca Nr.43.1 Rezultatet e pyetësorit të studentit për vlerësimin e praktikës mësimore V.A. 2022-2023.pdf; Evidenca Nr.147 Urdher për ngritjen e NJSBC, Fakulteti i Edukimit me ndryshim, 2022.pdf; Evidenca Nr.155 Urdhër për realizimin e vlerësimit të lektorëve nga studentët Sem I, V.A. 2019-2021.pdf; Evidenca Nr.152 Raporti i rezultateve të anketimit të studentëve, stafit akademik dhe administratës mbi.pdf; Evidenca Nr.153 (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerës.pdf;*

	<p>Kjo përvojë tregon se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit, formave të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë, është pjesë e politikave dhe strategjisë së UAMD/FE/DP.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar Statutit të UAMD, Kreu VII, Neni 77, 78, 79, 80 dhe 81 dëshmojnë se Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.¹⁸⁸</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimi i GVJ me personelin në përbërje të NJSBC-së, u mësua se kjo strukturë e bazon veprimtarinë e saj në Rregulloren përkatëse. Në dokumentin “Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në UAMD” , Neni 1, mes të tjerash shprehet se “Rregullorja synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë”.¹⁸⁹</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Në Universitetin Aleksander Moisiu, Durrës, pjesë e strukture organizative në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies janë: Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë (QKZHE). Strukturat e ngritura në nivel institucional koordinojnë veprimtarinë me njësitë kryesore dhe njësitë bazë të ofrimit të programit të studimit sipas rregulloreve të tyre të brendshme.¹⁹⁰</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi gjatë takimit me GVJ, se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, eksperimentimin me metoda të reja, cilësinë e kërkimit shkencor, etj.</p> <p>UAMD/FE/DP dëshmon se mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, si dhe trajnimin e</p>

¹⁸⁸ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

¹⁸⁹ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar.pdf>

¹⁹⁰ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSDHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

	<p>vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimit dhe zbatimit të metodave të reja. Shëmbull i mirë në këtë drejtim është shkëmbimi i përvojës akademike përmes organizimit të orëve të hapura dhe zbatimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ku personeli akademik të FE/DP ka mundësi të ballafaqojë mësimit dhe zbatimit të tyre me atë të kolegëve homologë brenda dhe jashtë vendit. Sipas dokumentit “Raport vjetor mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE” (2021-2022), mes të të tjerash raportohet se: <i>Pedagogët e FE, gjatë këtij viti kanë qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare, si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Value-X, Online Mobility Exchange, Erasmus+ Programme</i> - <i>“Preparing future teachers in the Western Balkans: Education for democracy and human rights” miratuar nga Këshilli i Evropës dhe i drejtuar nga Qendra Evropiane Wergerland.</i> - <i>Inclusive Tertiary Education in the Western Balkans (IDEA), financuar nga Bashkimi Evropian (Erasmus+ dhe CBHE), (2021-2024).</i> - <i>“Comparative studies in modern society; The Balkans – A Comparative and Integrative Approach”, March 2021. Prizren. Etj.¹⁹¹</i> 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD/FE/DP garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional të shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Të balancohet shpërndarja e shprehur në % midis formave të kontrollit të njohurive, duke ju dhënë peshë dhe rëndësi të gjitha formave të kontrollit;</i> 2) <i>Të respektohet Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59 i tij “Për kategoritë e personelit akademik”, Pika 6, ku përcaktohet se: Personeli akademik, që angazhohet në mësimit dhe zbatimit, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

¹⁹¹ Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf




Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në UAMD/FE, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët. Sipas dokumentit “Rregullore e UAMD”, Neni 68 dhe dokumentit “Rregullore e Fakultetit të Edukimit” (2019), Neni 66, përcaktohet se: (1) <i>Forma e vetme e kontrollit të dijës është provimi me shkrim. Për çdo kurs, 10% e vlerësimit mbështetet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grup dhe esetë, sipas programit të kursit të miratuar. (2) Në format e kontrollit përdoret sistemi i vlerësimit me pike, rezultati i të cilit kthehet në notë, sipas formulës ë përcaktuar me vendim të Senatit Akademik.</i>¹⁹²</p> <p>Në dokumentin “Regullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 22 “Format e kontrollit të dijeve, kriteret dhe shkalla e vlerësimit”, shprehet se: (1) <i>Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm). Format dhe kriteret e vlerësimit për studentin përcaktohen në planin e kursit (silabusin) dhe u bëhen të ditura studentëve. (4) Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i konvertuar në sistemin prej dhjetë notash në proces-verbalin përfundimtar. (8) Vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none">a. <i>Provimi i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar;</i>b. <i>Provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar;</i>

¹⁹²<https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>; Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;

c. Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar.¹⁹³

Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e lëndës dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor nëpërmjet evidentimit të syllabuseve të lëndëve.¹⁹⁴

Sipas RVB (2023), Mënyra e vlerësimit dhe e testimit bëhen të ditura tek studentët nga lektori i lëndës dhe janë afishuar në web-in e universitetit, në rrjetet sociale të fakultetit dhe të afishuara pranë standave të njoftimeve në fakultet.¹⁹⁵

Gjithashtu, në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 19, 20 dhe 21, përcakton modalitetet, standardet dhe rregullat e mbrojtjes së provimit të diplomës në përfundim të programit të studimit.¹⁹⁶

Në këtë kuadër, Institucioni ka përgatitur një Manual për Punimin e Diplomës Master Fakulteti i Edukimit (2016), i cili shërben si udhëzues studentëve të nivelit master për hartimin e punimeve të tyre përfundimtare sipas një formati të pranueshëm akademik në këtë fakultet. Ky udhëzues përmban përshkrimin e një numri rregullash dhe sugjerimesh që synojnë sigurimin e një standardi akademik në përgatitjen e tezave si nga ana e formës, ashtu edhe e përmbajtjes.

Institucioni ka hartuar një rregullore të posaçme edhe për praktikantët profesionalë, e cila sipas Nenit 2 “... vendos rregullat normative të funksionimit të praktikave në nivelin e Ciklit të Parë dhe të Ciklit të Dytë të studimeve dhe krijon marrëdhënie midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtyre praktikave. Rregullorja përcakton misionin, strukturën e procesit të praktikave, rolet përkatëse për funksionimin e tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, profesionistëve që do të marrin nën udhëheqje studentët, personelit akademik dhe administrativ, raportet midis tyre, rregullat për pranimin e studentëve në praktika, procesin e vlerësimit dhe parashikon sanksione në rastin e shkeljes së rregullores”.¹⁹⁷

¹⁹³ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

¹⁹⁴ Silabuset MSH MSHS bashke.pdf;

¹⁹⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

¹⁹⁶ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

¹⁹⁷ Evidenca Nr.41 Rregullore për praktikantët mësimorë në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p; Evidenca Nr.42 Manual i praktikës së mësimdhënies për studentët e programeve të Departamentit Psikologji.p; Evidenca_Nr.42.1_Formulari i vlerësimit të studentit praktikant MSH MSHS.pdf;

	<p>UAMD, në kuadër të transparencës dhe të komunikimit me të interesuarit pasqyron në faqen e vet online uamd.edu.al çdo dokument lidhur me legjislacionin dhe rregulloret respektive. Informacioni është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Si pjesë e UAMD, personeli akademik i FE/DP dëshmon se zbaton “Kodin e Etikës” (2017), Nenin 5 “Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike”, që përcakton se: (4) <i>Personeli akademik duhet t’i shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës e provimeve.</i> (5) <i>Personeli akademik duhet të tregohet transparent në vlerësimet dhe testimet e njohurive të studentëve, në metodologjinë e përdorur dhe në rezultatet e tyre, duke vepruar konform Rregullores së universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</i>¹⁹⁸</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Kreu III, “Vlerësimi i studentit”, Neni 23 dhe 24, përcakton modalitetet dhe rregullat e zhvillimit të provimit dhe procedurat e vlerësimit.¹⁹⁹</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, në rubrikën “Forma e kontrollit të dijeve”, vërehet se janë shënuar “Frekuentimi” dhe “Kontrolli i vazhdueshëm” që përfshin të dhëna për provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar, shoqëruar me sistemin e vlerësimit/testimit të dijeve të studentëve.²⁰⁰</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Çdo lektor informon studentët në orën e parë të leksionit për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, si dhe çdo element tjetër në programin e lëndës.²⁰¹</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 22, shprehet se:</p> <p>1. <i>Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm). Format</i></p>

¹⁹⁸ Evidenca Nr.45 KODI ETIKËS UAMD.pdf;

¹⁹⁹ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

²⁰⁰ Dokumenti Silabuset MSH MSHS bashke.pdf.

²⁰¹ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

	<p>dhe kriteret e vlerësimit për studentin përcaktohen në planin e kursit (silabusin) dhe u bëhen të ditura studentëve.</p> <p>2. Forma e vetme e kontrollit të dijeve në Universitetin "Aleksandër Moisiu" është provimi me shkrim. Për çdo kurs, 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të kursit të miratuar.</p> <p>3. Në format e kontrollit përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet në notë sipas formulës së përcaktuar në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu".²⁰²</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët, realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, ese, projekte etj, provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtar. Në nivel programi, studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmblylëse për mbrojtjen e diplomës.²⁰³</p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>			
Konkluzione	<p>GVJ mendon se institucioni dëshmon se ka hartuar rregullore me procedura të posaçme të kontrollit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, si dhe garanton zbatimin e tyre. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë përcaktuar në rregullore dhe manuale të miratuara nga institucioni. GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, në rubrikën "Forma e

²⁰² Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;


²⁰³ RAPORTI VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p><i>kontrollit të dijeve</i>”, janë shënuar “<i>Frekuentimi</i>” dhe “<i>Kontrolli i vazhdueshëm</i>” që përfshin të dhëna për provimin e ndërmjetëm (i cili ka 400 pikë të mundshme) dhe provimin përfundimtar (i cili ka 500 pikë të mundshme), si dhe detyrat e kursit (të cilat kanë 100 pikë të mundshme). Në total, studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë të mundshme. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse sipas tabelës së paraqitur në sylabuse.²⁰⁴</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni shprehet se: <i>Studenti i nënshtrohet dy provimeve me shkrim në semester dhe një mbrojtje në detyre kursi. Rezultatet e çdo lënde janë semestrale. Ky sistem i integruar i vlerësimit të njohurive, i nxit dhe i motivon studentët të mësojnë në vazhdimësi gjatë të gjithë periudhës së zhvillimit të modulit, në auditor dhe në orët e studimit të pavarur. Kjo formë mundëson vlerësimin e progresit të bërë nga studenti në përvetësimin e dijeve dhe i jep mundësi pedagogut dhe studentit të konstatojnë mangësitë që paraqiten.</i>²⁰⁵</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë si dhe ta ndihmojë atë hap pas hapi që të përmirësohet, si dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB (2023), Institucioni sqaron se: <i>UAMD disponon sisteme të integruara informacioni në bashkëpunim me projektin e RASH, si dhe vë në zbatim në disa lëndë të masterit të shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit në bashkëpunim me AADF.</i>²⁰⁶</p> <p>Për të shmangur format e abuzimit dhe rritur transparencën për testimin dhe vlerësimin e studentëve, UAMD/FE/DP zbaton procedura korrekte të përkrahura në rregulloret përkatëse, të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore e UAMD, Neni 69, ku shprehet se: (7) <i>Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët</i>

²⁰⁴ Dokumenti Silabuset MSH MSHS bashke.pdf

²⁰⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²⁰⁶ Manuali i përdorimit të sistemit Pitagora-RASH, Manuale për sekretarinë, pedagogun, studentin; <https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/>; Evidenca Nr.183.1 Manual i krijimit të provimit, vlerësimi me Clean Score.pdf




kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i kursit cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme. (11) Pas provimit personeli akademik i kursit dorëzon pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve si dhe në një zarf të mbyllur tezat e korigjuara së bashku me tezat origjinale brenda afateve të përcaktuara në pikën 7 të këtij neni. (12) Zarfet me fletët e provimeve të arshivuara në sekretari mund të hapen dhe të kontrollohen nga komisioni ad hoc i ngritur nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore, vetëm në rast ankimi nga studenti si dhe në rastet e kontrollit të përputhshmërisë me ligjin Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së.²⁰⁷

2. Rregullore e Fakultetit të Edukimit (2019),²⁰⁸ Neni 67.
3. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë (2019), Neni 58, shprehet se: (7) Personeli akademik i lëndës si dhe asistuesi ndjek zhvillimin e provimit dhe ka përgjegjësinë për mbarëvajtjen e tij. (8) Për çdo seksion/grup mësimor personeli akademik duhet të përgatisë të paktën 4 teza të ndryshme provimi. Ato duhet të jenë të përgatitura sipas formatit të miratuar në Departamentin e Psikologjisë dhe nënshkruhen nga Përgjegjësi i Departamentit, jo më vonë se dita e fundit e javës që paraprin provimin.²⁰⁹
4. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (2019), Neni 23, shprehet: (7) Korigjimi i tezave kryhet gjithmonë me ngjyrë të dallueshme, e ndryshme nga ajo e tezës së studentit. Teza duhet të përmbajë pikët sipas vlerësimit të grup-pyetjeve si dhe pikët totale, të vendosura në pozicion të dukshëm brenda tezës. (8) Tezat nga ana e studentëve plotësohen vetëm me stilolaps.²¹⁰

Në RVB (2023), Institucioni shprehet se: *Studentët mund të informohen në çdo kohë pranë pranë sekretarisë mësimore, dhe mund të marrin të gjithë informacionin e kërkuar nëpërmjet sistemit on-line.*

²⁰⁷ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>

²⁰⁸ Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;

²⁰⁹ Evidenca Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

²¹⁰ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;

	<p><i>Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma on-line, të cilat mundësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe personelit akademik.²¹¹</i></p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se: Çdo student mund të rregjistrohet në profilin personal dhe të aksesojë të dhënat në sistemin PITAGORA, si dhe të rregjistrohet në kurset përkatëse të programit të studimit, të konsultojë orarin e studimeve dhe njihet me rezultatet e vlerësimit të dijeve në secilin prej kurseve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në dokumentin “Rregullore e UAMD”, Neni 68, shprehet se: (6) <i>Vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</i></p> <p><i>a) Provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar;</i></p> <p><i>b) Provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar;</i></p> <p><i>c) Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar;²¹²</i></p> <p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 22, shprehet se: (2) <i>Forma e vetme e kontrollit të dijës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” është provimi me shkrim. Për çdo kurs, 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të kursit të miratuar.²¹³</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet</p>	<p>Në RVB (2023), Institucioni shpjegon se: Rezultatet e provimeve i jepen studentit brenda 72 orësh, ku bëhet ballafaqimi i vlerësimit të tezës së provimit dhe komenteve për përmirësim nga lektori i lëndës me studentët.²¹⁴</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se vlerësimi i studentit në seminare, detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare të një lëndë të caktuar shoqërohet me</p>

²¹¹ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²¹² <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>

²¹³ Evidenca Nr.15 Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf

²¹⁴ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;





për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	komente/feedback/ këshilla me qëllim që ta ndihmojë atë të përmirësohet në ardhmen.
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e UAMD”, Neni 70, specifikon se: (3) Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të kursit. (4) Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi. (5) Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i kursit. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit.²¹⁵</p> <p>Në dokumentin “Manual për punimin e diplomës Master” (2016), lidhur me kriterin 5, shprehet se: (a) Punimi duhet të jenë punë origjinale e kandidatit. (e) Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.²¹⁶</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni shpjegon se: Zhvillimi i provimeve realizohet nën vëzhgimin e lektorit/komisionit të lëndës dhe me praninë e një asistuesi nga personeli akademik. Kjo bëhet për të shmangur kopjimin apo çdo veprim a situatë të krijuar nga studenti apo lektori i lëndës, në lidhje me paanshmërinë dhe rigorozitetin në procedurën dhe ecurinë e provimit.²¹⁷</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FE, sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga pedagogë të lëndës. Përsa i përket shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni.</p>

²¹⁵ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf> ;

²¹⁶ Evidenca_Nr.35_Manual për punimin e diplomës master në Fakultetin e Edukimit.pdf;

²¹⁷ RAPORT I VLERËSIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

FE/DP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë.

Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 22, shprehet se: *Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm). Format dhe kriteret e vlerësimit për studentin përcaktohen në planin e kursit (silabusin) dhe u bëhen të ditura studentëve.*²¹⁸

Programi lëndor (syllabusin), në rubrikën “Forma e kontrollit të dijeve/Kontrolli i vazhdueshëm”, ka referuar një tabelë pikëzimi për llogaritjen e rezultatit përfundimtar të vlerësimit të studentëve, të ndarë në kategori: përshkrimi i vlerësimit me fjalë e shprehje, sistemi i vlerësimit me notë, përqindja, sistemi i vlerësimit me shkronjë dhe pikët.²¹⁹

Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: *Korrigjimi i provimeve realizohet nga lektori i lëndës, (cili është njëkohësisht edhe hartuesi i tezës) dhe komisioni në sezonet e riprovimeve.*²²⁰

Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 23, shprehet se: *(6) Provimet e ndërmjetme shpjegohen nga personeli akademik në orën pasardhëse të mësimit, si dhe bëhet ballafaqimi i rezultateve me studentët. Në kuadër të transparencës së vlerësimit, studentët kanë të drejtë të shohin personalisht provimin në prani të personelit akademik të kursit dhe të marrin sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar, personeli akademik i kursit përcakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit, e cila duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Brenda afateve të mësipërme, personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet e kursit.*

Neni 24, pika 1 shprehet se: *Procesverbali i Vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 3 ditë pune nga dita e provimit përfundimtar dhe jo më vonë se 7 ditë nga provimi i ndërmjetëm.*²²¹

²¹⁸ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

²¹⁹ Silabuset MSH MSHS bashke.pdf

²²⁰ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²²¹ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

	<p>Respektimi i përcaktimeve në Rregulloret përkatëse për mbarëvajtjen e programit të studimit, zbatimi i formave të ndryshme të vlerësimit dhe vendosja e notave bazuar në pikët e grumbulluara të studentit sipas referencave të pasqyruara në tabelën përkatëse të syllabusit, dëshmon përpjekjen e Institucionit për të rritur objektivitetin e vlerësimit përfundimtar të studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UAMD/FE/DP garanton bazuar në dokumentet rregullatore, të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 23, shprehet se: (6) <i>Provimet e ndërmjetme shpjegohen nga personeli akademik në orën pasardhëse të mësimit, si dhe bëhet ballafaqimi i rezultateve me studentët. Në kuadër të transparencës së vlerësimit, studentët kanë të drejtë të shohin personalisht provimin në prani të personelit akademik të kursit dhe të marrin sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar, personeli akademik i kursit përcakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit, e cila duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar.</i></p> <p><i>Sipas Nenit 24 (1) Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore, ku bën pjesë studentin jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. (4) Jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës, Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë ose Koordinatori i Programit përcakton ditën dhe orën se kur do të mbledhet komisioni ad-hoc dhe njofton për këtë personelin akademik të seksionit dhe studentin. (5) Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe komisionit. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit, atëherë ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e kursit duke ndjekur procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD-së.²²²</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 24, shprehet se: (1) Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. (3) Drejtuesi i Njesisë Kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit në bazë të</p>

²²² Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

<p>transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>relacionit. Nëse kërkesa refuzohet, studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Nëse kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse kursi mbulohe nga Departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Njesisë Kryesore. Nëse kursi mbulohe nga një Departamenti i një njësie tjetër kryesore, Drejtuesi i njësisë kryesore i kërkon njësisë tjetër përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. (5) Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe komisionit. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit, atëherë ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e kursit duke ndjekur procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD-së.</p> <p>Sipas Rregullores së UAMD, Neni 69, shprehet se: (14) <i>Procesverbalet origjinale përfundimtare të firmosura, depozitohen tek kryesekretari. (15) Provimet ruhen në sekretarinë mësimore sipas afatit të përcaktuar nga Rregullorja për arkivimin e dokumentacionit në UAMD. Sipas këtij afati ato asgjësohen nën kujdesin e Sektorit TI.</i>²²³</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ bazuar në analizen e kriterëve 1-8 të standartit III.3 dhe dokumentacionit të dorëzuar, mendon se Institucioni <i>siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Përbushja e këtij standardi dëshmohe nga përdorimi i formave të ndryshme të kontrollit që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar.</i></p> <p><i>Format e kontrollit dhe kriteret e vlerësimit për studentin përcaktohen në planin e kursit (silabusin) dhe u bëhen të ditura studentëve me fillimin e çdo lënde.</i></p> <p>Gjithashtu, UAMD disponon sisteme të integruara informacioni në bashkëpunim me projektin e RASH, si dhe vë në zbatim në disa lëndë të masterit të shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit në bashkëpunim me AADF.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron që institucioni të zgjerojë më tej praktikën e nisur të përfshirjes së sistemit elektronik të testimit dhe vlerësimit lëndor për të rritur objektivitetin e vlerësimeve. GVJ gjykon se standarti përbushet plotësisht</i></p>

²²³ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 6, shprehet se: Masteri i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” synon t’u ofrojë studentëve një përgatitje më të thelluar teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit... Objektivat kryesore formuese të programit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Të përgatisë mësues në arsimin paranuiversitar në shkencat shoqërore dhe humane. 2) Të formojë specialistë të mësimdhënies, të cilët të kenë njohuri të thelluara psikologjike, filozofike dhe sociologjike, për të identifikuar problematikat dhe nevojat e shfaqura nxënësit, si dhe për të menaxhuar raste të tilla. 3) Të pajisë studentët me njohuri bazë për kërkimin shkencor në shkencat sociale, për metodat dhe parimet e përgjithshme të kërkimit shkencor; <p>Neni 20, i kësaj Rregullore, përcakton se: <i>(2) Diplomimi në Masterin e Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. (10) Punimi i diplomës në studimet Master i Shkencave paraqet punën individuale të studentit, i cili me anë të tij vërteton se aftësitë teorike të arritura gjatë periudhës së tij të studimeve, mund të shfrytëzohen me kujdes për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën shkencore të programit mësimor.</i>²²⁴</p> <p>Plani Mësimor i programit të studimit të marrë në vlerësim, ka në përbërje të tij lëndë ku studenti merr njohuri të thelluara në fushën e</p>

²²⁴ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf




	<p>Filozofisë, Psikologjisë, Sociologjisë, Pedagogjisë, si dhe Kërkimit Shkencor.²²⁵</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Praktika profesionale e programit të studimit synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve, të fituara gjatë kohës së studimeve. Programi i studimit është i ndërtuar sipas një sistemi progresiv dijesh dhe njohurish, duke synuar kështu nga njëra anë thellimin e njohurive bazë, dhe nga ana tjetër informacione rreth nivelit të zbatueshmërisë së tyre në praktikë.²²⁶</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, <i>komunikimit</i> dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>UAMD/FE dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, <i>komunikimit</i> dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). Referuar Planit Mësimor, vërehet se ofrohen dy lëndë të posaçme në fushën e komunikimit, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Komunikimi dhe etika” e cila realizohet me 6 kredite, në semestrin e dytë, në vitin e dytë të programit të studimit. - “Teori e arsytimit dhe argumentimit”, me 5 kredite dhe realizohet në semestrin e dytë, të vitit të parë.²²⁷ <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik tregoi se studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë informatike dhe kërkesën për të komunikuar e ndërvepruar në gjuhë të huaj, ndërkohë që përpiqen të studiojnë literaturën përkatëse për realizimin e detyrave të kursit, ushtrimeve praktike të lëndëve të ndryshme, apo punimin sipas standardeve të temës/tezës së diplomimit. Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Departamenti i Psikologjisë, Departamenti i Sociologjisë dhe Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit, organizojnë leksione të hapura dhe aktivitete të ndryshme me përfaqësues institucionesh, ekspertë, etj.²²⁸</p> <p>Përfshirja e studentëve në këto aktivitete me qëllim zhvillimin e aftësive të tyre në fusha të veçanta, dëshmohet edhe nga përmbajtja e Kalendarit të Aktiviteteve në nivel fakulteti dhe departamentesh.²²⁹</p>


²²⁵Evidenca Nr.28.1 Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

²²⁶ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²²⁷Evidenca Nr.28.1 Plani Mësimor Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

²²⁸ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²²⁹ Evidenca Nr.88 Kalendarit i aktiviteteve V.A. 2022-2023 Departamenti i Psikologjisë.pdf; Evidenca Nr.87 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Sociologjisë V.A. 2022 .pdf; Evidenca_Nr.86_Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Psikologjisë V.A. 2022-2023;




<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentit “Raport vjetor - Veprimtaria mësimore e kërkimore shkencore FE” (2021-2022), mësohet se: <i>Rishikimi i syllabusit është përgjegjësi akademike e pedagogut që zhvillon mësimin dhe përcakton se çfarë duhet ndryshuar dhe rinovuar. Syllabuset rifreskohen çdo vit akademik në mënyrë që të përfshihen të dhënat më të reja dhe literatura më e fundit. Pedagogu që zhvillon lëndën përgatit syllabusin dhe dorëzon në departament versionin final të tij. Më pas syllabusi firmoset nga Përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i fakultetit duke u ruajtur hierarkia profesionale (fq.9).</i>²³⁰</p> <p>Kjo praktikë vlerësohet nga GVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve. Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se pedagogu i çdo lëndë, në fund të semestrit, para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e</p>	<p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikën e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore (syllabuseve) dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e objektivave dhe rezultateve të pritëshme të të nxënimit (në seksionin “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënimit”) që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shëmbuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritëshme të të nxënimit, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj., duke vënë</p>

²³⁰ Evidenca_Nr.133_Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.pdf;


<p>shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>theksin tek demonstrimi/përdorimi/aplikimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave në situata praktike.²³¹</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik shpjegoi se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: punë në grupe, diskutim, interpretim, analiza, reflektim, etj. Përsa i përket aspektit metodologjik të mësimdhënies, shumica e titullarëve të lëndëve treguan se ata kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxënit e studentëve duke e bazuar në diskutime që nxisin mendimin kritik, kombinime të punës individuale dhe asaj në grup, ushtrime praktike ku gjejnë zbatim dijet e fituara dhe zgjidhje të çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën.</p> <p>Institucioni e ka kthyer në traditë organizimin e konferencave shkencore të studentëve, duke krijuar një klimë të përshtatshme bashkëpunimi të stafit akademik dhe studentëve, për mbështetjen e ideve inovative, si dhe prezantimin e punimeve hulumtuese/kërkimore shkencore të tyre.²³²</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni shpjegon se: Përbërja e kurrikulës së programit Master Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”, lëndët dhe modulet janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që t’u japin studentëve kompetenca për t’ju përgjigjur tregut të punës.²³³</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, Pedagogjisë dhe Sociologjisë dëshmojnë se organizojnë aktivitete të ndryshme ku ftojnë specialistë ose ekspertë të fushës për të zhvilluar leksione të hapura, ose seminare, workshope mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.²³⁴</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaron se: Orët e hapura janë aktivitete që organizohet nga lektorët me synimin për të dhënë hapësira të reja</p>

²³¹ *Silabuset MSH MSHS bashke.pdf;*

²³² *Evidenca Nr.131 Njoftime për stafin dhe studentët për konferencat shkencore, FE, 2019-2022.pdf;*

²³³ *RAPORTI VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;*

²³⁴ *Evidenca Nr.134 Buletini i aktiviteteve në FE, V.A. 2017-2018.pdf; Evidenca Nr.86 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Psikologjisë V.A. 2022-2023; Evidenca Nr.87 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Sociologjisë V.A. 2022 .pdf; Evidenca Nr.88 Kalendari i aktiviteteve V.A. 2022-2023 Departamenti i Psikologjisë.pdf;*




	<p>dhe inteligjente për probleme të ndryshme që prekin këtë fushë studimi.²³⁵</p> <p>Gjithashtu, studentët pohuan gjatë takimit me GVJ se institucioni organizon veprimtari jashtë programit mësimor me karakter kulturor, shkencor dhe zbavitës.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FE/DP inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore ose punë kërkimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. GVJ evidentoi se institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të ngjarjeve shkencore në nivel kombëtar/ndërkombëtar, të organizuara nga UAMD/FE ose në partneritet me institucione të tjera, duke nxitur dhe mirëpritur pjesëmarrjen e studentëve me referime studimore/postera. Gjithashtu, GVJ pati mundësi të shfletonte një produkt të publikuar të punimeve Konferencës së Studentëve (2021) të FE të financuar nga UAMD.²³⁶</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e UAMD”, neni 38 dhe në Rregulloren e FE, neni 39, si dhe në Rregulloren e DP (2019), neni 29 “Financimi i kërkimit shkencor”, pika 4, shprehet se: <i>Në buxhetin që përcaktohet për (çdo njësi kryesore) Departamentin e Psikologjisë duhet të përcaktohet dhe një fond që duhet të mbështesë veprimtarinë mësimore/ kërkimore-shkencore dhe botimet përkatëse.</i>²³⁷</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni deklaroi se: Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Psikologjisë dhe Departamenti i Sociologjisë organizojnë një sërë aktivitetesh me karakter shkencor dhe mësimor, duke inkurajuar studentët të bëhen pjesë e tyre.²³⁸</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, ka përcaktuar qartë objektivat formues dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët nëpërmjet tërësisë së përmbajtjes lëndore si dhe përfshirjes së metodave interaktive të mësimdhënies, të cilat mundësojnë studentët</i></p>

²³⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

²³⁶ Evidenca Nr.134 Buletini i aktiviteteve në FE, V.A. 2017-2018.pdf; Evidenca Nr.86 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Psikologjisë V.A. 2022-2023; Evidenca Nr.87 Buletini i aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Sociologjisë V.A. 2022 .pdf; Evidenca Nr.88_Kalendari i aktiviteteve V.A. 2022-2023 Departamenti i Psikologjisë.pdf;

²³⁷<https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>; Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf; Evidenca Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

²³⁸ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;

	<p>të zhvillojnë njohuritë dhe shprehitë e nevojshme profesionale në situata praktike.</p> <p>Gjithashtu, programi i studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët edhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtari mesimore dhe shkencore. GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe publikuar rregullore të posaçme për programin e studimit të marrë në vlerësim, dhe ndjek procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre dhe i bën publike. Dokumenti “Rregullore e UAMD, neni 75, 76, 77, dhe 78, përshkruan procedurat e posaçme për detyrimet përmbyllëse.”²³⁹</p> <p>Kriteret për fitimin e diplomës dhe procedurat e diplomimit janë përcaktuar edhe në dokumente të tjera rregullatore të veprimtarisë së institucionit, si: Rregullore e Fakultetit të Edukimit (2019), neni 73, 74, 75 dhe 76; Rregullore e Departamentit të Psikologjisë (2019), neni 64, 65, 66 dhe 67; Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (2019),²⁴⁰ neni 19, 20 dhe 21.</p> <p>Të gjitha këto dokumente janë publike dhe të aksesueshme për të gjithë studentët në faqen zyrtare institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e</p>	<p>FE/DP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse dhe mbrojtjes së diplomës. FE ka publikuar Rregulloren e Programit të</p>

²³⁹ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>

²⁴⁰ *Evidenca Nr.11_Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf; Evidenca Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf; Evidenca Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;*

nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.

Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (2019), që përbën një dokument rregullator të posaçëm, i cili në nenet 19, 20 dhe 21, përcakton mënyrën e organizimit të diplomimit, procedurat dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë të marrë në vlerësim.²⁴¹

Fakulteti i Edukimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka përgatitur një Manual për Punimin e Diplomës Master (2016) që t’u shërbejë si udhëzues studentëve të nivelit master për hartimin e punimeve të tyre përfundimtare sipas një formati të pranueshëm akademik në këtë fakultet. Ky udhëzues përmban përshkrimin e një numri rregullash dhe sugjerimesh që synojnë sigurimin e një standardi akademik në përgatitjen e tezave si nga ana e formës, ashtu edhe e përmbajtjes (fq.2).

Sipas këtij Manuali, çdo student/e ka të drejtë të zgjedhë një udhëheqës shkencor. Udhëheqësi, që të udhëheqë punën e studentit duhet të ketë gradë shkencore “Doktor” dhe titull akademik. Në parim, Udhëheqësi duhet të zgjidhet nga punonjësit akademikë ose shkencorë të fakultetit dhe duhet të ketë përvojë në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës. Pasi merr pëlqimin e Udhëheqësit, studenti/ja i paraqet propozimin për punimin dhe Komitetit Shkencor të programit Master (fq.4). Udhëheqësi ka këto përgjegjësi: (b) Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit, por nuk ka përgjegjësi që të bëjë redaktimin e materialit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës (fq.4-5).²⁴²

Në RVB (2023), Institucioni deklaron se strukturat përgjegjëse, si *Përgjegjësi i departamentit të psikologjisë, pedagogu përkatës udhëheqës, zv. Dekani për kërkimin shkencor dhe zv. Dekani për anën mësimore, si dhe sekretaria mësimore për ciklin e dytë të studimeve, ndihmojnë dhe asistojnë studentët që në fazën e parë të aplikimit për*

²⁴¹ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” pdf;

²⁴² Evidenca_Nr.34_Rregullore e diplomimit për studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Edukimit.pdf;

	<p>tezën e diplomës, deri në mbrojtjen përfundimtare të diplomës. Studentët informohen nëpër auditore, dhe nëpërmjet kontakteve të tyre elektronike në lidhje me procedurën e temën së diplomës, dokumentacionin, kriteret etike për kërkimin shkencor dhe profilin e fushat e studimit të stafit akademik pranë programit të studimit.²⁴³</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale” (2019), Neni 20, pika 2 përcakton se: Diplomimi në Masterin e Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. Neni 21, shprehet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga njësitë bazë përkatëse dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë. 2. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 20 minuta. Anëtarët e komisionit dhe dëgjuesit në sallë, rezervojnë të drejtën për t’i drejtuar pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës. 3. Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve të komisionit.²⁴⁴ <p>Në RVB (2023), Institucioni shpjegon se: <i>Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit konsiderojnë: ecurinë e procesit të punës kërkimore, kriteret dhe standartet etike të kërkimit shkencor, strukturën dhe përmbajtjen e punimit të paraqitur në formë të shkruar; prezantimin e punimit për diplomë nga ana e studentit gjatë mbrojtjes në komision; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit dhe mbi bazën e paraqitjes së tyre bën vlerësimin me notë.</i>²⁴⁵</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si</p>	<p>Sipas dokumentit “Rregullore Departamentit të Psikologjisë” (2019), Neni 64, shprehet se: (4) <i>Departamentet përcaktojnë listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon Departamenti. (5) Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga Njësia Bazë dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.</i></p>

²⁴³ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf

²⁴⁴ Evidenca Nr.34 Rregullore e diplomimit për studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Edukimit.pdf;

²⁴⁵ RAPORT I VLERESIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

Neni 66 i kësaj rregullore, përcakton se: *Tezat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimorë shkencorë të Departamentit e Psikologjisë që kanë titull ose gradë shkencore, (të paktën të një cikli më të lartë), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve të ofruara nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" dhe që kanë kualifikim të lartë, specialistë të njohur të fushave të njëjta me programet e studimit që kanë titull shkencor si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit.*²⁴⁶

Sipas dokumentit "Manual për Punimin e Diplomës Master" (2016), Udhëheqësi ka këto përgjegjësi:

- a. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së punimit.
- b. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit, por nuk ka përgjegjësi që të bëjë redaktimin e materialit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
- c. Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
- d. Të mbajë takime të rregullta me studentin (të paktën 2-3 orë në javë) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së punimit.
- e. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- f. Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në seminare ose takime.
- g. Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para komisionit të mbrojtjes.

²⁴⁶ Evidenca_Nr.12_Rregullore e Departamentit Psikologji.pdf;

	<p>h. Të bëjë kritikën e duhura për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.</p> <p>i. Të vërtetojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e komisionit të vlerësimit kur ai e ka kthyer punimin për riparimet.</p> <p>j. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga punimi i tij.</p> <p>k. Të menaxhojë fondet e kërkimit nëse janë siguruar të tilla.²⁴⁷</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërme, dëshmohet se personeli akademik/ udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuara. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FE/DP asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Sipas dokumentit Rregullorë e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (2019), Neni 20, pika 7 shprehet se: <i>Studenti merr përsipër shpenzimet për realizimin e tezës së diplomës.</i>²⁴⁸</p> <p>Në RVB (2023), Institucioni shruan se: Udhëheqësi shkencor asiston, ndihmon dhe këshillon studentin nëpërmjet pajisjeve dhe programeve që disponon fakulteti.²⁴⁹</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, autoritetet drejtuese treguan se: <i>FE/DP u asiston studenteve brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në bibliotekë, mjedis të mbuluar me WiFi, etj.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së</p>	<p>Në përfundim të provimit të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentin vlerësohet me notë. Ky kriter gjen pasqyrim në Rregullorë e Programit të Studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale (2019), Neni 21, ku deklorohet se: (1) <i>Vlerësimi i tezës së</i></p>

²⁴⁷ Evidenca_Nr.34_Rregullorë e diplomimit për studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Edukimit.pdf;

²⁴⁸ Evidenca_Nr.15_Rregullorë e Masterit Shkencor "Mësues i Shkencave Sociale".pdf;

²⁴⁹ RAPORT I VLERËSIMI I BRENDSEHEM AKREDITIM MSH MSHS. pdf;




<p>punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga njësitë bazë përkatëse dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë. (3) Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve të komisionit.(5)Nota përfundimtare llogaritet duke u bazuar në sistemin e vlerësimit të Statutit të UAMD, të rregullores së fakultetit dhe të departamentit. Studentit i bëhet i ditur vlerësimi jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i mbrojtjes së tezës.²⁵⁰</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Ky kriter gjen shprehje në Rregulloren e UAMD, neni 90 “Lëshimi i diplomave, certifikatave”, ku përcaktohet se: (2) <i>Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të lartë profesional, të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara si edhe ato “Master ekzekutiv” të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës.</i> (5) <i>Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit të diplomës përcaktohet në rregulloren e UAMD, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.</i>²⁵¹</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, neni 9 “Procedurat për tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës”.²⁵²</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se kopja zyrtare e programit të studimit, që përfshin syllabuset e këtij programi, vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas</p>	<p>Sipas Statutit UAMD Neni 94, shprehet se: (1) <i>UAMD ruan të dhënat personale të studentëve.</i> (2) <i>Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave të studentëve kryhen, bazuar në parimin e</i></p>

²⁵⁰ Evidenca_Nr.15_Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”.pdf;

²⁵¹ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf>

²⁵² Evidenca_Nr.17_Rregullore e Sekretarisë mësimore në Fakultetin e Edukimit.pdf;


<p>rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p><i>konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</i>²⁵³</p> <p>Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FE disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Rregulloren e Sekretarisë Mësimore të FE dhe procedurat përkatëse mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale, të parashikuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar <i>Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</i>. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.²⁵⁴</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesin e DP, u dëshmuua se kjo njësi ruan kopjet e dorëzuara të punimit të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit, në versionin hardcopy dhe elektronikisht (CD).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p> <p>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

²⁵³ <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

²⁵⁴ *Evidenca Nr.17_Rregullore e Sekretarisë mësimore në Fakultetin e Edukimit.pdf*




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>FE/DP në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garanton mjedise brenda dhe jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e leksioneve, seminareve, ushtrimeve/laboratorëve/ Sallat dhe klasat janë të pajisuara me mjete audiovizive dhe teknologjike për të zhvilluar aktivitete dhe orë laboratorike në përputhje me kërkesat e kurseve në përbërje të programit.²⁵⁵</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të vëzhgonte nga afër disa nga klasat dhe sallat ku studentët e programit të studimit të marrë në vlerësim, zhvillojnë leksione, seminare, mësim praktikë. Ndërsa, praktikat profesionale të mësimdhënies realizohen në bashkëpunim me DAR/ZVA dhe shkollat përkatëse.²⁵⁶</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>UAMD/FE/DP, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave profesionale me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale.</p> <p>Sipas Rregullores së Fakultetit të Edukimit (2019), Neni 78, shprehet se: (2) <i>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës.</i> (3) <i>Mënyra e zhvillimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale përcaktohet në rregulloren mësimore të çdo programi studimi.</i>²⁵⁷</p> <p>Referuar Rregullores së praktikës profesionale për programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë (2019), Neni 9/c shprehet se: <i>Për studentët që frekuentojnë programet Master Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” dhe “Mësimdhënie në Psikologji-Sociologji”, praktika do të kryhet pranë shkollave të mesme publike apo private.</i>²⁵⁸</p> <p>Zhvillimi i praktikës profesionale bazohet në aktmarrëveshjet ndër-institucionale ku parashikohen detyrimet dhe të drejtat e secilës palë.²⁵⁹</p> <p>Sipas Ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Neni 8, pika 1, të diplomuarit në programin e studimit Master Profesional në Kitarë dhe Mësuesi,</p>


²⁵⁵ Evidenca Nr.144 Të dhëna për kapacitetin e Godinës Nr.1 Kampus Fakulteti i Edukimit.pdf; Evidenca Nr.145 Mjetet teknologjike në dispozicion për mësimdhënien, FE.pdf;

²⁵⁶ Evidenca Nr.177 Marrëveshje bashkëpunimi FE me Drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar, Durrës p.pdf;

²⁵⁷ Evidenca Nr.11 Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf;

²⁵⁸ Evidenca Nr.41 Rregullore për praktikat mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p;

²⁵⁹ Evidenca Nr.177 Marrëveshje bashkëpunimi FE me Drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar, Durrës p.pdf;




	kandidatë për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit, duhet: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në UP-në përkatëse, që në rastin e mësuesit janë Drejtoritë Arsimore Rajonale. ²⁶⁰
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Referuar Planit Mësimor, vërehet se praktika profesionale është vlerësuar me 12 kredite/300 orë. ²⁶¹ Referuar Rregullores së praktikës profesionale për programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë (2019), neni 9, shprehet se: <i>Përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë përcakton pedagogët udhëheqës dhe grupet e studentëve që do të kenë nën mbikqyrje për kryerjen e praktikës. ... Pedagogu udhëheqës gjatë zhvillimit të praktikave të studentëve shërben si ndërlidhje midis Universitetit dhe institucionit ku kryhet praktika. Pedagogu udhëheqës komunikon me mbikqyrësit e institucioneve të përfshira në praktikat e studentëve dhe informohet për progresin e studentëve, problematika të mundshme dhe menaxhon raste të tilla duke krijuar bashkëpunim midis institucioneve përkatëse. Përgjegjësitë e pedagogut udhëheqës janë parashikuar në Nenin 10, të kësaj Rregullore. Neni 14, specifikon se: Studentët praktikantë, në përfundim të praktikës së tyre, dorëzojnë pranë pedagogut udhëheqës dosjen profesionale. Dosja e praktikës përmban:</i> 1. Ditarin e studentit ku janë të dokumentuara të gjitha vizitat në institucion, orët e qëndrimit në institucion, përshkrimi i vëzhgimit, punës që është bërë, reflektime mbi të. 2. Një ese ku studenti reflekton për përvojën e tij të praktikës, aftësitë që ka zhvilluar, përvojat që ka mësuar dhe aspiratat e tij si një profesionist i të ardhmes. ... Vlerësimi i studentëve do të bazohet në këto dy elementë e të dosjes profesionale... Vlerësimi final bëhet sipas pikëzimit të miratuar në rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit të Psikologjisë duke u bazuar në dokumentacionin e dosjes finale. ²⁶²
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në analizen e kriterëve 1-3 të standartit III.6, dokumentacionin e paraqitur dhe vizites në institucion, në rastin e programit të studimit në Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, konkludon se institucioni ndjek një procedurë të qartë të</i>

²⁶⁰ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRRI.pdf>

²⁶¹ Evidenca Nr.28 I Plani Mësimor Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale".pdf

²⁶² Evidenca Nr.41 Rregullore për praktikant mësimore në programet e studimit të Departamentit të Psikologjisë.p;

	zbatimit të njohurive nëpërmjet ushtrimeve, praktikës profesionale dhe stazhit. GVJ gjykon se standarti permbushet plotesisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje	Nga verifikimet e bëra në Departamentin e Psikologjisë lidhur me stafin akademik me kohet të plotë dhe me kohë të pjesshme rezultojnë se stafi akademik që mbulon këtë program studimi në bazë të marrëveshjes së bërë vjen nga 4 departamente (Departamenti i Psikologji , Sociologjisë ,Pedagogjisë dhe Ekonomikut) është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe udhezimet e MAS e rregulloreve të institucionit UAMD Të dhëna për stafin akademik efektiv dhe me kontratë të programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale për tre vitet e fundit pasqyrohen në tabelën më poshtë: ²⁶³

²⁶³ Të dhëna tabelore për stafin akademik në programin Master i Shkencave “Mësues i shkencave sociale” (Ref.evidenca nr.65)

me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Tituj Grada	2022-2023	2021-2022	2020-2021
		PAE/PAK	PAE/PAK	PAE/PAK
	Prof.dr	2 / 0	2 / 0	1 / 0
	Prof.Assoc.	3 / 0	3 / 1	4 / 1
	Doktor	12 / 0	11 / 1	10 / 1
	Msc.	0 / 1	0 / 0	0 / 1
	Gjithsejt	17 / 1	16 / 2	15 / 3
	Totali	18	18	18
	Rezultoni nga shqyrtimi i lëndëve që mbulojnë dhe fushave të studimit se të gjithë titullarët e lëndëve janë në përputhje me udhëzimet e MAS-së. Pedagogët kanë nivelin e duhur të kualifikimit dhe fushat kërkimore të tyre përputhet me programin e studimit. ^{264, 265, 266}			
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i të dhënave mbi personelin akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” rezultoni se personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë është në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018 “Për Veprimtarin dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe rregullores së programit të studimit Master shkencor “Mësues i shkencave sociale”, (neni 12 i rregullores së programit të studimit). ^{267, 268} Rezultoni se stafi akademik PAE mbulon mbi 90% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi. ²⁶⁹			
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit,	Nga analiza e planeve mësimorë në tre vite si dhe nga një shqyrtim i dokumentacionit lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi sipas lëndëve është në përgjithësi i pandryshueshëm dhe i janë likuiduar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Në vizitën në zyrën			

²⁶⁴ Fusha e studimit për stafit akademik përgjegjës për programin MSH MSHS në Departamentin e Psikologjisë, Sociologjisë dhe Pedagogjisë. (Ref. Evidenca Nr.30)

²⁶⁵ CV e stafit akademik e Fakultetit të edukimit të UAMD (Ref. Evidenca Nr. 32.1)

²⁶⁶ Të dhëna tabelore për personelin akademik për programin Master i Shkencave „ Mësues i Shkencave Sociale” (Ref. Evidenca Nr.65)

²⁶⁷ Udhëzimin Nr. 29, date 10.09.2018 Për Veprimtarin dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë (Ref. Evidenca Nr.194)

²⁶⁸ Rregullore e programit të studimit Master shkencor “Mësues i shkencave sociale”, (Ref. Evidenca Nr. 15)

²⁶⁹ Të dhëna tabelore për stafin akademik në programin Master i Shkencave “Mësues i shkencave sociale” (Ref.evidenca nr.65)

<p>duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>e burimeve njerëzore u konstatua se të gjithë stafi që mbulonte këtë program studimi ishte me kontratë dhe paguheshin sigurimet shoqërore.²⁷⁰ Gjatë tre viteve të funksionimit të këtij program studimi 2018-19 deri në vitin 2020-2021 është ruajtur qëndrueshmëria e personelit që mbulojnë lëndët mësimore të këtij programi, por në vitin akademik 2022-2023 janë ndryshuar pedagogët në lëndët Politika dhe legjislacioni në arsim; Metodologji mësimdhënie; Zhvillim kurrikule; Psikologji Edukimi; Psikologji zhvillimi në adoleshencë ; Mikromakro ekonomi, nga 20 lëndë janë ndryshuar 5 titullarë të lëndëve, rreth 25% e lëndëve të programit. Në takimin me Drejtues të Departamentit na u tha ky ndryshim është bërë pasi ngarkesa e këtyre lëndëve u ka kaluar nga pedagogë me kohë të pjesshme tek ato me kohë të plotë.²⁷¹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të institucionit UAMD si dhe dokumentacionit që disponon Departamenti i Psikologjisë si dhe Burimet Njerëzore pranë institucionit rezulton se janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij më kohë të pjesshme.²⁷²</p> <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Edukimit neni 25 Departamenti mund të vendosë kriteret specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë, kriteret që miratohen më pas nga Rektori²⁷³ Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore, duke filluar nga përcaktimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike, shpallja në APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare²⁷⁴</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>Për vetë natyrën e programit nuk ka personel ndihmës akademik, në raport nuk ka të dhëna lidhur me këtë kriter.</p>

²⁷⁰ Model kontrate pune UAMD. (Ref.Evidenca Nr. 102)

²⁷¹ Tabelë me informacion rreth profileve të stafit akademik me kohë të plotë në Master i shkencave "Mesues i shkencave sociale" (Ref.Evidenca Nr.66)

²⁷² Procedurat dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit në UAMD (Ref.Evidenca Nr. 101)

²⁷³ Rregullore e Fakultetit të Edukimit në UAMD (Ref.Evidenca Nr. 11)

²⁷⁴ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Mundesi punesimi)

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga verifikimi i dosjeve të personelit akademik dhe jo akademik pranë departamenteve dhe Degës së Burimeve Njerëzore konfirmojmë që ekziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, titujt dhe gradat shkencore që kanë, ngarkesën mësimore në kuadrin e këtij programi, kualifikimin, punën shkencore të tyre. Në zyrën e burimeve njerëzore ka një informacion të plotë të këtij stafi sipas viteve akademike dhe lëndëve që mbulohe në këtë program nga ato²⁷⁵.</p> <p>Të gjitha strukturat përgjegjëse të programit të studimit Master i Shkencave “Mësues Shkencave Sociale” të UAMD Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Psikologjisë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore, bazuar në rregulloren e programit të studimit disponojnë listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në këtë program për çdo vit akademik dhe kanë informacion të plotë për realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse.²⁷⁶</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikuar gjatë vizitës në institucion, rezulton se UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DRAP Durrës për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave “Mesues Shkencave sociale” si dhe me institucione të tjera të arsimit apo përfaqësues të agjensive të ndryshme.^{277 278}</p> <p>Në rregulloren e studimit të Fakultetit të edukimit (neni 73;74;75,) dhe rregulloren e studimit të Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale” (neni 19;20;21) janë të përcaktuara qartë detyrat e strukturave dhe personelit akademik lidhur me detyrimet mbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi ^{279, 280}</p>

²⁷⁵ Te dhena tabelore per personelin akademik te programit Master i Shkencave “Më sues i Shkencave sociale” (Ref.Evidenca Nr.65)

²⁷⁶ Rregullore e studimit të Masterit Shkencor “Mesues I Shkencave sociale” (Ref. Evidenca Nr.15, neni 12;13.)

²⁷⁷ Marrë veshje bashkëpunimi mes Departamentit të Psikologjisë ,Sociologjisë dhe Pedagogjisë për r organizimin e MSH MSHS (Ref.Evidenca Nr. 27).

²⁷⁸ Marrë veshje bashkëpunimi mes Fakultetit të Edukimit dhe DRAP Durrës për r organizimin e praktikave profesionale të MSH MSHS (Ref.Evidenca Nr. 177.)

²⁷⁹ Pyetsorin mbi progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet e praktikave profesionale të studentëve ve. (Ref.Evidenca Nr.177/1)

²⁸⁰ Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i shkencave sociale” (Ref.Evidenca Nr. 15); Rregullore e FE (Ref.Evidenca Nr. 11)




sipas natyrës së programit të studimit.									
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës konfirmojmë se Fakulteti i Edukimit ka të sanksionuara në marrëveshjet e lidhura me institucionet pritëse tërë aspektet që lidhen me praktikën mësimore dhe ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit mbikqyrës lidhur me studentët, gjatë kohës së praktikës si dhe me plotësimin e raportit përfundimtarë dhe formularit të vlerësimit që i dërgohet. ²⁸¹								
Konkluzione	<i>GVJ bazuar ne analizen e kriterev 1-8 te standartit IV.1 te dokumentacionit te paraqitur dhe vizites ne institucion mendon se Fakulteti i Edukimit pranë UAMD që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit. GVJ gjykon se standarti permbushet plotesisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në	Infrastruktura e vënë në dispozicion të Programit te studimit Master i Shkencave “Mesues i Shkencave Sociale” përfshin ambiente për leksione dhe seminare pranë korpusit të ri në Spitalë , që i plotësojnë kriteret, dhe sigurojnë një mësim normal të këtij programi studimi, pavarësisht numrit të konsiderueshëm të studenteve në këtë program studimi.Janë 15 auditore me kapacitet 1141 vënde.Në dispozicion

²⁸¹ Formular vlerësimi I studentëve në praktikë n profesionale të MSH MSHS (Ref.Evidenca Nr.42/1); Rregullore per zhvillimin e praktikave profesionale (Ref.Evidenca Nr.44.)

<p>përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>është edhe nje sallë konferencash me kapacitet 218 vende për organizimin e konferencave të ndryshme.²⁸². Stafi akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në 16 zyra në të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal të punës. Për vetë natyrën e këtij programi nuk janë të nevojshme laboratore që përdoren në programe të tjera, por në dispozicion të këtij programi është laborator i IT-së me kapacitet 64 vende.²⁸³</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e Fakultetit të Edukimit të UAMD konstatoam se në funksion të programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” kishte mjedise mësimore si auditore, salla mësimi të paisura me mjete moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit, në mënyrë të vecantë të teknologjisë bashkohore ne fushën e mësimdhënies.²⁸⁴, Mjediset e mesimdhënies ishin paisur me mjete te perfituara nga projekti TEAVET si kompjutera,laptop,vidio-projektor, smartboard me softwverw për mësimdhënien etj.²⁸⁵</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në vizitën në ambientet e Fakultetit të Edukimit në UAMD konstatoam se ka mjedise të mjaftueshmë dhe të paisura me aparatura dhe mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike të cilat janë në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave “ Mësues i Shkencave Sociale” në përputhje me kërkesat e lëndëve për një formim teorik dhe praktik të studentëve, përcaktuar në qëllimet e programit.²⁸⁶ Laboratori i Informatikës ka të gjitha paisjet e nevojshme për një mësimdhënie bashkohore për formimin e aftësive si teorike dhe praktike të studentëve në përputhje me objektivat dhe përmbajtjen e moduleve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Në ambientet e Fakultetit të Edukimit, në funksion të programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” kishte edhe një laborator të informatikës i paisur me kompjutera, laptop, smart bord, vidio-projektore,Web server,printer fotokopje,etj, paisur nga projekti TEAVET,të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe për aftësimin teorik dhe praktik në përputhje me</p>


²⁸² Dokumentacion mbi asetet objektet pasurite dhe politikat e prones në UAMD (Ref.Evidenca Nr.143)

²⁸³ Të dhena mbi kapacitetet e godinës së Fakultetit të Edukimit (Ref.Evidenca Nr. 144)

²⁸⁴ Të dhena mbi kapacitetet e godinës së Fakultetit të Edukimit (Ref.Evidenca Nr. 144)

²⁸⁵ Mjete teknologjike në funksion të mësimdhënies ne FE (Ref.Evidenca Nr.145)

²⁸⁶ Të dhena mbi kapacitetet e godinës së Fakultetit të (Ref.Evidenca Nr. 144)




natyrës së programit të studimit që ofron.	objektivat e programit. Laboratori i informatikës disponon edhe programe softëçere profesional si programi statistikor SPSS versioni 22, Paketa office, Exel, Word, ²⁸⁷			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Kampusi i ri i UAMD ku ndodhet Fakulteti i Edukimit garanton mjedise me kapacitete të mjaftueshme për një zhvillim normal të procesit mësimor në programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale”. ²⁸⁸ Për vetë natyrën e programit me përfshirjen e tre departamenteve ka një marrëveshje mes tyre për shfrytëzimin e ambienteve të përbashkëta lidhur me realizimin e këtij programi studimi. Për zhvillimin e praktikës profesionale FE ka lidhur marrëveshje me DRAP Durrës, si dhe me organizata të tjera ²⁸⁹ .			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka mjaftueshëm dhe vë në dispozicion të programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale, mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin teorik dhe praktik, të studentëve në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i> <i>GVJ gjykon se standarti permbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

²⁸⁷ Mjete teknologjike në funksion të mësimdhënies në FE (Ref.Evidenca Nr.145)

²⁸⁸ Të dhëna për kapacitetin e Dodines Nr.1 Kampus të Fakultetit të Edukimit (Ref.Evidenca Nr. 144)

²⁸⁹ Marrëveshje bashkëpunimi mes Departamentit të Psikologjisë, Sociologjisë dhe Pedagogjisë (Ref.Evidenca Nr.176);
Marrëveshje bashkëpunimi mes Departamentit të Psikologjisë dhe DRAP Durrës, dhe organizata të tjera. (Ref.Evidenca Nr.170.)

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në formatin e programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” është përcaktuar si element edhe literatura bazë dhe e rekomanduar që u ofrohet studentëve qoftë fizike ashtu edhe digjitale (literaturë e cila gjindet ne bibliotekën e UAMD fizikisht dhe online U LIBRARY) e cila siguron marrjen e njohurive të domosdoshme për një formim profesional të studentëve. Departamenti i Psikologjisë ka nje metodologji të perzgjedhjes së teksteve mësimorë dhe leksioneve që u ofrohen studentëve, ku pasqyrohen qartë si kriteret ashtu edhe procedurat e përzgjedhjes së tyre²⁹⁰.</p> <p><i>Gjatë shqyrtimit të programeve lëndore konstatojmë se në disa syllabuse literatura e rekomanduar që i ofrohet studentëve në syllabuset ose është e pakët në numër ose jo shumë e përditësuar (poshtë viteve 2015). Kjo mund të konstatohet edhe në evidencen e paraqitur me tituj e librave që disponon biblioteka për këtë program studimi^{291 292}</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se FE dhe Departamenti i Psikologjisë ka një praktikë pune për përditësimin e literaturës me botime të reja si gjatë diskutimit që bëhen për miratimin e syllabuseve, ashtu edhe nepërmjet kërkesave të tyre ndaj bibliotekës. Nga ana tjetër edhe biblioteka zbaton orientimet e që rrjellin nga plani i veprimtarive strategjike të UAMD-së për të zgjeruar fondin e saj me cdo botim të tyre të ri, ku përfshihet edhe detyrimi i pedagogëve për të dorëzuar cdo botim të publikuar.²⁹³</p> <p>Nga takimi me stafin dhe me drejtues të Fakultetit dhe Departamentit u theksua se përditësimi i literaturës behej nga pedagogët duke e pasqyruar në leksionet e tyre, por nuk u paraqit ndonjë leksion që të verifikohet ky aspekt.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Prane Fakultetit të Edukimit në korpusin e ri të UAMD funksionon biblioteka e FE me nje kapacitet 120 vende, e cila ka një bashkëpunim</p>

²⁹⁰ Metodologjia e përzgjedhjes së teksteve mësimorë Departamenti i Psikologjisë (Ref.Evidenca Nr. 60)

²⁹¹ Syllabuset e lëndëve të programit MSHMSHS .

²⁹² Lista e teksteve në bibliotekën FE UAMD Departamenti i Psikologjisë .(Ref.Evidenca Nr. 59.)

²⁹³ Plani i Veprimtarive Strategjike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2021-2023. Fusha strategjike V.(Ref. Faqja zyrtare, <https://uamd.edu.al> Rubrika : Transparenca,Informacione dhe Dokumenta)

<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>të mirë si me bibliotekat universitare si brënda vendit (duke qënë pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri) dhe me institutin UNRISD në Zvicër. Biblioteka garanton një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programe të ndryshme studimi, dhe në këtë aspekt edhe programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” që mbulon ky fakultet. Studentët kanë akses në shërbimet online (Katalogun online të integruar) dhe Arkivën digjitale që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit.²⁹⁴</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Fondi i librave që disponon biblioteka e fakultetit, në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” është i mjaftueshëm në shqip dhe në gjuhë të huaj, që varion nga 2 deri në 5 kopje për libër, dhe që janë në përputhje me literaturën bazë dhe të rekomanduar të programeve të lëndëve, moduleve dhe veprimtarive mësimore të programuara në to.²⁹⁵</p> <p>Biblioteka i jep mundësinë studentëve të shfrytëzojnë edhe fondin periodik, gazeta revista si dhe përdorimin e arkivës dixhitale.²⁹⁶</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e bibliotekës konstatohet se janë krijuar kushte dhe akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e ambienteve dhe fondit të saj, nëpërmjet rregjistrimit falas dhe mundësisë së përdorimit të bibliotekës online ku studentët marrin informacion si nga literatura shqipe dhe e huaj.²⁹⁷</p> <p>Studentët kanë akses edhe në U-Library duke u ofruar atyre edhe një manual përdorimi të JSTOR.²⁹⁸</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e bibliotekës rezulton se ka jo vetëm ambiente fizike të mjaftueshme, por edhe është mirë e paisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve.</p>


²⁹⁴ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Studentët ,Biblioteka studentore.

²⁹⁵ Lista e teksteve në Bibliotekë FE UAMD Departamenti i Psikologjisë (Ref.Evidenca Nr.59)

²⁹⁶ Të dhëna për bibliotekën UAMD (Ref.Evidenca Nr. 56)

²⁹⁷ Rregullore e bibliotekës UAMD (Ref.Evidenca Nr. 57)

²⁹⁸ Manual Përdorimi biblioteka online (Ref.Evidenca Nr.54); Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika Studentët ,Biblioteka studentore




<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në mënyrë të vecantë të rregullore se saj dhe në faqen zyrtare të institucionit rezulton se biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 8.00 deri 16.00, dhe për informacionin elektronik ora 8.00 deri 20.00.</p> <p>Kjo është sanksionuar në rregulloren e saj si dhe afishuar në ambientet e bibliotekës dhe faqen zyrtare të institucionit.^{299 300}</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Bibliotekës studentore rezulton se ka një bashkëpunim të mirë mes strukturave të institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës si dhe përditësimin e këtij fondi si dhe nivelin e shfrytëzimit të tij.</p> <p>Biblioteka punonte sipas standarteve ndërkombëtare dhe udhëzimeve të përcaktuara nga IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Bibliotekave) dhe ka procedurë të përcaktuara bashkëpunimi me strukturat e tjera të UAMD për pasurimin e fondit të saj.^{301 302}</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standartit IV.3 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizites në institucion mendon se njësia kryesore që mbulon programin e studimit Departamenti i Psikologjisë, ka vënë në dispozicion të këtij programi tërë infrastrukturën e nevojshme si fizike ashtu edhe literaturën e nevojshme në shërbim të procesit të mësimi.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që në përgjithësi të rritet numri i librave apo publikimeve tek literatura e rekomanduar (pasi është nivel i dytë</i></p>

²⁹⁹ Rregullore e bibliotekës UAMD (Ref.Evidenca Nr. 57)

³⁰⁰ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Biblioteka studentore)

³⁰¹ Rregullore e bibliotekës UAMD (Ref.Evidenca Nr. 57)

³⁰² Raport I veprimtarisë ekonomiko- financiare UAMD 2021-2022 (Ref.Evidenca Nr. 111)




	<i>studimi) dhe në disa syllabuse të ketë përditësim të saj me literaturë të paktën të 7-8 viteve të fundit. (Kriteri 1;2),</i> <i>GVJ mendon se standarti përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAMD dhe Fakulteti i Edukimit si njësi përbërëse e saj, ka një sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky sistem përfshin Departamentet, Sekretarinë mësimore, Sistemi PITAGORA, Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve akademike, sektori i IT që ofron një sasi aplikacionesh të integruara me njëra tjetrën e cila jep mbështetje të plotë për procedurat e administrimit të mësimdhënies dhe vetëshërbimit nga ana e studentëve ^{303 304 305}
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në Fakultetin e Edukimit si dhe strukturat e tjera ndihmëse si sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve akademike, Sekretarisë mësimore rezulton të ketë një sistem menaxhimi të informacionit, bazuar në një rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit, ku administrohet tërë dokumentacioni që lidhet me përditësimin e të dhënave të stafit akademik ndihmës akademik dhe administrativ lidhur me tërë veprimtarinë e tyre në kuadrin e realizimit të programit të studimit Master. ^{306 307 308}

³⁰³ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime, Pitagora, Sekretaria mesimore)

³⁰⁴ Të dhëna tabelore për studentet e Master Shkencor Mesues i Shkencave Sociale (Ref. Evidenca Nr. 68)

³⁰⁵ Rregullore e Fakultetit të Edukimit në UAMD nenet 81 -87. (Ref. Evidenca Nr.11)

³⁰⁶ Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD: (Ref. Evidenca Nr. 52)

³⁰⁷ Të dhëna tabelore për personelin akademik në Masterin e Shkencave "Mesues i Shkencave Sociale" (Ref. Evidenca Nr.65)

³⁰⁸ Rregullore e Fakultetit të Edukimit në UAMD neni 17;19;32;81;83;84;87. (Ref. Evidenca Nr.11)

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të sistemit të menaxhimit rezulton se të dhëna lidhur me dokumentacion janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të UAMD dhe të njësive përkatëse. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UAMD dhe Fakultetit të Edukimit, ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” siguron të akses të informacioneve dhe e dokumentave. Sektori i çështjeve mësimore pranë Drejtorisë së kurrikulave dhe standarteve të cilësisë, vë në dispozicion të studentëve si planin mësimor, syllabeset, të dhëna të tjera kur kërkohen kopje fizike e tyre^{309 310}</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UAMD dhe Fakultetit të Edukimit, ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studenteve. Një platformë e tillë është Platforma Pitagora, që jep mundësi komunikimi të pedagoqeve me studentë për aspekte të tilla të procesit mësimor si: të dhëna për frekuentimin, analizë të esëve të studentëve dhe detyrave të kursit, notat e provimeve, oraret për takime apo konsultime.³¹¹</p> <p>Një mundësi komunikimi është edhe Web.i universitetit, rrjetet sociale si dhe përdorimi i platformave Google Drive; Classroom team; Zoom etj.^{312 313 314}</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit pranë Departamentit të Psikologjisë rezulton se në vijimsinë e punës organizohen vazhdimisht monitorime që lidhen me aktivitetin akademik dhe administrativ. Mbi bazën e informacionit të mbledhur herë pas here rezulton se bëhen mbledhje për vlerësimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të stafit, përgaditet një material përmbledhës që i vihet në dispozicion si Drejtuesit të fakultetit ashtu edhe stafit.^{315 316}</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet</p>	<p>Nga verifikimi në Faqen zyrtare të UAMD-së mund të konfirmojmë se institucioni publikon vazhdimisht informacione për të gjitha fushat e funksionimit në Universtitetit dhe në këtë kuadër edhe të</p>

³⁰⁹ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime, Pitagora, Sekretaria mesimore)

³¹⁰ Manual përdorimi të sistemit PITAGORA nga sekretaria mesimore, pedagoqe dhe studente. (Ref.Evidenca Nr. 181)

³¹¹ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> (Sherbime, Pitagora)

³¹² Shembull i përdorimit të platformës Zoom për zhvillimin e leksioneve gjatë pandemisë, 2021). (Ref.Evidenca Nr.188).

³¹³ Udhëzues për përdorimin e platformës online Classroom Teams. (Ref.Evidenca Nr.185)

³¹⁴ Strategjia e Komunikimit, UAMD. https://uamd.edu.al/epcontent/uploads/2023/03/Strategjia_e_Komunikimit.pdf

³¹⁵ Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut nga eprori/kolegu - shembuj të plotësuar V.A. 2022-2023). (Ref.Evidenca Nr.92)

³¹⁶ Formularët e plotësuar të vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore Departamenti Psikologji, 2016). (Ref.Evidenca Nr.93)




e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	informacionit që lidhet me programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale”. Në këtë faqe zyrtare ka të dhëna për departamentin pedagogët, studentët, urdhëra dhe udhëzime, veprimtari si dhe informacion që lidhet me programin e studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standartit IV.4 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion mendon se Fakulteti i Edukimit që mbulon këtë program studimi, ka një sistem menaxhimi institucional të aksesueshëm për të gjithë publikuar në faqen zyrtare dhe njëherësh në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i> GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UAMD harton çdo vit nepërmjet Drejtorisë së financave një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat lidhur me veprimtarinë akademike dhe shkencore të institucionit. ³¹⁷ Edhe Departamenti i Psikologjisë harton një plan financiar lidhur me kostot e programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” duke përcaktuar pagesat e pedagogëve, mjetet didaktike të nevojshme, shpenzime të tjera, të cilat ja paraqet Dekanit të fakultetit, dhe Drejtorisë së financave. ³¹⁸

³¹⁷ Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-Financiare UAMD, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.111)

³¹⁸ Plan buxheti afatmesëm Departamenti Psikologji, 2024 – 2026.(Ref. Evidenca_Nr.79)

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo</p>	<p>UAMD nepërmjet Drejtorisë së financave ka një plan financimi për tërë strukturat universitare i cili miratohet në Senatin akademik të institucionit.³¹⁹</p> <p>Rezulton nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në UAMD se njësisia bazë Departamenti i Psikologjisë paraqet para Dekanit një plan buxhet financiar me kërkesat për mbulimin e shpenzimeve në tërësi ku përfshihen edhe shpenzimet për programin e studimit, kërkesa mbi të cilat hartohet edhe plani financiar që miratohet nga Senati akademik, dhe Bordi i Administrimit.³²⁰ Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatohet se është planifikuar sipas zerave të caktuar në buxhet, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, mirëmbajtje e mjediseve dhe blerje të mjeteve didaktike, si dhe shpenzime për bibliotekën online.^{321 322}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr 83, date 03.02.2016, auditimit të brendshëm në Sektorin publik, UAMD ka njësi auditimi Drejtorinë e auditimit, por nuk rezulton se ka ndonjë raport auditimi për institucionin.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konfirmojmë se UAMD bazuar në Udhëzimin Nr. 5, date 19.02.2018 “Per përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit çdo vit sipas afatit të përcaktuar, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zerave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit. Ky rapor i dergohet edhe MAS dhe i bëhet i njohur tërë njësisive të institucionit fizikisht dhe në faqen zyrtare.³²³</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Drejtorinë ekonomike dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se UAMD garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë Departamentit të Psikologjisë dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxheti i shteti, të ardhurat që</p>

³¹⁹ Miratimi i Raportit të aktivitetit vjetor ekonomik-financiar të UAMD, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021. (Ref. Evidenca_Nr.113)

³²⁰ Plan buxheti afatmesëm Departamenti Psikologji, 2024 – 2026.(Ref. Evidenca_Nr.79)

³²¹ Plan buxheti afatmesëm Departamenti Psikologji, 2024 – 2026.(Ref. Evidenca_Nr.79)

³²² Të ardhurat dhe financimet e ndryshme 2016-2020, UAMD. (Evidenca_Nr.114; 113).


³²³ Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-Financiare UAMD, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.111); Faqja zyrtare

<p>Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vinë nga projektet^{324 325}</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ lidhur me standartin konkludon se Institucioni (UAMD dhe Fakulteti i Edukimit) nepërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit të tij garanton financimin dhe mbeshtetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në "Mësues i Shkencave Sociale".</i></p> <p><i>Ka një raport vjetor të veprimtarisë financiare të institucionit, ka instrumentat e kontrollit të kësaj veprimtarie, por nuk rezulton se ka një raport auditimi periodik të institucionit. (kriteri 3)</i></p> <p>GVJ mendon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

³²⁴ Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-Financiare UAMD, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.111)

³²⁵ Miratimi i Raportit të aktivitetit vjetor ekonomiko-financiar të UAMD, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021. (Ref. Evidenca_Nr.113)




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në rregulloren e Fakultetit të Edukimit neni (46;47), dhe të Rregullores së programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” (neni 13; 27; 31; 32) rezulton se janë përcaktuar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve të saja rregullatore një sërë procedurash që lidhen me mbulimin e studentëve nga rregjistrimi e deri në përfundim të studimeve. ^{326 327} Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me studentë, rezulton se studentët njihen që fillim me kriteret e pranimin dhe të konkurimit nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare nga ana e institucionit, me planin mësimor dhe kërkesat e programeve të lëndëve, mënyrën e komunikimit dhe të ankimimit, përparimit të tyre etj. ^{328 329 330}
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procedurat që ndiqen nga UAMD për pranimet në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin në Senatit akademik dhe MAS të kriterëve dhe kuotave (duke parashikuar kuota për kandidatë të vecantë, nga trojet, pakicat kombëtare, persona me aftësi të vecantë, dhe shpallja e tyre në faqen zyrtare të institucionit), garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit. ^{331 332}
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe në takimin me drejtues të institucionit, rezulton se Fakulteti i Edukimit bazuar në propozimin e njësisë bazë Departamentit të Psikologjisë harton dhe dergon për

³²⁶ Udhëzimi i MAS Nr.10, Dt. 16.6.2023 “Mbi përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar”. (Ref.Evidenca_Nr.199)

³²⁷ Rregullore e Fakultetit të Edukimit(Ref. Evidenca_Nr.11)

³²⁸ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Studentët,kriteret e pranimin)

³²⁹ Kriteret e pranimin të studentëve Fakulteti i Edukimit V.A. 2021-2022.(Ref. Evidenca_Nr.127)

³³⁰ Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimin të studentëve në të gjitha programet e studimit V.A. 2021-2022.(Ref. Evidenca_Nr.125)

³³¹ Rregullore e Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”. (Ref. Evidenca_Nr.15)

³³² Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimin të studentëve në të gjitha programet e studimit V.A. 2021-2022.(Ref. Evidenca_Nr.125)

<p>përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>miratim në Senatin akademik çdo vit kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Pas miratimit të këtyre kriterëve nga MAS ato publikohen në faqen zyrtare të UAMD.^{333 334}</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezulton se Fakulteti i Edukimit si njësi përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” në rregulloren e studimit të programit (nenet 13; 22; 24; 28; 31; 32; 33). ka miratuar dhe i ka të aksesueshme pranë sekretarive mësimore në formë shkresore dhe elektronike, si dhe në faqen zyrtare të institucionit rregulloret e studimit të ciklit të dytë, rregulloren e pranimit dhe konkurimit, të cilat bëjnë të mundur njohjen nga të gjithë studentët dhe të interesuar të kriterëve dhe procedurave të pranimit në programin e studimit Master i shkencave”, si dhe informacion për njohjen dhe mënyrat e vlerësimit, transferimit apo ekuivalentimit të studimeve të mëparshme.³³⁵ Nepërmjet Platformës Pitagora studentët njihen online për përparimin e tyre në kohë reale.³³⁶</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit rezulton se çdo vit akademik i bën të ditura studentëve të nivelit bachelor dhe palëve të tjera të interesuara kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta, informacion mbi organizimin dhe përmbajtjen e Masteri Shkencor “Mesues i Shkencave sociale”. Kjo realizohet nepërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale, faqes shtetërore dhe portalit U-Albania si dhe fletë palosjeve dhe javës së informimit.^{337 338}</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me</p>	<p>Nga dokumentacioni rezulton se UAMD harton çdo vit akademik kriteret për pranimet në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin në Senatin akademik dhe MAS të kriterëve dhe</p>

³³³ Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> (Studentët, kriteret e pranimit)

³³⁴ Vendim Senati Akademik për kriteret e pranimit të studentëve në nivelin e parë dhe të dytë të studimeve V.A. 2023-2024, Fq.19). (Ref.Evidenca Nr.122).

³³⁵ Rregullore e Masterit Shkencor “ Mesues i Shkencave sociale”. (Ref.Evidenca 15.)

³³⁶ Manuali i përdorimit të sistemit Pitagora-RASH, Manuale për sekretarinë, pedagogun, studentin.(Ref. Evidenca_Nr.181) <https://ëëë.rash.al/sq/softëare/universitare/pitagora/>

³³⁷ Informacion dhe shërbime dedikuar studentëve të UAMD përmes faqes zyrtare UAMD.<https://uamd.edu.al/studentet/>

³³⁸ Përshkrimi në faqen zyrtare të UAMD i programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale.(Ref. Evidenca.Nr.158) <https://uamd.edu.al/mesues-ne-shkencat-sociale/>

aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	kuotave për kandidatë me aftësi të vecantë, pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke i bërë publike në faqen zyrtare të institucionit. ³³⁹			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren programit të studimit nivelit të dytë Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” (neni 11) konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës. ³⁴⁰			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të UAMD rezulton se në rubrikën Studentët, Bursa, Departamenti i Psikologjisë publikon të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për të ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. Në takimin me studentë dhe në sekretarinë mësimore u konfirmua ky fakt. ^{341 342}			
Konkluzione	<i>GVJ GVJ bazuar ne analizen e kriterев 1-8 te standartit V.1 te dokumentacionit te paraqitur dhe vizites ne institucion mendon se UAMD ka një sistem dhe procedura transparente të pranimit ndjekjes dhe mbeshtetjes se studentëve i cili është i aksesueshëm nga të gjithë nepërmjet publikimeve në faqën zyrtare të tij ndaj GVJ gjykon se standarti permbushet plotesisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë	UAMD ka një strukturë efektive dhe vë në dispozicion të studentëve të programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” një

³³⁹ Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit V.A. 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.125)

³⁴⁰ Rregullore e Masterit Shkencor “ Mësues i Shkencave sociale”. (Ref.Evidenca 15.)

³⁴¹ Raport i Veprimtarisë Ekonomiko-Financiare UAMD, 2021-2022. (Ref.Evidenca_Nr.111)

³⁴² Faqja zyrtare e UAMD-së. <https://uamd.edu.al> (Studentët)

<p>dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>informacion të vazhdueshëm lidhur me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Kjo është sanksionuar në rregulloren e programit në nenet 17; 19; 22 deri 32,³⁴³</p> <p>Informimi i studentëve behet edhe nga Sekretaria mësimore, nga pedagogët nepërmjet sqarimit të syllabuseve të planit mësimor, guides së studentëve, dhe nga platforma Pitagora që janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.³⁴⁴</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe takimin me studentë, konfirmohet se UAMD ka një sistem informimi të studentëve si Rregullorja e studimeve (neni 32) Sekretaria mësimore, dhe Zyra e kurrikulave dhe lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme.³⁴⁵</p> <p>Në takimin me studentë të këtij programi kishte një student i cili kishte mbaruar me parë një master profesional dhe në programin e ri i ishte njohur ku kualifikim i bërë nepërmjet njohjes së lëndëve që ajo i kishte dhënë provim, por nuk ka evidence per kete aspekt.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me stafin dhe studentet gjatë vizitës rezulton se studentët njihen që në ditën e pare të mësimin të lëndëve si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimit të cilat janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, dhe në rregulloren e studimit të këtij programi.</p> <p>Duhet thene se kjo mënyrë vlerësimi (nga 1000 pikë 400 janë të provimit të ndërmjetëm,500 pikë provimi përfundimtar dhe 100 pikë detyra esse projekte gjatë vitit). i jep <i>përparësi vlerësimeve me shkrim dhe jo vlerësimit të vazhdueshem në forma të tjera të studentit</i>³⁴⁶</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Përveçse e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit (neni 19; 20; 21,) dhe në Manualin për punimin e diplomës, në planin mësimor është planifikuar një 2 deri në 3 orë në javë në auditor e udhëheqësit me studentin si mundësi edhe informimi ndihme dhe kontrolli të tyre lidhur me ecurine e përgatitjes së diplomës si pjesën që lidhet me performancën ashtu edhe me përgatitjen e mikrotezës.^{347 348}</p>

³⁴³ Rregullore e Masterit Shkencor " Mesues i Shkencave sociale". (Ref.Evidenca 15.)

³⁴⁴ Manual perdorimi te sistemit PITAGORA nga sekretaria mesimore,pedagoge dhe studente.(Ref.Evidenca Nr. 181)

³⁴⁵ Rregullore e Masterit Shkencor " Mesues i Shkencave sociale". (Ref.Evidenca 15.)

³⁴⁶ Syllabuset e programit të studimit Master i Shkencave "Mesues i shkencave sociale".

³⁴⁷ Rregullore e diplomimit për studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Edukimit. ((Ref.Evidenca_Nr.34)

³⁴⁸ Manual për punimin e diplomës master në Fakultetin e Edukimit. (Ref.Evidenca_Nr.35)

	Studenti përveç takimeve me pedagogun udhëheqës komunikon me të edhe nepërmjet E-Mail -it për të sqaruar apo miratuar materialin sipas procedurave të percaktuara në rregulloren e diplomimit (neni 8;9) ³⁴⁹			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në faqen zyrtare të UAMD në rubrikën Studentët -Alumni jepet një informacion i plotë lidhur me programin e studimit, kriteret dhe procedurat e rregjistrimit. Po kështu institucioni publikon Guidën studentore' rrjetet sociale dhe javën e informimit ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program. ³⁵⁰			
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se UAMD disponon dhe publikon në web-in e tij në shërbim të studentëve tërë informacionin e nevojshëm për njohjen me të gjitha aspektet e rregjistrimit vlerësimit dhe përfundimit të studimeve në këtë program studimi Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale".</i> <i>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga dokumentacionit të paraqitur më GVB si Rregullore e studimit të Departamentit të Psikologjisë, Rregullores së programit Master i Shkencave "Mësues i Shkencave sociale", u konfirmua se nepërmjet sekretarisë mësimore, dhe njërive të tjera ndihmëse, pedagogëve në paraqitjen e syllabuseve ata marrin një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën dhe organizimin e programit të studimit. ³⁵¹ . Në takimin me studentë rezultoi se ata merrnin

³⁴⁹ Rregullore e diplomimit Bachelor dhe Master (Ref.Evidenca Nr.34)

³⁵⁰ Java e informimit të studentëve për programet e studimit. (Ref. Evidenca Nr 164)

³⁵¹ Rregullore e Masterit Shkencor " Mesues i Shkencave sociale". (Ref.Evidenca 15.)

	informacione të përditësuara për programin e studimit edhe nepërmjet faqes zyrtare rrjeteve sociale dhe informacioneve të afishuara në ambientet e fakultetit. ³⁵²
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se UAMD ka përcaktuar në rregulloret e saj përgjegjësinë e tërë strukturave të saj për informimin e studentëve lidhur me përbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale. Në takimin me studentë u deklarua se ato merrnin informacion si nga pedagogët, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UAMD-së apo rrjetet sociale dhe Google classroom ^{353 354}
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në faqen zyrtare të UAMD, në rubrikën Kariera dhe Alumni rezulton se kjo strukturë organizon veprimtari me studentë si për orientimin në tregun e punës ashtu edhe për trainimin e tyre për përgatitjen e CV- së, leter motivimin etj. ³⁵⁵ Nga takimi me studentë u konfirmua se ata merrnin vazhdimisht informacion nga zyra e programit të karrierës për mundësitë e punësimit të tyre. Ata konfirmuan se kishte takime dy apo tre here në vit ku jo vetëm njiheshin me tregun e punës por edhe me mënyrën e konkurimit për vend pune ³⁵⁶ Në takimin me zyrën e Karrierës dhe Alumni, përveç se aktiviteteve të cilat janë pasqyruar në faqen zyrtare nuk ishin të evidentuara takimet me tematikën dhe numrin e pjesëmarrësve që shërbeu edhe si evidencë për takimet e realizuara me studentë nga kjo njësi.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë vizitës konstatuam se UAMD, Njësia kryesore dhe Bazë, nepërmjet një sistemi menaxhimi eksistues efektiv (Sekretari mësimore, Drejtoria e kurrikulave dhe standarteve të cilësisë, Grupe lëndët, takimet informuese në fillim viti shkollor, faqja zyrtare e institucionit) vë në

³⁵¹ Manual perdorimi te sistemit PITAGORA nga sekretaria mesimore,pedagoge dhe studentë

³⁵² Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> . Rubrika studentët.

³⁵³ Përshkrimi në faqen zyrtare të UAMD i programit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale. (Ref. Evidenca_Nr.158)<https://uamd.edu.al/mesues-ne-shkencat-sociale/>

³⁵⁴ Udhëzues i Karrierës, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. (Ref.Evidenca_Nr.161)<https://eëë.uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21Maj-2020.pdf>

³⁵⁵ Faqe zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al> . Rubrika studentët. Kariera dhe Alumni.

³⁵⁶ Vizita në institucion. (Ref. Minuta në takimin me studentë)

	dispozicion të studentëve një informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin. ^{357 358} Gjatë vizitës u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të programit një infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e tij.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se institucioni UAMD ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacioni duke filluar nga faja zyrtare, sekretaria mësimore, strukturat ndihmëse akademike, sistemi PITAGORA dhe aksesit në internet me platformat Google Classroom, Moodle. Këto struktura ndihmojnë studentët të marrin informacion për veprimtarinë mësimore gjatë frekuentimit të programit, rregjistrimet në provime dhe rezultatet e vlerësimit, të dhëna për lëndët, mjetet didaktike dhe tekstet. ³⁵⁹			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar ne analizen e kriterев 1-5 te standartit V.3 te dokumentacionit te paraqitur dhe vizites ne institucion mendon se standarti realizohet plotësisht pasi ka një sistem efektiv menaxhimi të informacionit të përditësuar të aksesueshëm që lidhet me programin Master i Shkencave "Mesues i shkencave sociale"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe vërtifikimit të tyre gjatë vizitës në institucion në sekretarinë mësimore, rezultoni se UAMD disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për

³⁵⁷ Java e orientimit për studentët FE, UAMD, 17 Tetor 2022. (Ref.Evidenca_Nr.164)

<https://ëëë.facebook.com/departamentipsikologjisefakultetiedukimituamd/posts/pfbid0sf8Gi3x4yBoFCcnS6HA6oMcJ35bKGUEE34H3eMhUfoM2gE74Sds3YjtiEënJul>

³⁵⁸ Guida e studentit, UAMD, 2022-2023. (Ref.Evidenca_Nr.157)

<https://uamd.edu.al/ëpcontent/uploads/2022/11/GUIDA-E-STUDENTIT-2022-2023-pdf.-1.pdf>

³⁵⁹ Faqja zyrtare UAMD <https://uamd.edu.al>




<p>studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>herë të parë dhe atyre që diplomohen. Sektori i Karrierës dhe Alumni përditëson çdo vit të dhëna lidhur studentët e diplomuar bazuar në pyetsorët online që ajo u kërkon atyre.^{360 361}</p> <p>Statistika vjetore për studentët e diplomuar mban edhe Sekretaria Mësimore, dhe Departamenti i Psikologjisë të pasqyruara në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore kërkimore të tij.³⁶²</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, dhe të sistemit PITAGORA rezultojnë se për Masterin e Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” ka statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi. Në këto statistika jepet edhe numri i të larguarve, apo edhe të çrregjistruar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2018-2019 nga 13 studentë të regjistruar 9 janë diplomuar; - Në vitin akademik 2019 - 2020 nga 39 studentë të regjistruar 7 janë diplomuar dhe 1 studentë nuk ka frekuentuar; - Në vitin akademik 2020-2021 nga 32 studentë të regjistruar 1 student është transferuar, dhe 12 janë diplomuar; - Në vitin 2021-2022 janë regjistruar 11 studentë, 1 student është çrregjistruar, 1 student transferuar, ndërsa 22 janë diplomuar; - Në vitin 2022-2023 janë regjistruar 8 studentë; <p>Të gjitha këto të dhëna u verifikuan në sekretarinë mësimore gjatë vizitës në fakultet³⁶³</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe</p>	<p>Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësisë si dhe aktivitetit të dy sektorëve të këtij institucioni Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Kariera dhe Alumni rezultojnë se këto njësi menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit, dhe publikojnë në faqen zyrtare raportet e tyre.³⁶⁴</p>

³⁶⁰ Informacion mbi punësimin e të diplomuarve Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” 2018-2021.(Ref. Evidenca_Nr.70).

³⁶¹ Pyetësori tip për gjurmimin e punësimin të studentëve të programeve master, Departamenti i Psikologji. (Ref.Evidenca_Nr.71.1)

³⁶² Raporte vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të Departamentit të Psikologjisë, 20192020; 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023.(Ref. Evidenca_Nr.78).

³⁶³ Të dhëna të plota tabelore për studentët në Mësues i Shkencave Sociale për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, V.A 2018-2023.(Ref. Evidenca_Nr.68).

³⁶⁴ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, UAMD. <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf>




lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>Nga dokumentacioni që ka në dispozicion UAMD rezulton se ka të përcaktuar qartë në aktet dhe rregulloret e tij kontrollin periodik nga tërë njësitë që menagjojnë programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” Drejtoria e Kurrikulës dhe standarteve të cilësisë Sektori i çështjeve mësimore, NJSBC ushtrojnë kontrolle mbi njësitë përgjegjëse për standartet e cilësisë të brendshme të institucionit, kurrikulave dhe mësimdhënies, marrin feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, bëjnë analizë të gjendjes dhe dergojnë Komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë i cili harton një raport vjetor që i dërgohet Rektorit, miratohet në Senat dhe më pas i dërgohet gjithë njësive bazë që mbulojnë programe studimi të nivelit të dytë.³⁶⁵</p> <p>Në shkallë institucioni njësia mbikqyrëse “Komisioni i përhershëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë” përcakton kriteret, instrumentet matës dhe mënyrat e publikimit të rezultateve.³⁶⁶</p>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Konfirmojme se njësia bazë që mbulon programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” Departamenti i Psikologjisë ka një dokumentacion të plotë lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, punësimin e tyre nepërmjet bashkëpunimit me Sektorin mësimor dhe programin e karrierës,^{367 368} bën raporte analitike, por nuk rezulton se ka plan masash për përmirësimin e treguesve.</p>
Konkluzione	<p>GVJ konkludon se Fakulteti i Edukimit nepërmjet njësive përbërëse të saj administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit bën raporte analitike, por nuk rezulton se reflekton me një plan masash për përmirësimin e treguesve (Kriteri 5),</p>

³⁶⁵ Statuti I UAMD. Neni 79;80;81. Faqja Zyrtare e UAMD-së Rubrika Transparence (Informacione dhe dokumenta)

³⁶⁶ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, UAMD (Ref.Evidenca_Nr.16) <https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf>

³⁶⁷ Të dhëna nga Alumni mbi punësimin e të diplomuarve, programet master Shkencor “Mësues i Shkencave sociale. (Ref.Evidenca_Nr.70)

³⁶⁸ Vlerësimi i studentëve për programin Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” V.A. 2021-2022.(Ref. Evidenca_Nr.94.1)

	GVJ gjykon se standardi përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konfirmojmë se UAMD ka përfshirë studentët nepërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si në Senatin akademik, Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, Këshillit studentor zgjedhur në 2016 si vetorganizim i studentëve, në GVB, dhe shoqata dhe forume studentorë. ³⁶⁹ Aktualisht janë 2 studentë antarë të Senatit, 1 student antarë i Këshillit të Etikës, 1 student në GVB, 1 antarë në Bordin e Administrimit ³⁷⁰
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me studentë dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ka një përfshirje reale të studentëve në vendimmarrje dhe në vlerësim të procesit mësimor, që ka dhënë ndikimin e vet edhe në veprimtarinë e institucionit. Kështu në takimin me studentë u theksua se pyetësi që realizohet për të dhënë opinionin mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, që realizohet në cdo fund semestri, ka ndikuar në përmirësimin e punës së pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi. ^{371 372 373} Në takimin me drejtues dhe stafin e programit na u konfirmua se pedagogët që kishin mangësi në performancën e tyre, ose nuk u jepej

³⁶⁹ Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të UAMD. (Ref.Evidenca_Nr.118)

³⁷⁰ Anëtarët e Këshillit Studentor të FE, 2022. (Ref. Evidenca_Nr.139)

<https://ëëë.facebook.com/uamdofficial/posts/pfbid0QpzRh16Jo54eDXdBBZhRsfepLT4195HmEu61jKK8HHr4cnf3oCyHu3XpXVm8BRBil>

³⁷¹ Urdhër për realizimin e vlerësimit të lektorëve nga studentët Sem I, V.A. 2019-2021). (Ref. Evidenca_Nr.155)

³⁷² Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit. (Ref.Evidenca_Nr.153)

³⁷³ Raport dhe pyetësi për studentët për matjen e nivelit të kënaqësisë me shërbimet e sektorit të Karrierës dhe Alumnit në UAMD, Gusht -Shtator 2021. (Ref. Evidenca_Nr.162)

	më lënda ku ishin lektor ose i nënshtroheshin trainimeve në Qendrën e Edukimit në vazhdim. ^{374 375}			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë rezultoi se gjatë tërë vitit akademik ushtrohen kontrole mbi ecurinë e procesit mësimor, dhe mbi bazën e tyre bëhet një analizë e plotë dhe nxirren konkluzione duke i pasqyruar ato në një raport vjetor në hartimin e të cilit janë të pranishëm edhe studentët. ³⁷⁶ Ato japin mendime dhe sugjerime për programin e studimit në takime që organizohen, fokus grupe, pyetësorë etj, të cilat merren në konsideratë për përmirësimin e programit të studimit. ³⁷⁷ Një proces i tillë ku është evidentuar edhe kontributi i studentëve ka qënë edhe riorganizimi i programit me Urdherin 7238/1 të MAS datë 31.08.2018 nga Master Shkencor Mesimdhënie në Psikologji Sociologji në Master Shkencor Mesues i Shkencave sociale.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se institucioni ka sanksionuar në statutin dhe rregulloret e miratuara (rregullore e FE. neni 67; 68; 69) barazine dhe ndershmërinë në vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit, dhe të rishikimit të vlerësimit. ³⁷⁸			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në analizen e kriterëve 1-4 të standartit V.5 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion mendojnë se UAMD e përmbush plotësisht standartin pasi ka një përfshirje reale të studentëve në organet vendimmarrëse dhe merr në konsideratë të gjitha sugjerimet që vinë nga ata.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁷⁴ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> (FE. Qendra e Edukimit në vazhdim)

³⁷⁵ Trajnimi i stafit nga QEV- Udhë zues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme në mesimdhënie). (Ref. Evidenca Nr.137)

³⁷⁶ Statuti I UAMD.

³⁷⁷ Vlerësimi i studentëve për programin Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" V.A. 2021-2022. (Ref. Evidenca Nr.94.1).

³⁷⁸ Rregullore e Fakultetit të Edukimit. (Ref.Evidenca Nr.11)

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka njësi shërbimi dhe informimi të studentëve si: Sekretaria Mësimore; Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve Akademike, (sektori i Karrierës/Alumni dhe Komunikimi si dhe sektori i IT), Këshilli studentor, Sistemi PITAGORA etj në dispozicion të studentëve të rregjistruar në programin e studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” si edhe rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion.^{379 380} Informacioni dhe veprimtarit konkrete për studentë dhe pedagogë publikohen në faqen zyrtare të UAMD dhe në rrjetet sociale Facebook.³⁸¹</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Rezulton se UAMD ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimor e të studentëve, duke e sanksionuar me urdhër Rektorati mënyrën e funksionimit të sistemit të tutoriali dhe mentorimit, si dhe të javës së informimit të tyre.^{382 383}</p> <p>Për ndjekjen dhe marrjen informacion për përparimin e studentëve rezulton se funksionon platforma Pitagora, ku studentët rregjistrohen nga sektori i IT, aplikacionit Moodle dhe Google Classroom.³⁸⁴</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga takimi me përfaqësuesen e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës rezulton se kjo zyrë realizon një bashkëveprim të mirë me studentët duke u ofruar atyre informacion mbi procesin mësimor, probleme që lidhen me praktikën profesionale, dhe në mënyrë të vecantë orientimin e tyre për tregun e punës,³⁸⁵</p>

³⁷⁹ Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, neni 14; 15; 18; 19. Evidenca_Nr.50.

³⁸⁰ Rregullore e sekretarisë mësimore në Fakultetin e Edukimit, neni 5; 6; 7; 8. (Ref.Evidenca_Nr.17)

³⁸¹ Faq zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> Rubrika : Te reja (Lajme dhe Kalendarium)

³⁸² Mbi Organizimin e Tutorialit/Mentorimit në UAMD.(Ref. Evidenca_Nr.116.)

³⁸³ Java e orientimit për studentët FE, UAMD, 17 Tetor 2022).

<https://ëëë.facebook.com/departamentipsikologjiiefakultetiedukimituamd/posts/pfbid0sf8Gi3x4yBoFCcnS6HA6o>

[McJ35bKGUEE34H3eMhUfoM2gE74Sds3YjtiErtEënJul](https://ëëë.facebook.com/departamentipsikologjiiefakultetiedukimituamd/posts/pfbid0sf8Gi3x4yBoFCcnS6HA6o) (Ref. Evidenca_Nr.164/1)

³⁸⁴ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al/studentet/>

³⁸⁵ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al/studentet/> (Rubrika studentet Karriera dhe Alumni)

mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në takimin me studentë u tha se kjo zyrë ka vazhdimisht kontakte me to dhe se dy ose tre herë në vit ka aktivitete të programuara në grup, për informimin apo orientimin e tyre për aspekte të ndryshme ³⁸⁶			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe nga vizita në institucion konfirmojmë se Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve Akademike, (sektori i Karrierës Alumni dhe Komunikimi) përdor një pyetsor me studentët e diplomuar dhe merr të dhëna lidhur me punësimin e studentëve pas mbarimit të Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave sociale” duke i ruajtur në një databazë, e cila është e aksesueshme për të gjitha njesitë e institucionit. ^{387 388}			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se institucioni nepërmjet njësive të ngritura e ka të konsoliduar si informimim ashtu edhe orientimin e studenteve në aspekte të ndryshme të procesit mësimor dhe të punësimit. Një proces i tillë realizohet nga Sektori i Karrierës dhe Alumni nepërmjet takimeve me studentë dhe publikimeve në faqen zyrtare të institucionit.</i> GVJ mendon se standarti përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁸⁶ <https://uamd.edu.al/studentet/>

³⁸⁷ Pyetësori tip për gjurmimin e punësimit të studentëve të programeve master, Departamenti i Psikologji. (Ref. Evidenca Nr.71.1).

³⁸⁸ Të dhëna nga Alumni mbi punësimin e të diplomuarve, programet master FE, 2021- 2022. (Ref. Evidenca Nr.69)

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se UAMD ka një strategji të sektorit të Teknologjise dhe Informacionit me qëllim edhe përmisimin e teknologjisë në shërbim të mësimdhënies ka hartuar një udhëzues për përdorimin e platformës online Classroom Teams dhe ka një manual për përgatitjen dhe korigjimin e provimeve në Clean Score, por jo manual për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. ^{389 390} Në qëndrën e Edukimit në vazhdim janë përgatitur një sërë modulesh për trainimin e pedagogëve me metoda bashkohore të mësimdhënies, por nuk ka evidenca të realizimit të tyre, të numrit të pjesmarrësve të kohës së realizimit, dhe nuk rezulton se ka një udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative. ³⁹¹
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësia kryesore si dhe vizita e bërë në institucion rezulton se Fakulteti i Edukimit në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë si përgjegjëse për këtë program studimi, ka në funksionim të vazhdueshëm mekanizma dhe struktura (Komisioni i perhershem për garantimin e cilësisë; NJSBC; Kordinatori institucional; Drejtorja e kurrikulave dhe standarteve të cilësisë) për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor të programit. NJSBC përdor instrumentë vlerësues të tillë si pyetsorë me studente, vlerësimi nga kolegë, dhe vetvlerësimin e performancës nga vetë pedagogu etj. ^{392 393 394} Në rregulloren e funksionimit të NJSBC janë të përcaktuara qartë detyrat për një vazhdimësi të monitorimit të procesit të mësimdhënies ³⁹⁵ , rezulton se ka një raport për zhvillimin e

³⁸⁹ Manual i krijimit të provimit, vlerësimi me Clean Score). (Ref.Evidenca Nr.183.1)

³⁹⁰ Udhëzues për përdorimin e platformës online Classroom Teams). <https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/> (Ref.Evidenca Nr.185)

³⁹¹ Faqja zyrtare e UAMD. FE Qendra e Edikimit në vazhdim.

³⁹² Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (Ref.Evidenca Nr.16)

³⁹³ Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit . (Evidenca Nr.153)

³⁹⁴ Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut nga eprori/kolegu - shembuj të plotësuar V.A. 2022-2023. (Ref.Evidenca Nr.92).

³⁹⁵ Rregullore NJSBC. Faqja zyrtare e UAMD <https://uamd.edu.al> Rubrika Sherbime (NJSBC ,Rregullore e funksionimit)

	mësimdhënies në klasa virtuale realizuar në shkurt 2021, publikuar në faqen zyrtare por nuk ka të dhëna që tregojnë për një vlerësim periodik të aftësive të mësimdhënies dhe inovative të personelit pasi nuk ka të dhëna për vitin 2022.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nepërmjet rregulloreve të institucionit është e garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të studentëve. Përdorimi i pyetësorëve nga NJSBC-së për vlerësimin e performancës së pedagogëve dy herë në vit para provimeve, tregon për një përfshirje reale të studentëve në këtë proces. ³⁹⁶ Po kështu rezulton se ka një sistem për marrjen dhe menaxhimin e ankesave të studentëve në sekretarinë mësimore e cila disponon formularët e ankesave për studentët, e konfirmuar kjo edhe me raste nga takimi me studentë. ³⁹⁷			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezulton se ka një rubrikë ku flitet për sigurimin e cilësisë në faqen zyrtare të institucionit ku deklarohet funksionimi i Komisionit të sigurimit të cilësisë dhe i NJSBC, ka një publikim në faqen e internetit të institucionit për vlerësimin e mësimin online e realizuar në vitin akademik 2020-2021 <u>dhe jo ndonjë vlerësim të mëvonshëm.</u> ³⁹⁸			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nuk ka të dhëna të qarta të promovimit apo edhe të inkurajimit të praktikave të mira të dala nga mekanizmat e vlerësimit për nxitjen e personelit për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, përveçse përcaktim të procedurave të realizimit të vlerësimit si rregullore, plan strategjik i zhvillimit dhe raport veprimtarie shkencore, ndaj rekomandojme evidentimi dhe vlerësimi i veprimtarive të organizuara në kuadrin e realizimit të programit të studimit duke synuar marrjen e një feedbacku nga pjesëmarrësit për të kuptuar sa të efektshme dhe sa janë përputhur me pritshmëritë e tyre.			
Konkluzione	GVJ mendon se standarti përmbushet kryesisht pasi ndonëse ka një strukturë dhe një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë, duhet periodikisht të tregojë realizimin e këtij standarti, duke nxjerrë në pah dhe promovuar praktikat pozitive për të nxitur pedagogët për përmirësimin e performancës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

³⁹⁶ Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit . (Evidenca_Nr.153)

³⁹⁷ Faqja Zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al>. Rubrika Ankesa

³⁹⁸ Faqja Zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al> NJSBC Rubrika Dokumente dhe Informacione

			X	
--	--	--	---	--

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga vizita në UAMD dhe shqyrtimi i dokumentacionit që disponon institucioni për sigurimin e cilësisë rezulton se strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati Akademik; Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit; Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program. ^{399 400} Këto struktura punojnë mbi bazën e Planit strategjik të zhvillimit (2020-2025), rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. ⁴⁰¹ ;
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se UAMD ka ngritur një sistem për sigurimin e cilësisë i cili vepron bazuar në legjislacionin dhe rregulloren e miratuar për veprimtarinë e saj si institucion dhe rezulton se ka një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. ⁴⁰² Rezulton se studentët kanë përfaqësimin e tyre në këtë njësi, por nuk rezulton se ka një ekspert të jashtëm i cili do të ndihmonte në rishikimin apo dhënie sugjerimesh lidhur me përmirësimin e punës. ⁴⁰³ <i>Ndaj rekomandojmë përfshirjen e një eksperti të jashtëm në NJSBC të gjitha niveleve.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UAMD përdor si vlerësimin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe ka percaktuar në

³⁹⁹ Vendim Nr. 57, Dt. 25.05.2020 "Miratim i anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë", UAMD). (Ref.Evidenca_Nr.146)

⁴⁰⁰ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, UAMD) https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/Aneksi_IV_Model_i_organizimit_te_SBSC.

⁴⁰¹ . Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025) (Ref. Evidenca_Nr.3)

⁴⁰² Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025) (Ref. Evidenca_Nr.3)

⁴⁰³ Urdhër për ngritjen e NJSBC Fakulteti i Edukimit me ndryshim, 2022) (Ref. Evidenca_Nr.147)




<p>duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>rregulloren e brëndëshme të sigurimit të cilësisë edhe instrumentët përkatës për realizimin e vetvlerësimit si të institucionit ashtu edhe të programeve të studimit (të cilat mendoj se duhen rinovuar sipas formatit të ri të vlerësimit). Konfirmohet se UAMD i është nënshtruar 2 herë edhe vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe me vendimin e fundit të BA Nr 18. Date 24/03/2022 ka marrë vlerësim pozitiv 4 vite 2022-2026 .</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet nga dokumentacioni i paraqitur nga UAMD se analiza vjetore e veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësisë kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në tregues të qartë e të matshëm (si kontrollat e realizuara për mësimdhënien, pyetsorët me studentë, vlerësimi nga kolegët etj) ^{404, 405}. Të dhënat rezultojnë se mbledhen nga Drejtorja e kurrikules dhe sigurimit të cilësisë dhe raportet periodike miratohen në Senat, dhe më pas shpërndahen strukturave, por nuk rezultojnë të ketë promovime nxitëse për arritje më të mira në programin e studimit MSH MSHS</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizen e kriteve 1-4 të standartit VI.2 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion mendojnë se ka dhe funksionon një sistem i brëndëshëm i sigurimit të cilësisë si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel të njësive kryesore dhe njësive bazë i cili është transparent, por nuk rezultojnë se ka ekspertë të jashtëm të përfshirë në këtë proces.</i></p> <p>GVJ gjykon se standarti përmbushet plotësisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

⁴⁰⁴ Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit. (Ref. Evidenca_Nr.153)

⁴⁰⁵ Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik. (Ref. Evidenca_Nr.154)




Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni përdor mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” në shërbim të akreditimit, në përputhje me planin strategjik dhe rregulloren e institucionit për sigurimin e cilësisë.⁴⁰⁶</p> <p>Në rregulloren për funksionimin dhe sigurimin e cilësisë (neni 6;7;8; 10) përcaktohen qartë detyrat e NJSBC dhe Drejtorisë së kurrikulave për përgatitjen periodike të raporteve të vetvlerësimit. Çdo vit mësimit Departamenti i Psikologjisë bën vlerësimin e programit MSH MSHS duke evidentuar të dhëna të cilat shërbejnë për analizën vjetore, raportin analitik i cili miratohet në Senatin akademik.^{407 408}</p> <p>Rezulton se ky program studimi i është nënshtruar një procesi riorganizimi dhe riemërtimi, duke ju përgjegjur kërkesave të tregut të punës.⁴⁰⁹</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion rezulton se në evidencat e paraqitura për këtë kriter janë dhënë instrumentat e përdorur për vlerësimin e programit të studimit (Evidencat Nr. 109 relacion mbi aktivitetet; 152 rezultatet e anketimit të studenteve; 174 mungon; 94.1 vlerësim i studenteve për programin; 90 miratim dokumentacioni për GVB. 78 mungon), ka një analizë të vlerësimit të studentëve të përfituara nga pyetsorët me studentë, por nuk</p>

⁴⁰⁶ Plani i Zhvillimit Strategjik të MSH MSHS. Departamentit Psikologji, 2020-2025. (Ref. Evidenca_Nr.9)

⁴⁰⁷ Vlerësim i studentëve për programin e studimit MSH MSHS. Departamenti i Psikologjisë (Ref.Evidenca_Nr.94.1)

⁴⁰⁸ Raporte vjetore të veprimtarisë mësimore e kërkimore të Departamentit të Psikologjisë, 2021-2022; (Ref.Evidenca_Nr.78)

⁴⁰⁹ Propozim për riorganizim dhe riemërtim të programit MSH Mësimdhënie në Psikologji – Sociologji në MSH Mësues i Shkencave Sociale.(Ref. Evidenca_Nr.20)

<p>arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>ka një plan masash për të përmisuar mangësitë dhe promovimit të praktikave dhe arritjeve më të mira.⁴¹⁰</p> <p>Në planin e zhvillimit strategjik të programit MSH MSHS 2020-2025 behet një analizë SWOT për programin dhe përcaktohen objektivat strategjike nga ana e Departamentit të Psikologjisë.⁴¹¹</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion konfirmojmë që UAMD aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta (të cilat janë përcaktuar në rregulloren e funksionimit dhe të sigurimit të cilësisë, neni 5; 6), për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë: Pyetsori për vlerësimin e kurseve përbërëse të kurrikulës; Pyetsori për vlerësimin e praktikës profesionale, dhe të dhëna nga Alumni.^{412 413 414}</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion konfirmojmë që UAMD aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta (të cilat janë përcaktuar në rregulloren e funksionimit dhe të sigurimit të cilësisë), për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë: sondazhe dhe mbledhje informacioni nga studentë të diplomuar nga Alumni, lidhur me</p>

⁴¹⁰ Vlerësimi i studentëve për programin MSH MSHS. (Ref.Evidenca Nr. 94.1.)

⁴¹¹ Plani i zhvillimit strategjik të MSH MSHS (Ref. Evidenca Nr. 9)

⁴¹² Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit.(Ref. Evidenca _Nr.153)

⁴¹³ Model pyetësori për studentët e diplomuar, Alumni). <https://uamd.edu.al/karriera/>. (Ref.Evidenca _Nr.168)

⁴¹⁴ Rezultatet e pyetësorit të studentit për vlerësimin e praktikës mësimore V.A. 2022-2023).(Ref. Evidenca _Nr.43.1)

ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	përfitimet e tyre pas diplomimit, shkëmbim informacioni me institucionet bashkëpunuese etj. ^{415 416 417 418}			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka ngritur në sistem monitorimin dhe vlerësimi për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave Mësues i Shkencave Sociale, duke përdorur metoda dhe teknika si të drejtperdrejta ashtu edhe të terthorta, ndaj gjykon se standarti përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe	UAMD në procesin e sigurimit të cilësisë rezultojnë se ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në këtë proces. Kjo realizohet nepërmjet pjesëmarrjes të studentëve në aplikimin e procedurave dhe komisioneve të vlerësimit të cilësisë, bashkëpunimin me studentët e diplomuar nepërmjet Alumnit, Komisionit të përhershëm për garantimin e sigurimit të cilësisë, NJSBC etj. ^{419 420 421}

⁴¹⁵ Raport dhe pyetësori për studentët për matjen e nivelit të kënaqësisë me shërbimet e sektorit të Karrierës dhe Alumnit në UAMD, Gusht -Shtator 2021.(Ref. Evidenca Nr.162)

⁴¹⁶ Model pyetësori për studentët e diplomuar, Alumnit). <https://uamd.edu.al/karriera/> (Ref.Evidenca Nr.168)

⁴¹⁷ Pyetësori për progresin e bashkëpunimit me institucionet bashkëpunuese (Ref. Evidenca Nr.177.1)

⁴¹⁸ Pyetësori për progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet e praktikës profesionale (Ref. Evidenca Nr.177.1)

⁴¹⁹ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, (Ref. Evidenca Nr.16)

⁴²⁰ Përfshirja e studentëve në organet vendimarrëse të UAMD). (Ref.Evidenca Nr.118).

⁴²¹ Vendim Nr. 57, Dt. 25.05.2020 "Miratim i anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë", UAMD). (Ref.Evidenca Nr.146).

përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<u>Por sic e kemi theksuar edhe më sipër nuk ka ndonjë ekspert të jashtëm të përfshirë në këtë proces</u>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se në Statutin e UAMD-së si dhe në Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 2, janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tërë aktorëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të cilësisë në institucion. Këto detyra dhe përgjegjësi janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të UAMD-së ^{422 423}
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nga analiza e dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon UAMD mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave sociale” institucioni ngarkon me përgjegjësi njësinë kryesore dhe bazë, kordinatorin e programit si dhe të gjitha strukturat ndihmëse të saj. ^{424 425}
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UAMD, konstatojmë se sanksionuar në aktet rregullatore dhe Kodin e Etikës të institucionit, në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit, përsosmëria dhe liria akademike, respekti i ndërsjellë dhe dinjiteti njerëzor, shumëllojshmëria e mendimeve, kulturave gjinore dhe etnike përgjegjësia personale e institucionale si dhe llogaridhënia duke siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve. ⁴²⁶

⁴²² Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. <https://uamd.edu.al>. Rubrika Transparenca (Informacione dhe Dokumenta)

⁴²³ Faqja zyrtare e UAMD . <https://uamd.edu.al>. (Sherbime NJSBC)

⁴²⁴ Statuti I UAMD.

⁴²⁵ Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. <https://uamd.edu.al>. Rubrika Transparenca (Informacione dhe Dokumenta)

⁴²⁶ Kodi i Etikës në UAMD neni 2; 6; 14;16. (Ref. Evidenca_Nr.45.)

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Konfirmojmë se UAMD ka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë të Masterit Shkencor “Mësues i Shkencave sociale” gjithë bashkëpunëtorët dhe ekspertët e përfshirë në realizimin e këtij programi studimi, nëpërmjet bashkëveprimit me studentë të diplomuar, institucionet bashkëvepruese për të marrë ekspertizë lidhur me ecurinë e programit.^{427 428}</p> <p>Vlerësimet mendimet e tyre merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të programit.⁴²⁹</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizen e kriterëve 1-5 të standartit VI.4 të dokumentacionit të paraqitur dhe vizites në institucion mendon se mendon se standarti përmbushet plotësisht pasi ka një sërë procesesh dhe veprimtarish që flasin për një përfshirje aktive të strukturave përgjegjëse në procesin e vlerësimit, si dhe veprimtari artistike për të evidentuar këtë përfshirje.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë</p>	<p>Organizimi dhe menaxhimi institucional në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, promovimi i një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë, është sanksionuar në “Planin strategjik 2020-2025 të UAMD-së (faqe</p>

⁴²⁷ Pyetësorët mbi progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet për praktikat profesionale dhe punësimin e studentëve, Departamenti Psikologji, 2022-2023. (Ref. Evidenca_Nr.177.1)

⁴²⁸ Evidencë e komunikimit me Urdhërin e Psikologut. (Ref. Evidenca_Nr.178)

⁴²⁹ Takim mes studentëve dhe ish-studentëve Alumni Fe/ Psikologji për të treguar mbi studimet në master, përvojat dhe arritjet e tyre, Prill 2023.

<https://ëëë.facebook.com/departamentipsikologjiisefakultetiedukimituamd/posts/pfbid0qo7LiceFYMZDKtrKpëE Dhy29nVpËKËyqu867u1NABcKaiEpEzDqvYGq4Cjb4mqgAl>

transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	9-11) dhe në programin e transparencës, publikuar në faqen zyrtare të tij. ^{430 431} Nga vizita në institucion rezulton se administrata pranë fakulteteve ofron shërbime për studentë dhe të intersuarit sipas nevojave të tyre lidhur me programin e studimit dhe me aspekte që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga vizita në UAMD rezulton se institucioni ka të sanksionuar në Rregulloren e funksionimit dhe organizimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, dhe në Planin strategjik detyrimin e publikimit të gjithë të dhënave dhe rezultateve në kuadër të vlerësimit të programeve të studimit që ajo ofron, duke ruajtur konfidencialitetin për të dhënat personale. Kjo mund të evidentohet më së miri në pyetësorët e ndryshëm të realizuar për probleme të ndryshme lidhur me procesin mësimor. ^{432 433}
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se procesi i vlerësimit të programeve të studimit pas relacioneve të dhëna lidhur me rezultatet e vlerësimit, nuk shoqërohet me një plan masash me orientim përmisimin e mangësive kur janë të konstatuara. <i>Mendojmë hartimin e një plan veprimi masash për programin e studimit ku të përcaktohen qartë mangësitë dhe dobësitë e konstatuara dhe afatet kohore për realizimin e tyre.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve që disponon UAMD dhe Fakulteti i Edukimit, dhe veprimtarive të planifikuara dhe të realizuara nga kjo njësi, konstatohet se është siguruar ndikimi i këtyre veprimtarive për përmisimin dhe rritjen cilësore të performancës së pedagogëve dhe studentëve dhe përmisimit cilësor të programit të studimit. ^{434 435}
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	Nga takimi me GVB të institucinit konstatohet se janë organizuar një sërë veprimtarish për ndërgjegjësimin e stafit për vazhdimësinë e punës

⁴³⁰ *Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD, 2020-2025* <https://uamd.edu.al/epcontent/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf> (Ref.Evidenca_Nr.3)

⁴³¹ *Programi i transparencës së UAMD.* <https://uamd.edu.al/programi-i-transparences/>

⁴³² *Pyetësorët mbi progresin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet për praktikat profesionale dhe punësimin e studentëve, Departamenti Psikologji, 2022-2023.* (Ref. Evidenca_Nr.177.1)

⁴³³ *Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët- Shembull i rezultateve të vlerësimit.* (Ref. Evidenca_Nr.153)

⁴³⁴ *Raport mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore FE, 2021-2022.* (Ref.Evidenca_Nr.133)

⁴³⁵ *Faqja zyrtare e UAMD* <https://uamd.edu.al>

periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	lidhur me vlerësimin periodik të programeve me synimin përmisimin e vazhdueshëm të tyre. Takime, ekspertizë, vlerësime dhe analiza rezultojnë se janë organizuar periodikisht në këtë institucion. ⁴³⁶			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se standarti përmbushet plotësisht pasi institucioni ka një sistem transparent dhe efektiv sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe po punon për krijimin e një kulture tek gjithë personeli për sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Aleksander Moisiu Durrës"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit Master Shkencor " Mësues i Shkencave Sociale" ka një infrastrukturë moderne për mësimdhënie dhe një bibliotekë funksionale në shërbim të stafit dhe studentëve për të përmbushur rezultatet e pritshme. Infrastruktura, hapësirat e nevojshme dhe adekuate, për mësimdhënie dhe studim individual, janë të bollshme dhe të mirë organizuara.
2. Programi i studimit Master i Shkencave "Mësues i Shkencave Sociale" përfshin studentët e diplomuar nepërmjet ALUMNI-t në përmisimin e objektivave dhe përmbajtjes të programit, duke shfrytëzuar pjesëmarrjen e tyre në veprimtarinë e organizuara nga Departamenti, dhe ekspertizën që ata ofrojnë.

⁴³⁶ Faqja zyrtare e UAMD. <https://uamd.edu.al>




3. Plani strategjik i zhvillimit 2020-2025 i Departamentit të Psikologjisë, në kuadrin edhe të planit strategjik të zhvillimit të institucionit, përcakton qartë misionin e njësisë detyrat dhe përgjegjësitë për përmisimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe të sigurimit të cilësisë.
4. Niveli i kualifikimit në rritje, vërtetuar me gradat e titujt e fituar dhe vlerësimet e studentëve, mobilitetet si të stafit akademik ashtu dhe studentëve, nga pjesëmarrja në programin Erasmus+ ka mundësuar shkëmbim eksperiencash që ndikojnë në mësimdhënie e kërkimin shkencore të pedagogëve dhe studentëve.
5. FE/DP, ka realizuar marrëveshjet bashkëpunimit në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale.
6. Studentët shprehen të kënaqur me klimën positive institucionale dhe ndërveprimin me stafin akademik të angazhuar në program.

Pika të dobta

1. Numri në ulje i studentëve të rregjistruar nga 39 në vitin akademik 2019-20 në 8 studentë në vitin akademik 2022-2023 dhe atyre të punësuar në raport me numrin e studentëve të diplomuar, nga 12 të punësuar në 2019-2020, në 1 student në vitin 2022-2023. **(Referuar Evidencës Nr.211. Tabelat përmbledhëse të MSH MSHS)**
2. Mungesa e një eksperti të jashtëm në njësitë e vlerësimit të brendshëm si në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore, Fakultet dhe Departament, i cili do të ndihmonte në rishikimin apo dhënie sugjerimesh lidhur me përmisimin e punës. **(Standarti VI/2. Kriteri 1; 2)**
3. Në disa nga syllabuset e programit të studimit Master i Shkencave “Mësues i Shkencave Sociale” ka një numër të pakët të literaturës së rekomanduar **(duke patur parasysh se kemi të bejmë më një nivel të dytë studimi) dhe kërkohet përditësim i saj. (Standarti IV/3, Kriteri 1; 2)**
4. Mungesa e evidentimit dhe vlerësimit të veprimtarive të organizuara në kuadrin e realizimit të programit të studimit duke synuar marrjen e një feedbacku nga pjesëmarrësit për të kuptuar sa të efektshme dhe sa janë përputhur me pritshmëritë e tyre. **(Standarti V/4 kriteri 1; Standarti VI/ kriteri 3)**
5. Ngarkesa mësimore e shprehur në kredite për kategoritë A, B dhe C të veprimtarive formuese, të pasqyruara në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Mësues i Shkencave Sociale, nuk përputhet plotësisht me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; **(Standarti II.1, kriteri 1)**
6. Mungojnë disa aspekte teknike të Planit Mësimor lidhur me elementet informuese, përfshi edhe elementet informuese për lëndën Praktikë Profesionale. **(Standardi II.3, kriteri 2; Standardi II.4, kriteri 2)**


Rekomandime

1. Rekomandohet ruajtja e vazhdimësisë së vlerësimeve periodike të programit bazuar në rezultatet e vlerësimit të përfituara nga pyetsorët me studentë, vlerësimin e kolegëve dhe drejtuesve të institucionit, për të verifikuar rezultatet e pritshme, dhe arritjeve më të mira.
2. Përfshirja në njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë të një eksperti të jashtëm i cili do të ndihmonte në rishikimin apo dhënie sugjerimesh lidhur me përmisimin e procesit mësimor, dhe sigurimin e cilësisë.
3. Evidentimi dhe vlerësimi i veprimtarive të organizuara në kuadrin e realizimit të programit të studimit duke synuar marrjen e një feedbacku nga pjesëmarrësit për të kuptuar sa të efektshme dhe sa janë përputhur me pritshmëritë e tyre.
4. Rekomandohet që në përgjithësi të rritet numri i librave apo publikimeve tek literatura e rekomanduar tek syllabuset (pasi është nivel i dyte studimi) dhe në disa syllabuse të ketë përditësim të saj me literaturë të paktën të 7-8 viteve të fundit.
5. Rekomandohet të rishikohet në Planin Mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore respektive e shprehur në kredite për kategoritë A, B, C, me qëllim që të pajtohet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar), si dhe të plotësohen disa aspekte teknike të Planit Mësimor lidhur me të dhënat/elementet informuese, përfshi edhe elementet informuese për lëndën Praktikë Profesionale.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Teacher of social sciences" provided by the Higher Education Institution "UAMD"

Strengths and affirmations

1. The Master of Science study program "Teacher of Social Sciences" has a modern infrastructure for teaching and a functional library at the service of staff and students to meet the expected results. The infrastructure, the necessary and adequate spaces for teaching and individual study, are abundant and well organized.
2. The Master of Science study program "Teacher of Social Sciences" includes graduate students through ALUMNI in improving the objectives and content of the program, using their participation in the activity organized by the Department, and the expertise they offer.
3. The 2020-2025 strategic development plan of the Psychology's Department, within the framework of the institution's strategic development plan, clearly defines the unit's mission, duties, and responsibilities for continuous improvement of the teaching process and quality assurance.
4. The growing level of qualification, proven by the degrees and titles obtained and student evaluations, the mobility of both academic staff and students, from participating in the Erasmus+ program has enabled the exchange of experiences that affect the teaching and scientific research of lecturers and students.




5. Educational Faculty/ Department of Psychology has implemented cooperation agreements at the institutional level for the organization and fulfillment of the goals of professional practice, as well as other educational activities for the realization of the study program of the second cycle Master of Science in Teacher of Social Sciences.
6. Students are satisfied with the positive institutional climate and the interaction with the academic staff engaged in the program.

Weaknesses

1. The decreasing number of students registered from 39 in the academic year 2019-2020 to 8 students in the academic year 2022-2023 and those employed in relation to the number of graduated students, from 12 employed in 2019-2020 to 1 student in the year academic year 2022-2023. **(Referred to Evidence No. 211. Summary tables of Master of Science "Teacher of Social Sciences)**
2. Lack of an external expert in the Internal Evaluation Units both at the institutional level and the main unit Faculty and department who would help in reviewing or giving suggestions regarding the improving of teaching process. **(Standard VI/2. Criterion 1; 2).**
3. In some of the syllabuses of the Master of Science "Teacher of Social Sciences" study program there is a small number of recommended literature (taking into account that we are dealing with a second level of study) and its updating is required. **(Standard IV/3. Criterion 1; 2)**
4. The lack of evidence and evaluation of the activities organized in the framework of the implementation of the study program, aiming to receive a feedback from the participants in order to understand how effective they were and how much they complied with their expectations. **(Standard V/4 Criterion 1; Standard VI/1 Criterion 3)**
5. The load of teaching/teaching hours expressed in credits for categories A, B and C of formative activities, reflected in the Academic Plan of the study program Master of Science in Teacher of Social Sciences, does not fully comply with the definitions of VKM no. 41, dated 24.01. 2018; **(Standard II.1, criterion 1)**
6. Some technical aspects of the Academic Plan are missing in relation to the informative elements, including the informative elements for the subject of Professional Practice. **(Standard II.3, criterion 2; Standard II.4, criterion 2)**

Recommendation

1. We recommend maintaining the continuity of periodic evaluations of the program based on the evaluation results obtained from questionnaires with students, the evaluation of colleagues and leaders of the institution, to verify the expected results, and the best achievements, inclusion in the quality assurance units, of one external expert who would help in reviewing or giving suggestions regarding the improving of teaching process.




2. The inclusion in the internal quality assurance units of an external expert who would help in reviewing or giving suggestions regarding the improvement of the teaching process, and ensuring quality.
3. The evidantation and evaluation of the activities organized in the framework of the implementation of the study program, aiming to receive a feedback from the participants in order to understand how effective they are and how much they have met with their expectations.
4. We recommend that, in general, the number of books or publications in the literature recommended in the syllabuses should be increased (since it is the second level of study) and that some syllabuses should be updated with literature from at least the last 7-8 years.
5. It is recommended to review in the Academic Plan, the distribution of the relevant teaching/learning load expressed in credits for categories A, B, C, in order to comply with the definitions of VKM No. 41, dated 24.01.2018 (amended), as well as to complete some technical aspects of the Academic Plan regarding data/informational elements, including informational elements for the subject of Professional Practice.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

